

David Martin Young



RIKTHIMI



David Martin Young



RIKTHIMI



Rikthimi

David Martin Young

AEM-Misioni Ungjillor
Gjrokastër

Titull në shqip: “Rikthimi”
(vëllim shoqërues me “Mposht Dyshim”)

Autor: David Martin Young
Shqipëroi: Florenc Mene
Botoi: AEM-Misioni Ungjillor, Janar 2009
© AEM-Misioni Ungjillor, Gjirokastër, Albania (Prill 2009)

E drejta e botuesit në gjuhën shqipe:
Të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk duhet të riprodhohet, të vendoset në ndonjë sistem, ose të trasmetohet nëpërmjet çdo forme apo mënyre, elektronike, mekanike, fotokopjimi, inçizimi apo në ndonjë mënyrë tjetër pa marrë më parë leje me shkrim nga botuesi.

Citimet biblike janë marrë nga Bibla Diodati i Ri (1991-1994).
E drejta e autorit © SHOQERIA BIBLIKE SHQIPTARE (A.B.S.)
TIRANË. Përdorur me leje.

Shtypur: Vernon Publishing,
Tirana, Albania, 2009
ISBN: 978-99943-55-58-7

Ic þohte þæt ge woldon þurh þa wundorlican race eower mod awendan to
Godes willan on eornost.

[Synimi im ishte që, me anë të rrëfimit të mrekullueshëm, të dëshironit ta kthenit
zemrën plotësisht drejt vullnetit të Perëndisë.]

- Ælfric

Kapitulli 1 - Shkarja nga Besimi

Ky libër flet për atë që në anglisht quhet *backsliding*. E patëm pak të vështirë të vendosnim për përkthimin e fjalës “backsliding”, dhe megjithëse në fund vendosëm për shprehjen “të shkasësh nga besimi”, na u duk e drejtë të japim një shpjegim ose përshkrim të asaj çka nënkuptojmë me këtë. Kjo shprehje përdoret për të përshkruar përvojën dhe gjendjen e një të krishteri të vërtetë i cili nuk po ecën më me përkushtim dhe intimitet me Zotin; zjarri shpirtëror i është shuar; ai ndoshta lutet shumë rrallë, Biblën e lexon rrallë, nuk shkon shpesh në kishë dhe rrallëherë kënaqet me bashkësinë e të krishterëve të tjerë kur ata flasin për gëzimet dhe përvojat e tyre shpirtërore, ose kur flasin për bekimet e Perëndisë në jetën e tyre; ai nuk i shërben më Perëndisë siç ka bërë një herë e një kohë. Njeriu që ka shkarë nga besimi ka qenë një i krishterë i përkushtuar dhe i flaktë: tani ai është shmangur nga ajo afërsi me Zotin, dhe është larg tij. Zemra e tij është si ai zjarri që gjej ndonjëherë kur ngrihem në mëngjes: të gjithë drutë dhe qymyri janë bërë hi, dhe kanë marrë ngjyrë gri, ndonëse kur pastroj vatrën, thellë brenda hirit, gjej ende ndonjë thëngjill të zbehtë. Zjarri është shuar gjatë natës; është mbuluar me hi. Kjo është gjendja e shpirtit dhe jetës së njeriut që ka shkarë nga besimi.

Ka njerëz që kanë shkarë nga besimi dhe nuk shqetësohen për gjendjen e shpirtit të tyre: ndoshta ata nuk po e lexojnë këtë libër, por nëse ti, lexues, je një njeri i tillë, vazhdo të lexosh dhe lejoje Perëndinë të të flasë përsëri dhe të të tërheqë prapë afër vetes së tij për shërbesë me dashuri dhe zell. Ka edhe nga ata njerëz të shkarë nga besimi që janë të pikëlluar për gjendjen e mjerueshme ku ndodhen tani, dhe që duan shumë të kthehen tek Perëndia i tyre, ndonëse ndoshta nuk dinë sesi, ose ndoshta pyesin veten nëse Perëndia

do të ishte i gatshëm t'i pranojë përsëri. Nëse je njeri që ka shkarë nga besimi dhe je i shqetësuar për gjendjen tënde shpirtërore, shpresojmë që ky libër i vogël do të të vijë në ndihmë.

Ka shumë njerëz që fillojnë të ecin në Perëndinë me gëzim dhe shpresa të mëdha, por që, më vonë, shkasin mbrapa në moskokëçarje dhe ftohtësi.

Por ka edhe shumë të tjerë që më vonë ndjejnë fajin dhe turpin e asaj që kanë bërë. Ata i kanë kthyer kurrizin një Zoti që i ka dashur, që erdhi në këtë botë, vdiq për ta dhe që, pasi u ringjall nga vdekja, dërgoi në jetën e tyre Frymën e tij dhe u dha besimin, shpëtimin dhe privilegjin e pamasë që të jenë fëmijë dhe shërbëtorë të të vetmit Perëndi të vërtetë dhe të gjallë. Ata i kthyen kurrizin gjithë kësaj dhe thanë me anë të veprave dhe jetës së tyre, në mos edhe me fjalë, se tani kanë punë më të rëndësishme ose më tërheqëse për të bërë. Pastaj më vonë, ata ndjejnë fajin që i përvëlon, turpin poshtërues për mënyrën sesi i janë përgjigjur Shpëtimtarit dhe Atit të tyre qiellor.

Këto dy arsye e shtynë Pastor Femi Cakollin nga Prishtina të shkruante:

Librin që e ke propozuar më duket një temë shumë e qëlluar dhe e nevojshme për kishën.

Pikëllimi për mëkatën është gjithmonë fillimi më i mirë në kthimin te Perëndia. Shumë njerëz e kanë ndjerë. Nëse ke shkarë nga besimi, shpresojmë seriozisht se edhe ti po ndihesh në këtë mënyrë. Por mos u dorëzo para mungesës së shpresës. Ekziston një rrugë kthimi. Perëndia të do dhe po pret të të pranojë përsëri, mjafton që të vish. Nuk është tepër vonë; asnjëherë nuk është tepër vonë përderisa mbetesh në këtë botë. Ja disa fjalë ngushëllimi dhe të fuqishme nga Bernardi i Clairvaux, një murg katolik francez që jetoi në vitet 1091-1153:

Miq të e mi, ju këshilloj të zbrapseni nga kthimi i ankthshëm dhe i dhimbshëm tek jeta e shkuar dhe e gabuar, dhe të ndiqni shtigje që janë më të lehta dhe ju japin mendime më të kënaqshme për të kujtuar të mirat e Perëndisë. Në këtë mënyrë, duke i fiksuar mendimet dhe sytë tek ai, do të mund të siguronit njëfarë lehtësimi nga turpi dhe pështjellimi, të cilat shkaktohen kur mendoni për veten. Do të doja që të provonit këshillën që jep psalmisti i shenjtë kur thotë: “Gjej kënaqësinë tënde në Zotin dhe ai do të plotësojë dëshirat e zemrës sate.” (Ps. 37:4) Pikëllimi për mëkatën është vërtet i nevojshëm, por nuk duhet të jetë i vazhdueshëm; dhe ai duhet të

përzihet me kujtimin e gëzueshëm të mirësisë hyjnore, në mënyrë që zemra të mos ndihet e rënduar për shkak të trishtimit që ndien dhe dëshpërimi të mos e shkatërrojë plotësisht. Le ta përziejme mjaltin me pelin, në mënyrë që të jemi në gjendje ta pimë këtë pije të hidhur, të zbutur nga diçka e ëmbël; kështu, edhe hidhësia e saj do të jetë e shëndetshme. Shikoni si Perëndia vetë e zbut hidhësirën e zemrës së thyer në mënyrë që ta tërheqë nga humnera e dëshpërimit njeriun e mposhtur nga frika dhe shkurajimi; për të ngushëlluar të pikëlluarin me mjaltin e një premtimi të ëmbël dhe besnik; për ta ngritur lart atë që ka pak besim.

- Predikimi XI mbi Këngën e Këngëve [përkthyer nga “Duaje Perëndinë”, redaktuar nga Hugh Martin, SCM, Londër, 1959]

Fotografia e kapakut tregon një grua që po shëtiti në Black Hill në Uells, e cila, në një ditë të zymtë dhe me lagështirë, po kthehet përmes një shtegu të ashpër i cili shpesh ka pellgje uji. Po kthehet nga ajo që duket si fundi i kodrës, ku dukej sikur nuk e dinte nga të shkonte. Nuk kishte ndonjë perspektivë përpara; prandaj kishte ardhur çasti të kthehej. Njeriu që ka shkarë nga besimi mund të arrijë në këtë gjendje në jetën e brendshme, ndoshta edhe në jetën e jashtme. Ka ardhur koha që të kthehesh tek Perëndia. Pikërisht për këtë gjë flet ky libër.

Me këto fjalë hyrëse, në kapitujt e mëposhtëm do të shfletojmë faqet e shkrimit dhe do të

shohim njerëz që patën shkarë nga besimi, dhe do të shikojmë se si Zoti i thirri dhe si veproi me ta.

Por ndoshta fjala “njeri që ka shkarë nga besimi” nuk është ajo e duhura për disa prej tyre. Disa, pikë së pari, mund të mos kenë qenë kurrë besimtarë të vërtetë, por ata dinë shumë për Perëndinë, kanë rrëfyer prej së jashtmi se e njohin dhe kanë bërë disa hapa drejt shërbimit dhe adhurimit të tij. Pastaj, i kthyen kurrizin Zotit, ndonëse nuk i ishin kthyer kurrë atij me besim, dashuri dhe përkushtim të vërtetë e të brendshëm. Edhe këtyre njerëzve u bëhet thirrje të kthehen aty ku kanë qenë, por kësaj here jo vetëm me fjalë dhe vepra të jashtme, por me pendim dhe besim në zemër, duke vendosur me përkushtim që të jetojnë dhe të vdesin në besimin e vërtetë, dhe pastaj të kalojnë përjetësinë me Perëndinë, i cili i thirri me durim që të vijnë.

Zoti na ndihmoftë të kuptojmë dhe t'i afrohem atij me dashuri të ngrohtë dhe përkushtim të vërtetë.

Kapitulli 2 - Kaini

Më duket ide e mirë që të fillojmë me Kainin, sepse ai përmendet shumë herët në Bibël, në fakt që tek Zanafilla 4. Historia që lexojmë për të dhe për familjen e tij tregon se ai kishte prindër që nuk ishin të përsosur por që besonin me të vërtetë tek Zoti: ndryshe nga shumë njerëz në ditët e sotme! Dhe sigurisht, ata quheshin Adami dhe Eva, dhe ishte mosbindja dhe mëkati i tyre që sollën kaq shumë telashe, deri dhe vdekjen, në racën tonë.

Kaini nuk ishte njeri që u shmangej përgjegjësi: ai kishte punë të vështirë dhe ishte i tëri i dhënë pas saj. Ai ishte “punonjës i tokës”, bujk. Më parë kam jetuar në një fermë në Sussex, dhe e kam paksa idenë e fillimit të punës herët në mëngjes, orëve të gjata, varësisë nga moti dhe nevojës për të duruar kur moti ishte kundër punës së fermerit, si edhe lodhjes fizike.

Edhe Kaini besonte tek Perëndia dhe kishte njëfarë dëshire për ta pranuar, adhuruar dhe për t’i shërbyer, sepse “i bëri një ofertë frutash të tokës Zotit”. Ai ndoshta mund të ketë qenë si ty, ose si dikush tjetër që ti njeh dhe për të cilin po lutesh. Ai e dinte se ekzistonte një Perëndi që meritonte të adhurohej. Kaini kishte edhe një vëlla, Abelin, edhe ai fermer, i cili nuk ishte bujk, por bari. Prandaj, ai nuk i solli Perëndisë ofertë nga frutat e tokës, por “të paralindurin e kopesë së tij dhe yndyrën e tyre”. Zoti e çmoi Abelin dhe ofertën e tij, por jo Kainin dhe ofertën e tij. Pra, Perëndia pranoi një njeri dhe dhuratën e tij, dhe refuzoi tjetrin.

Pse? Pse Perëndia nuk e pranoi Kainin dhe ofertën e tij? Zanafilla nuk na e thotë, por përgjigjen e gjejmë tek Hebrenjtë 11:4. Atje thuhet se “me anë të besimit Abeli i ofroi Perëndisë flijimin më të mirë nga ai i Kainit”. Po, Kaini e dinte se ekzistonte një Perëndi, dhe e dinte se Perëndia duhej adhuruar; por atij i mungonte besimi dhe përkushtimi i vërtetë në zemër. Kjo e klasifikon atë në kategorinë e tretë që përmendëm tek kapitulli 1 – jo një besimtar që ka shkarë nga besimi, por një njeri që ishte afër fesë së vërtetë, por asnjëherë nuk krijoi një marrëdhënie të brendshme e personale me Perëndinë.

Unë besoj se sot ka shumë njerëz të tillë në të gjitha kishat, Ortodokse, Romane apo Protestante; ka edhe një numër të mirë njerëzish të tillë jashtë çdo kishe. Ndoshta ti je një prej tyre: e di se Perëndia është i vërtetë, e nderon deri diku, por nuk e njeh si të ishe fëmija i tij. Kaini shkau nga pozicioni ku gjendej afër besimit të vërtetë, ndonëse jo brenda tij, dhe u largua shumë nga Zoti.

Shumë njerëz, në gjendjen ku filloi Kaini, mendojnë se Perëndia do t'i pranojë ashtu siç janë. Ata mendojnë se mjafton të pranosh me mendje ekzistencën e tij dhe të drejtën për t'i shërbyer, pa pasur besim të vërtetë - domethënë besim te Perëndia dhe mbështetje në premtimet dhe veprën e tij. Është mirë të shkosh në kishë, të bësh sakramentet, të jesh anëtar zyrtar i një denominacioni ose kishe, por nuk është ky thelbi i brendshëm i marrëdhënies me Perëndinë, i krishterimit të vërtetë: përkundrazi, aktivitete të tilla duhet të shprehin atë bashkim të brendshëm të shpirtit dhe Perëndisë në Krishtin.

Kaini u habit dhe u zhgënjye kur Perëndia nuk e pranoi atë dhe ofertën e tij, “dhe fytyra e tij mori një pamje të dëshpëruar”. Sigurisht që ai duhet të kishte ndaluar, të shqyrtonte veten dhe të sigurohej që të gjente shkakun pse Perëndia e refuzoi. Por nuk e bëri. Për marrëzinë e tij, ai u zemërua me Perëndinë – në fakt, Bibla thotë “u pezmatua shumë”. Sot ka shumë njerëz – sigurisht në kisha Protestante, por ndoshta edhe tek të tjerat – që nuk janë aspak të gatshëm t'u nënshtrohen kërkesave të rrepta të Perëndisë, dhe zemërohen pse ai nuk i ul standartet për ta dhe nuk i pranon njerëzit mbi asnjë bazë tjetër veç asaj që ka caktuar ai: me anë të besimit. Sepse pa besim është e pamundur t'i pëlqesh atij.

Ata që jetojnë dhe vdesin pa besim do të dënohen, por njerëzit zemërohen kur dëgjojnë për gjykimin dhe ferrin, dhe mendojnë se Perëndia duhet të pranojë edhe diçka më pak, diçka që mund t'ia ofrosh me gjysmë zemre, dhe jo me të gjithë zemrën. Disa ofrojnë vepra fetare, që edhe mund të jenë vepra mahnitëse: “A nuk profetizua në emrin tënd, a nuk i dëbua demonët në emrin tënd, a nuk kemi bërë shumë vepra të fuqishme në emrin tënd?” Por Jezusi shpall: “Unë s'ju kam njohur kurrë; largohuni nga unë, ju të gjithë, që keni bërë paudhësi.” (Mt. 7:21-23) Disa njerëz shpresojnë se mirësia e tyre do të mjaftojë, por përsëri Perëndia na thotë, me anë të apostullit Pal, se shpëtimi ynë “nuk vjen nga vepra, që të mos mburret askush.” (Ef. 2:8-9) Perëndia kërkon pendimin dhe besimin. Kapitulli i parë

i Ungjillit të Markut përmban këtë urdhërim: “Pendohuni dhe besoni ungjillin”. Pendim do të thotë të të vijë keq për gjërat e gabuara që ke bërë, dhe të kthehesh drejt një jetë të re. Besimi është mbështetja besëplotë në premtimet e Perëndisë dhe në atë që Perëndia bën për të shpëtuar shpirtin tënd përmes Birit të tij Jezu Krisht. Është marrëzi, por dhe mëkat, të shkatërrosh vetveten duke u zemëruar me Perëndinë ngaqë të kërkon këtë kur, në fakt, duhet t’i bindesh atij me pendim dhe besim.

Por Perëndia ishte i mirë dhe i duruar me Kainin; ai e paralajmëroi për rrezikun që i kanosej, dhe e ftoi të shqyrtonte shkakun e zemërimit dhe zhgënjimit të tij. Ai e ftoi Kainin të bënte të mirën dhe të largohej nga mëkati, në mënyrë që të pranohej (Zan. 4:6-7). Perëndia është i mirë dhe i duruar me ne, mëkatarët, sepse nuk është vullneti i tij që ndonjë njeri të humbasë.

Por vëreni këtë: Perëndia nuk i dha ndonjë shpjegim Kainit dhe nuk e justifikoi veten. Perëndia është Perëndi dhe nuk i jep llogari e as nuk i përgjigjet njeriu – as ty, lexues, dhe as njeriu tjetër, fetar apo jofetar. Ai i ka vendosur standardet e tij, i ka fiksuar kërkesat dhe nuk na detyrohet neve (krijesave të tij) të na i shpjegojë ose justifikojë ato. Ai është i mirë dhe na thotë se çfarë duhet të bëjmë që të shpëtohemi, të falemi dhe të jemi fëmijët e tij. Ai na thotë: por është e drejta e tij të vendosë se në bazë të çfarë kushteve na pranon, dhe këto janë jashtëzakonisht të qarta. “Pendohuni dhe besoni ungjillin”. Kapitulli i Hebrenjve, të cilin e përmendëm, na thotë shkoqur se “pa besim është e pamundur t’i pëlqesh atij” (Heb. 11:6).

Pra, Perëndia nuk e justifikoi veten, dhe nuk i “kërkoj falje” Kainit, pse kishte vendosur një standard kaq të lartë: por, nga ana tjetër, i tha çfarë mund të bënte vetë Kaini për hallin që kishte. I duruar, i arsyeshëm dhe i mirë – ky është Perëndia. Por Kaini u bë i paarsyeshëm; ai u largua edhe më tej nga Perëndia, dhe në mënyrë të dukshme, u bë edhe më shumë i ndryshëm nga karakteri i Perëndisë; u bë mëkatar akoma më i hapur. Në vend të që kthehej tek Perëndia siç e ftoi ai, Kaini tani u zemërua me të vëllanë, Abelin, tek i cili Perëndia gjeti besim dhe e pranoi, dhe Kaini vrau Abelin. Kjo mund të duket diçka e skajshme, dhe në fakt është e tillë: por mendo – a nuk ka shumë njerëz sot që e kanë më mirë t’i vrasin ata që i vënë në dijeni për Perëndinë e vërtetë sesa t’i binden Perëndisë dhe të bëhen të krishterë në kuptimin biblik të fjalës?

Kështu, Kaini e mori të vëllanë në fushë, dhe atje e vrau. Perëndia, pasi pa se çfarë kishte ndodhur, e ftoi Kainin që të rrëfente çka kishte bërë: “Ku është vëllai yt Abeli?” – e pyeti, sigurisht, duke e ditur shumë mirë përgjigjen, sepse në vargun tjetër thotë: “Zëri i gjakut të vëllait tënd më vëngon nga toka.” Pra, Perëndia i dha një mundësi tjetër Kainit që të tregonte të vërtetën, të nxirrte në shesh gabimin e tij. Por ai e përbuzi këtë shans, dhe përkundrazi, i tha Perëndisë një gënjeshtër të hapur: “Nuk e di.”

Kjo ishte një marrëzi dhe mëkat i madh. Edhe të tjerë njerëz e kanë gënjyer Perëndinë, dhe ka një dënim të ashpër për këtë, nëse nuk pendohemi. Pastaj Kaini beri një hap akoma më të gabuar se i pari. Ai vazhdoi t’i përgjigjej pyetjes së Perëndisë me sarkazëm. Imagjinoni pak të bëhesh sarkastik me Perëndinë! As *njerëzve* nuk u pëlqen sarkazma. Kaini e sfidoi: “Mos jam unë rojtari i vëllait tim?”

Bibla thotë më vonë: “Kurse këta flasin keq për të gjitha gjërat që nuk i dini ... Mjerë ata, sepse kanë marrë rrugën e Kainit” (Jud. 10-11). Mund ta kuptoni pse.

Në këtë pikë, dëshiroj të shkruaj një paralajmërim shumë serioz për çdo lexues që ka ndjerë fuqinë e Perëndisë dhe e ka kuptuar se Perëndia kërkon bindjen dhe shërbimin tonë. Dua të them këtë: nuk mund t’i afrohesh Perëndisë, të largohesh prej tij, dhe prapëseprapë të qëndrosh i njëjti. Kjo është e pamundur. Kur i afrohesh Perëndisë ndryshon, në një mënyrë ose në një tjetër. Nëse nuk reagon ndaj tërheqjes së tij dhe nuk i afrohesh, do të bëhesh më keq, do të biesh akoma më poshtë. “Sepse do të qe më mirë për ta të mos e kishin njohur udhën e drejtësisë, se sa, pasi e njohën, t’ia kthejnë shpinën urdhërimit të shenjtë që u qe dhënë. Por atyre u ndodhi ç’ka thotë një fjalë e urtë e vërtetë: ‘Qeni i kthye në të vjellat e veta’, dhe ‘dosa e larë u kthye të zhgërryhet në llucë’.” (2 Pj. 2:21-22)

Është tronditëse që një njeri i cili filloi me prindër jo të përsosur por besimtarë, që punoi shumë dhe ndërmori disa hapa drejt Perëndisë, të bëhej gënjeshtar dhe vrasës. Por këto histori nuk gjenden në Bibël që të na nxisin kureshtjen, që të na zbavitin gjatë mbrëmjeve, që të jenë për ne si mitet greke ose si sagat norvegjeze, me të cilat mund të kënaqemi, por që nuk i zbatojmë. Këto histori janë aty që të na paralajmërojnë dhe të na udhëzojnë, sepse çdonjëri prej nesh mund të marrë rrugën e Kainit. 1 Gjonit 3:12-15 na urdhëron që të mos jemi “sikundër Kaini, i cili ishte nga i ligu dhe vrau vëllanë e vet ... dhe ju e dini se asnjë vrasës nuk ka jetë të përjetshme të

qëndrueshme në vete.” Kjo u është shkruar të krishterëve për shkak të mundësisë së tmerrshme se mund të shkasim nga afërsia jonë me Perëndinë, dhe mund të bëhemi thellësisht dhe krejtësisht të mëkatshëm – më të mëkatshëm se ata që nuk kanë besuar kurrë.

Pyetja tjetër që Perëndia i bëri Kainit na drejtohet të gjithëve: “Çfarë ke bërë?” Është më mirë që Perëndia të të pyesë tani, dhe t’i përgjigjesh ndershmërisht duke i thënë të vërtetën – sado të këqija të jenë gjërat që duhet të pranosh – sesa të presësh të bëhesh 70 ose 80 vjeç dhe të zgjohesh në mes të natës i djersitur dhe në ankth duke pyetur *veten*, “Çfarë kam bërë? Çfarë kam bërë?” Ndoshta do ta bësh pyetjen dhe do ta dish përgjigjen, por do të kesh harruar se ku të gjesh paqe për ndërgjegjen në të vetmen mënyrë që është përjetësisht e mundshme, pra, nëpërmjet gjakut të kryqit.

Nga atë sa dimë, Kaini nuk u pendua kurrë, dhe tek Zanafilla 4:11-16 mundësia për të ndryshuar s’është më, Kaini e ka refuzuar, dhe mallkimi i Perëndisë bie mbi të:

Dhe ti tani je më i mallkuar se toka... nuk do të të japë më prodhimet e saj, dhe ti do të jesh endacak dhe një ikanak mbi tokë... atëherë Kaini u largua nga prania e Zotit dhe banoi në vendin e quajtur Nod, në lindje të Edenit.

Një shënim në fund të faqes na tregon se “Nod” do të thotë “të endesh”.

Por këtij tregimi i shtohet diçka e mahnitshme. Edhe në atë çast, Perëndia, me mirësi dhe mëshirë, e shpëtoi Kainin nga pasojat më të këqija të mëkatit të tij. Sepse Kaini tha: “Ndëshkimi im është tepër i madh sa unë nuk mund ta duroj”, dhe u frikësua se ai vetë do të vritej nga dikush që mund të takonte në endjet e tij. Perëndia nuk e la në mëshirë të fatit, por “Zoti vuri një shenjë mbi Kainin, me qëllim që kushdo që ta gjente të mos e vriste.”

Më vonë Kaini arriti gjëra të mëdha. Ai dhe gruaja e tij patën një djalë, dhe Kaini ndërtoi dhe i vuri emrin një qyteti. Por jeta familjare dhe arritjet qytetare të tij u prishën nga ftohja e tij me Perëndinë. Ai ishte njeri në arrati. Askund nuk lexojmë për kthimin e tij tek Perëndia. Megjithatë, mendoj se kjo histori na tregon se mëshira e Perëndisë është e hapur për mëkatarin gjatë gjithë kohës që ai qëndron në këtë botë.

Nëse e di që Perëndia është i gjallë dhe i vërtetë, adhuroje dhe shërbeji nëpërmjet Birit të tij, Zotit Jezu Krisht. Kjo është thirrja e Perëndisë për të gjithë njerëzimin, dhe për ty.

Nëse, një e herë e një kohë, e ke njohur Perëndinë dhe e dije se me anë të besimit ke qenë fëmija e tij, por ke shkarë nga ajo dashuri dhe miqësi me Zotin tënd, kthehu dhe vendose pjesën e jetës që të ka mbetur në duart e tij.

Nëse po lutesh për dikë që të kthehet, vazhdo me ngulm derisa ai person të jetë në këtë botë, duke kujtuar gjithmonë se mëshira e Perëndisë e mirëpret mëkatarin dhe atë që ka shkarë nga besimi gjatë gjithë kohës, deri sa të mbyllë sytë në vdekje. Por pas kësaj, vjen gjykimi.

Kapitulli 3 - Jakobi

Psalmi 24:5-6 premton bekim, vënien e drejtësisë në vend dhe shpëtimin nga një Perëndi i interesuar personalisht për ata që “kërkojnë fytyrën tënde, o Perëndi e Jakobit”. Por kjo ndoshta s’të vjen shumë në ndihmë, veçse nëse mendon se je pak a shumë si Jakobi. Pra, do të kthehemi përsëri tek libri i Zanafillës dhe do të studiojmë jetën dhe përvojën e Jakobit. Në këtë mënyrë, mendoj se shumë prej nesh do ta shikojmë veten të pasqyruar në ndonjë pjesë të historisë së tij, ose ndoshta në gjithë historinë. Pikërisht, në atë moment do të kuptojmë se kemi të drejtën të kërkojmë të njëjtin Perëndi që adhuroi Jakobi, dhe do të jemi në gjendje të kërkojmë bekimin, drejtësinë dhe shpëtimin prej tij.

Zanafilla 25:23 na thotë se Perëndia e njihte këtë njeri dhe kishte plane për të që para se ai të lindte. Gjatë rritjes, jeta e Jakobit filloi të shfaqte një sërë të metash në karakterin e tij dhe vështirësi në rrethanat ku ndodhej. T’i shohim sipas radhës.

Së pari, ai “ishte një njeri i qetë, që jetonte në çadra”. Në një shoqëri ku shpesh kishte luftë fisesh dhe ku gjuetia pëlqejë dhe vlerësohej, shohim një njeri të qetë i cili parapëlqente të qëndronte në shtëpi. Edhe nga ana fizike, trupi e shfaqte këtë anë të karakterit të tij, sepse ndonëse kishte një vëlla të fortë dhe trim, të cilit i pëlqente shumë të shkonte për gjah përjashta dhe të cilin Bibla e përshkruan si “njeri leshtor”, Jakobi vetë ishte “njeri me lëkurë të lëmuar”. Nuk është për t’u habitur që i ati, Isaku, parapëlqente Esaun, vëllanë e Jakobit, më shumë se Jakobin; por Jakobi ishte fëmija i preferuar i së ëmës. Fëmijët janë ndryshe nga njëri-tjetri, dhe ndodh shpesh që njërin mund ta vlerësosh dhe ta pëlqesh më shumë sesa tjetrin. Por është gjë e keqe kur prindërit i shfaqin pëlqimet tyre dhe lejojnë favorizimin të hyjë vjedhurazi në jetën familjare.

Gjyshi dhe gjyshja ime kishin katërmëdhjetë fëmijë. Kur njëri prej tyre vdiq, babai im kujtonte se i ati zbriti nga shkallët me fëmijën e vdekur në duar dhe tha se, ndonëse kishte dhe shumë fëmijë të tjerë, ai e ndjente humbjen e njërit prej tyre njësoj sikur të mos kishte asnjë tjetër, sepse i donte të gjithë njësoj. Kështu duhet të sillen prindërit. Pra, Jakobi ishte në disavantazh për shkak të karakterit me të cilin u lind dhe u rrit.

Ai lejoi që karakteri t'i bëhej i pakëndshëm: 'finok' dhe 'lakmitar' janë fjalët që e përshkruajnë këtë lloj karakteri. Një herë, kur ai po ziente një supë, Esau erdhi nga fusha shumë i uritur dhe i tha Jakobit: "Të lutem, më lër të ha pak nga kjo supë e kuqe, sepse jam i lodhur." Jakobi iu përgjigj: "Më shit më parë parëbirninë tënde." Dinak dhe i shpejtë në mendime.

Çfarë ishte parëbirnia? Ajo i përkiste djalit më të madh, pra Esaut, dhe nënkuptonte një pjesë të dyfishtë të trashëgimisë së të atit pas vdekjes së tij. Djali i parëlindur bëhej kreu i familjes dhe në këtë mënyrë trashëgonte administrimin e pronës familjare dhe një autoritet të madh mbi anëtarët më të rinj të familjes. Ai merrte edhe bekimin e të atit në prag të vdekjes, gjë që e vendoste në një marrëdhënie më të afërt me Perëndinë.

Esaut nuk i interesonin çështjet serioze si p.sh. çfarë do të ndodhte pas vdekjes së të atit; ai donte vetëm diçka të atypëratyshme që t'i shuante urinë. "Ja, unë jam duke vdekur, - tha ai, - ç'dobi kam nga parëbirnia?" Por Jakobi e shtyu Esaun të bënte një betim përpara se t'i jepte supën. Kështu që ai u betua, dhe Jakobi i dha supën me thjerrëza dhe bukë, dhe ai e hëngri.

Në kapitullin 27, ky premtim në lidhje me parëbirninë fillon të vihet në zbatim. Isaku është plak dhe drita e syve po e lë. Duke mos ditur sesa ditë i kishin mbetur për të jetuar, ai thirri të parëlindurin e tij, Esaun, dhe i kërkoi të dilte e të kapte gjah, dhe pastaj t'i përgatiste një gjellë të shijshme nga ato që i pëlqenin, që ai ta hante si ushqim të shenjtë dhe pastaj të bekonte Esaun. Por gruaja e tij, Rebeka, po dëgjonte, dhe dërgoi Jakobin tek kopeja për të marrë dy keca në mënyrë që ajo të përgatiste një gjellë me to, ashtu siç i pëlqente Isakut. Rebeka e përgatiti gjellën, dhe Jakobi, me ndihmën e saj, u maskua si i vëllai, duke përdorur rrobat e Esaut që vinin erë fushe, dhe ia çoi gjellën të atit duke e gënjyer: "Jam Esau, i parëlinduri yt. Bëra siç më ke thënë. Tani çohu, ulu dhe fillo të hash nga gjahu im, me qëllim që shpirti yt të më bekojë."

Isaku dyshon edhe pse nuk shikon dot qartë. "Po si bëre që e gjete kaq shpejt, biri im?" – e pyeti Jakobin. Dhe në këtë moment, Jakobi bie edhe më poshtë: jo vetëm që mashtron, duke e zhvatur të vëllanë dhe duke gënjyer babanë e vet plak; por tani thyen njërin nga Dhjetë Urdhërimet dhe përdor emrin e Perëndisë kot. Ai thotë: "Sepse Zoti, Perëndia yt, bëri që të vijë tek unë."

A mendon se Perëndia mund ta bekojë ndonjëherë mëkatin, dhe të na japë sukses për shkak të tij? Por Jakobi po shpreh pikërisht këtë pretendim të

tmerrshëm.

Isaku pyet përsëri: “A je ti me të vërtetë biri im Esau?” Ai u përgjigj: “Po”. Kështu që Isaku e bekoj, dhe bekimin e tij të mrekullueshëm mund ta lexoni tek Zanafilla 27:27-29.

Sapo Isaku mbaroi së bekuari Jakobin me atë që, në fakt, duhet të kishte qenë bekim i Esaut, Jakobi u largua prej tij, ndërsa Esau u kthye nga gjahu. Ai përgatiti gjellën, ia solli Isakut dhe i tha me shpresë: “Çohu Ati im dhe ha nga gjahu i birit tënd, me qëllim që shpirti yt të më bekojë.” Isaku filloi të kuptojë se e kishin mashtruar, dhe kjo e bëri ta zinin të dridhura të forta. Ai e di që nuk mund ta kthejë mbrapsht bekimin e dhënë, edhe pse ia kishin marrë me mashtrim. Dhe Esau harroi se e kishte përçmuar parëbirninë e tij kur hëngri supën me thjerrëza. Ajo që u bë, u bë, dhe nuk mund të kthehej mbrapsht, dhe ai dha një ulërimë shumë të fortë dhe të hidhur.

“Ti do të jetosh me shpatën tënde dhe do të jesh shërbëtori i vëllait tënd.” – i tha Isaku. Parëbirnia i kishte humbur përgjithmonë, dhe tani ai e urreu të vëllanë, Jakobin, dhe vendosi që ta vriste pasi të vdiste Isaku. Këtë e tha me vete, por duhet ta ketë thënë me zë të lartë ose mund t’ua ketë thënë më vonë shokëve të vet, sepse Rebeka e mori vesh dhe iu përgjërua Jakobit që ai të ikte tek vëllai i saj Labani në Haran, në juglindje të Edesës së ditëve të sotme, në një degë të lumit Eufrat. Ai duhej të qëndronte atje derisa të kalonte zemërimi i Esaut, pastaj ajo do t’i çonte fjalë që ai të kthehej në shtëpi. Në fakt, ajo i rregulloi gjërat që vetë Isaku ta dërgonte atje për të kërkuar një grua, që të mos martohej me një të huaj, pra me një kananease vendase (vendi ku po banonin përkohësisht), dhe Jakobi shkoi tek shtëpia e dajës, Labanit.

Të gjitha këto gjëra na japin një pamje të pakëndshme të karakterit të Jakobit, por për habinë tonë, kur ai ndalon për të kaluar natën gjatë udhëtimit, duke fjetur jashtë me vetëm një gur si jastëk, Perëndia i flet: “Dhe ja, unë jam me ty dhe do të të mbroj kudo që të vesh, dhe do të sjell përsëri në këtë vend.”

Si mund të dojë Perëndia një njeri të tillë? Vërtet, si mund të të dojë Perëndia ty, ose mua, pas gjithë atyre gjërave që kemi bërë kundër tij dhe kundër njerëzve të tjerë – ndoshta edhe kundër vetë familjes sonë? Ky është një mister në karakterin e Perëndisë. Shkruhet se “Perëndia është dashuri”. Perëndia i bëri dhe disa premtime Jakobit:

- tokën ku je shtrirë do të ta jap ty dhe pasardhësve të tu

- pasardhësit e tu do të jenë si pluhuri i tokës, dhe ti do të shtrihesh në perëndim dhe në lindje, në veri dhe në jug
- dhe tërë familjet e tokës do të bekohen nëpërmjet teje dhe pasardhësve të tu.

Nga Jakobi erdhën judenjtë, dhe të tillë ishin mbreti Saul, David dhe Solomon; më vonë prej tyre erdhi Jezusi, Krishti. Judenjtë banojnë në tokën e Izraelit, ashtu siç i premtoi këtu Perëndia Jakobit; ata patën ditë të lavdishme nën sundimin e atyre mbretërve; nëpërmjet Mesisë të tyre, Jezu Krishtit, të gjitha familjet e tokës mund të marrin bekim, madje dhe bekimin e faljes dhe jetës së përjetshme. Perëndia i mban premtimet!

Por pavarësisht se Perëndia ishte me të, pavarësisht nga këto premtime të vërteta dhe të sigurta, Jakobin e prisnin ende kohë të vështira. Ai ra në dashuri me vajzën e Labanit, Rakelën, dhe pranoi t'i shërbente Labanit për shtatë vjet në shkëmbim të dorës së Rakelës për martesë. Labani pranoi – por natën e dasmës, ai i sjell vajzën e madhe, Lean, e cila kishte “sy të perënduar”, - na thotë Bibla. Ah! Tani Jakobi e di se ç'do të thotë të të mashtrojnë! Labani ia dha edhe Rakelën, në këmbim të premtimit të shtatë viteve të tjera shërbimi; pra Jakobi përfundoi me dy gra, por Rakelën e donte më shumë se Lean. Historia përsëritet: Jakobi vinte nga një familje ku mbahej ana e njërit ose tjetrit dhe tani ai po vendos anësinë e tij, e cila përmban të njëjtat të meta të rrezikshme.

Nuk është për t'u habitur që në shtëpinë e tij kishte grindje, njësoj siç kishte shkaktuar grindje ai në shtëpinë e mëparshme. Lean urrehej, por ajo i dha bij Jakobit. Rakela ishte shterpë, ziliqare, dhe i tha Jakobit: “Më bëj me fëmijë përndryshe unë po vdes.” Kjo gjë e zemëroi Jakobin me Rakelën, dhe ai vë në dukje, ndoshta pa takt, se është Perëndia ai që nuk lejon fryte nga barku i saj.

Jakobi punoi shumë për Labanin; siç u thotë grave të tij tek Zanafilla 31:6, “Dhe ju e dini se unë i kam shërbyer atit tuaj me tërë forcën time.” Ai pati sukses në punën e tij me kafshët e Labanit, dhe u pasurua shumë me kope të mëdha, deve, gomarë dhe shërbëtorë. Bijtë e Labanit filluan të ankoreshin: “Jakobi mori gjithçka kishte ati ynë.” Kështu që Labani, i vjehrrri, nuk e shikonte më me sy të mirë Jakobin. Nga ana tjetër, Jakobi mendonte se Labani nuk e kishte trajtuar drejt dhe tha se ai e kishte mashtruar dhe i

kishte ndryshuar pagat dhjetë herë gjatë njëzet viteve që i kishte shërbyer – katërmbëdhjetë vjet për vajzat e tij dhe gjashtë për kopetë.

Me një fjalë, kjo nuk ishte një histori e lumtur: mashtrime, komplete dhe grindje nga çdo anë, ndonëse kur kthen kokën pas, ai arrin të thotë: “Por Perëndia i atit tim ka qenë me mua.” (Zan. 31:5)

Në fund, Perëndia i foli përsëri: “Tani çohu, lëre këtë vend dhe ktheu në vendlindjen tënde.” Kështu që ai u nis, me familjen dhe bagëtinë e tij, për t’u kthyer në shtëpi, dhe në fund, siç thuhet tek Zanafilla 32, atë e priste gjatë rrugës një takim më i thellë me Perëndinë, një takim që do t’ia ndryshonte jetën përgjithmonë. Ja si ndodhi:

Së pari ai i dërgoi lajm më përpara vëllait të tij Esaut, i cili kishte dashur ta vriste, “për të gjetur hir në sytë e tu”. Ai donte të rivendoste paqen me vëllanë; nuk donte që të vritej! Lajmëtarët u kthyen tek Jakobi me lajmin se Esau po vinte, me katërqind burra. Jakobi u frikësua edhe u hidhërua – dhe ky njeri jo i perëndishëm lutet:

O Zot ... unë nuk jam i denjë i të gjitha mirësive dhe i gjithë besnikërisë sate që ke treguar ndaj shërbyesit tënd.

Sa shumë nevojë kemi të gjithë ne, me të vërtetë, që të arrijmë në të njëjtin konkluzion për jetën tonë! Pastaj lutja e tij vazhdon:

Çliromë, të lutem, nga duart e vëllait tim, nga duart e Esaut, sepse unë kam frikë nga ai dhe druaj që ai të vijë për të më sulmuar, pa kursyer as nënat as fëmijët.

Dhe pastaj i kujton Perëndisë premtimin e Tij:

Por ti the: ‘Patjetër, unë do të të bëj mirë dhe t’i bëj pasardhësit e tu si rëra e detit, që nuk mund të llogaritet se është shumë e madhe.’

Pastaj ai i dërgoi përpara dhurata pa kursim Esaut, dhe pastaj dërgoi gratë dhe fëmijët e tij përgjatë lumit ku po fushonin:

Kështu Jakobi mbeti vetëm dhe një burrë luftoi me të deri në agim. Kur ky burrë e pa se nuk mund ta mundte, i preku zgavrën e ijës; dhe zgavra e ijës së Jakobit u përdrodh, ndërsa ai luftonte kundër tij. Dhe ai i tha: ‘Lërmë të shkoj, se po lind agimi’. Por Jakobi iu përgjegj: ‘Nuk do të të lë të shkosh, në rast se nuk më bekon më parë!’. Tjetri i tha: ‘Cili është emri yt?’. Ai u përgjegj: ‘Jakob’. Atëherë ai i tha: ‘Emri yt nuk do të jetë më Jakob, por Israel, sepse ti ke luftuar bashkë me Perëndinë dhe me njerëzit, dhe ke fituar’. Jakobi i tha: ‘Të lutem, tregomë emrin tënd’. Por

ai iu përgjegj: ‘Pse e do emrin tim?’. Dhe kështu ai e bekoj. Atëherë Jakobi e quajti këtë vend Peniel, sepse tha: ‘E pashë Perëndinë ballë për ballë dhe jeta ime u fal’. Mbasi e kaloi Penielin, dielli po ngrihej; dhe Jakobi çalonte për shkak të ijës.

Ai luftoi me Zotin, dhe fuqia iu thye. A ndihesh ndonjëherë kështu? Fuqitë të lënë, ke arritur në fund të endjes sate, shkarjes nga besimi dhe mëkatit, të mungon forca për t’u kthyer tek Perëndia, dhe e vetmja gjë që mund të bësh është të kapesht pas tij dhe t’i thërrasësh: “Nuk do të lë të shkosh, në rast se nuk më bekon më parë.” Tani ai po çalonte për shkak të ijës. Po, mund të jetë e dhimbshme të kthehesh tek Perëndia; jo, nuk “mund të jetë” – *do të jetë* e dhimbshme. Nuk është e lehtë të kthehesh mbrapa, të heqësh dorë nga mëkati i dëshiruar, dhe të fillosh nga e para me Perëndinë. Por Perëndia e pranoi luftimin e Jakobit, sepse si në Dhiatën e Vjetër dhe në të Renë ai thotë: “E desha Jakobin” (Mal. 1:2; Rom. 9:13).

Kthimi tek Perëndia nuk do të thotë se tani gjithçka do të shkojë mirë në jetën tënde, se do t’i vijë fundi dhimbjes, pikëllimit dhe zhgënjimit, sepse Perëndia dërgon si diellin ashtu dhe shiun mbi të drejtin dhe të padrejtin, dhe njeriu lind në këtë botë për të patur telashe, ashtu si shkëndijat fluturojnë lart. Në mbretëri duhet të hyjmë duke kaluar përmes shumë pikëllimeve. Por ashtu si në rastin e Jakobit, edhe ne duhet të dimë se Perëndia është me ne, dhe asnjëherë nuk na lë, nuk na braktis.

Në shtatë kapitujt që vijojnë (33-49) Jakobi përjeton më shumë bekime – sigurisht që edhe ti do t’i përjetosh – dhe më shumë hidhërime – sepse është pjesa që na takon në këtë botë. Por në fund ai thotë:

Perëndia, para të cilit ecën etërit e mi Abrahami dhe Isaku, Perëndia që më ka ushqyer qysh prej lindjes sime deri më sot, engjëlli që më ka çliruar nga çdo e keqe.

Ku filluam? Filluam me ata që “kërkojnë fytyrën e Perëndisë së Jakobit” të cilët përmenden tek Psalmi 24:5-6. Psalmisti u premton atyre bekime, drejtësi dhe shpëtim nga Perëndia. Nëse jeta jote e shkuar, dhe ajo e tashme, i ngjajnë sadopak asaj të Jakobit, nëse ke qenë njeri i mëkatshëm, intrigant dhe i pakëndshëm, dhe jo çdo gjë të shkoi sipas planeve të tua, atëherë mund të kërkoksh të njëjtin Perëndi që gjeti dhe njohu Jakobi, dhe do të gjesh bekim, drejtësi dhe shpëtimin prej tij nëse e kërkon me sinqeritet, derisa ta gjesh.

Ka edhe një aspekt tjetër të kësaj historie që dua t'i kushtoni vëmendje, dhe ajo ka të bëjë me Esaun, të vëllanë. Esau kishte plotësisht të drejtë të zemërohej me Jakobin, ashtu si Perëndia ka të drejtë të zemërohet me mëkatarët. Për njëzet vjet Jakobi i qëndroi larg Esaut, ashtu si ne, kur shkasim nga besimi, mund të qëndrojmë një kohë të gjatë larg Perëndisë. Kur Jakobi e dinte se kishte ardhur koha të kthehej, ai kishte frikë nga zemërimi i Esaut dhe priste që Esau të hakmerrej. A ke frikë të kthehesh tani tek Perëndia, a druhash se ai do të të shohë vetëm me zemërim, dhe të të refuzojë për shkak të viteve të shumta me mëkat dhe mosbindje?

Prandaj, Jakobi u përpoq ta zbuste Esaun me dhuratat e tij. A shpreson se mund të bësh diçka (përveçse të të vijë vërtet keq dhe të ndryshosh mënyrën e jetës tani e tutje) që ta bësh Perëndinë më të gatshëm për të të pranuar? Që ta qetësosh pak? Që të zbusësh ose të paktën t'ia zvogëlosh zemërimin që ai ka për mëkatet e tua? Mund të përpiqesh, duke u sjellë mirë ose me anë të përkushtimit fetar, por të gjithë e dimë se këto nuk do të jenë dhe nuk mund të jenë kurrë të mjaftueshme.

Në fakt, ajo që ndodhi ishte se Jakobi nuk u përmbajt dot nga surpriza e lumtur:

Atëherë Esau vrapoi drejt tij, e përqafoi, iu hodh në qafë dhe e puthi; dhe që të dy qanë. (33:4)

Kjo është pikërisht mënyra sesi Perëndia na pranon kur kthehemi tek ai me pikëllim për gabimet tona dhe me vendosmëri që të fillojmë përsëri jetën e vërtetë të krishterë, nëse ai na ndihmon.

Kur Esau pa të gjitha dhuratat që Jakobi i ofroi për ta zbutur, ai tha: “Kam mjaft për vete, o vëllai im.” Edhe Perëndia shikon shpërblimin që Jezu Krishti pagoi për ne kur vdiq në Kalvar, dhe thotë: “Kam mjaft.” Zemërimi i Perëndisë është derdhur mbi Zëvendësuesin tonë në kryq, dhe është shuar. Ai është i kënaqur. Shlyerja e plotë është bërë. Nuk është e nevojshme që ta zbusësh përpara se të kthehesh: kjo është kryer tashmë për ty.

Dhe kështu Jakobi bën një deklaratë të habitshme, plot me të vërtetën e ungjillit. Ai i thotë Esaut: “kur pashë fytyrën tënde, për mua ishte njëlloj sikur të shikoja fytyrën e Perëndisë, dhe ti më ke pritur mirë” (vargu 10). Nëse kthehesh tek Perëndia nga hallakatjet dhe nga periudha e mëkatit, me pendim dhe dëshirë për t'u pastruar dhe për t'ia nisur nga e para, atëherë

Perëndia do të të pranojë, në mënyrë të ngjashme, me favor ashtu edhe me ngazëllim.

Ai do të marrë bekimet e Zotit dhe drejtësinë nga Perëndia e shpëtimit të tij. I tillë është brezi i atyre që kërkojnë, që kërkojnë fytyrën tënde, o Perëndi i Jakobit.

- Psalmi 24:5-6

Kapitulli 4 - Betheli

Kemi parë jetën dhe përvojën e Jakobit dhe kemi vënë re se ai kishte një karakter të mëkatshëm dhe të pakëndshëm. Ai ia punoi vëllait të vet; gënjeu babanë; përdori emrin e Perëndisë më kot. Kjo është njësoj si ne; jo se mëkatet tona janë domosdoshmërisht si të tijat, por “ne të gjithë endeshim si dele” dhe “të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë”.

Por kemi parë edhe – mister i mistereve! – se bekimi i Perëndisë ishte mbi të. Perëndia nuk e bekoj ngaqë ishte njeri i mirë, ose ngaqë meritonte dashurinë dhe hirin e Perëndisë; ai e bekoj për shkak të vendimit të vet që ta bënte këtë gjë, siç na thuhet me hollësi tek Romakët 9:10-16:

“Dhe jo vetëm kaq, por edhe Rebeka mbeti shtatzënë nga një njeri i vetëm, Isakun, atin tonë, (sepse para se t’i lindnin *fëmijët* dhe para se të bënë ndonjë të mirë a të keqe, që të mbetej i patundur propozimi i Perëndisë për të zgjedhur jo sipas veprave, por prej atij që thërret), iu tha asaj: ‘Më i madhi do t’i shërbejë më të voglit’, siç është shkruar: ‘E desha Jakobin dhe e urreva Esaun’. Çfarë të themi, pra? Mos *ka* padrejtësi te Perëndia? Aspak! Ai i thotë në fakt Moisiut: ‘Do të kem mëshirë për atë që të kem mëshirë, de do të kem dhembshuri për atë që do të kem dhembshuri’. Kështu, pra, kjo nuk varet as prej atij që do, as prej atij që vrapon, por nga Perëndia që shfaq mëshirë.”

Këtu lexojmë se “jo sipas veprave, por prej atij [Perëndisë] që thërret”, dhe është e sigurt se e njëjta arsye qëndron pas bekimit të Perëndisë për jetën tonë, nëse jemi fëmijët e tij:

Duke ditur, vëllezër të dashur prej Perëndisë, të zgjedhurit tuaj – 1 Thes. 1.4

Por ne duhet ta falënderojmë vazhdimisht Perëndinë për ju, o vëllezër të dashur nga Zoti, sepse Perëndia ju zgjodhi që në fillim [ose si besimtarët e parë] - 2 Thes. 2.13

Megjithatë, pavarësisht se Perëndia e zgjodhi Jakobin si dikë që do ta bekonte, Jakobi duhet të përjetonte një krizë, një pikë kthese në jetën e tij, një vendim që t’i dorëzohej Perëndisë. Kështu ndodh edhe me ne. Ne duhet

të kthehemi në besim; duhet të pendohemi dhe të besojmë ungjillin; duhet të pranojmë dhe t'i nënshtrohemi autoritetit hyjnor të Krishtit.

Tek Zanafilla 28 shohim Jakobin tek largohet nga shtëpia e tij në Beer-sheba dhe udhëton drejt Haranit. Kur ra nata, ai fjeti përjashta, duke përdorur për jastëk një gur që gjeti, dhe Perëndia i dha një ëndërr. Veprat 2:17 na thotë se ëndrrat janë një mënyrë me të cilën Perëndia u flet ndonjëherë njerëzve. Ai pa në ëndërr një shkallë nga toka deri në qiell, me engjëj që hipnin e zbrisnin në të. Ai pa në ëndërr edhe Zotin, dhe Zoti i foli. Në të njëjtën mënyrë, edhe kthimi ynë në besim, ose dorëzimi ndaj autoritetit hyjnor të Krishtit në jetën tonë, duhet të përfshijë një përvojë të brendshme dhe personale të Perëndisë. Kjo nuk është thjesht teori; ky është një ndërveprim personal me një Atë qiellor dhe një Shpëtimtar që kërkon jetën dhe shërbimin tonë .

Në ëndërr, Perëndia zbuloi diçka nga qëllimi që kishte për jetën e Jakobit: “Tokën në të cilën je shtrirë do të ta jap ty dhe pasardhësve të tu.” Ndodh shpesh që, kur Perëndia të flet dhe të thërret që ta dorëzosh jetën nën drejtimin e tij, në thirrjen e tij ai të jep edhe njëfarë ideje se ku do të të çojë jeta dhe puna jote. Këtu kemi një zbulesë mahnitëse! Kjo ngjarje ndodhi rreth 4000 vjet më parë, dhe Perëndia parashikon në të se pasardhësit e Jakobit, judenjtë, do të trashëgojnë tokën e Izraelit. Dhe sot, ata janë ende aty. Fjalët e Perëndisë janë të fuqishme dhe të sigurta.

Mund ta kemi më të lehtë t'i përgjigjeshim një drejtimi të caktuar sesa një thirrjeje më të përgjithshme për t'iu nënshtruar Krishtit si Zot, dhe mund të ndodhë që thirrja e Perëndisë për ty të ketë të bëjë thjesht me faktin nëse përgjigjja jote do të jetë “po” ose “jo” në lidhje me atë që ti e di se është vullneti i Perëndisë për jetën tënde. Por jo gjithmonë: mund të ndodhë që të të duhet t'i dorëzohesh plotësisht Krishtit si Zot, pa e ditur se ku do të të çojë. Sido që të jetë, duhet të vijë një krizë – ashtu siç i ndodhi Jakobit.

Një premtim tjetër që Perëndia i dha Jakobit në këtë kohë ndërveprimi të fortë dhe të rëndësishëm personal mes tyre ishte ky: “tërë familjet e tokës do të bekohen nëpërmjet teje dhe pasardhësve të tu.” Jezu Krishti erdhi në botë nëpërmjet pasardhësve të Jakobit, dhe ndërsa ungjilli i tij përhapet në të gjithë botën si një dëshmi për të gjitha kombet, po kështu fjalët e këtij premtimi po përmbushen vazhdimisht dhe gjithnjë e më gjerësisht. Nuk mendoj se ne dimë ndonjëherë gjithçka se ku do të çojë thirrja e Perëndisë për ne; por nëse kuptojmë qartë çfarë duhet të bëjmë – dhe pikërisht atë hap

tjetër që duhet të hedhim drejt bindjes – atëherë pjesën tjetër mund t’ia lëmë në duar Perëndisë. Ai do t’i zgjidhë gjërat, ndoshta përtej gjithçkaje që ne kërkojmë ose mendojmë.

Kishte edhe më tepër se kaq. Perëndia jo vetëm që dha premtime në lidhje me pasardhësit tokësorë dhe shpirtërorë të Jakobit – judenjtë dhe të krishterët – por ai gjithashtu dha me mirëbesim disa premtime personale për vetë Jakobin (vargu 15)

Unë jam me ty...

Do të të mbroj kudo që të vesh...

Do të të sjell përsëri në këtë vend

Nuk do të të braktis para se të bëj atë që të kam thënë.

Perëndia premton se do të jetë gjithmonë me secilin prej fëmijëve të tij kur ata ecin me të. Ai asnjëherë nuk do të na lërë dhe as nuk do të na braktisë.

Tani shih ndryshimin tek Jakobi – ashtu si do të ketë me siguri një ndryshim tek ty nëse takon Perëndinë dhe i përgjigjesh. Jakobi thotë: “Me siguri Zoti është në këtë vend dhe unë nuk e dija.” Tani ai e njeh Perëndinë më nga afër dhe më qartë sesa e njhte përpara kësaj kthese. Kështu ndodh edhe me ne ndonjëherë: arrijmë në një çast në jetë kur ndodh një takim i veçantë me Perëndinë – ndoshta në kishë, ndoshta kur jemi vetëm. Perëndia merr iniciativën dhe na afrohet, dhe na flet fuqishëm dhe qartë. Ne mund të stepemi; por nëse shkojmë përpara me Perëndinë, atëherë që këtë e tutje do ta njohim atë më mirë sesa më përpara, dhe do të ndjejmë se jemi më afër me të. Tani Jakobi ka një nderim më të thellë dhe një vetëdije më të gjallë për gjërat shpirtërore: “Sa i tmerrshëm është ky vend! Kjo nuk është tjetër veçse shtëpia e Perëndisë, dhe kjo është porta e qiellit.”

Sa mirë dhe sa e shëndetshme është kur nderimi ynë për Perëndinë dhe për gjërat që kanë të bëjnë me të thellohet. Bëjmë një hap të bekuar përpara kur papritur bëhemi më të vetëdijshëm për të vërtetat shpirtërore.

Asnjë prej këtyre nuk e përjashton aspektin tjetër të jetës sonë shpirtërore: këmbënguljen graduale në përkushtim, bindje dhe rritje shpirtërore. Ecja jonë e përditshme me Perëndinë është po aq jetike sa edhe momentet e veçanta që Perëndia na dërgon në mënyrë të hirshme; në fakt, ato ndoshta janë më të rëndësishmet, sepse formojnë sfondin e sinqertë kundrejt të cilit vijnë thirrjet dhe momentet e veçanta.

Mëngjesin tjetër, Jakobi mori gurin që e kishte përdorur si jastëk, e vuri si përmendore dhe i hodhi përsipër vaj, dhe e quajti vendin Bethel, që do të thotë Shtëpia e Perëndisë (më përpara vendi njihet me emrin Luc). Vëreni këtë gjë: ai ishte i vendosur ta mbante mend, dhe ndërmori këtë hap për t'u siguruar se do ta bënte. Dhe në fakt e mbajti mend! Kjo ishte një ngjarje që ai nuk e harroi kurrë, dhe vite më vonë kur po vdiste tha (48:3): “Perëndia i plotfuqishëm m'u shfaq në Luc, në vendin e Kananit, më bekoj.”

Miku im, lexuesi im, bashkëbesimtari im: merr hapa që të mbash mend thirrjen e Perëndisë, atë çast kur ai të afroi dhe të foli qartë në jetë, duke të thirrur që ta njihje dhe t'i bindeshe. Ruaj fotografi të vendit ku ndodhi kjo gjë; mbaj një ditar, tregoj miqve dhe sigurohu që ata ta dinë se ky është një çast që nuk duhet harruar kurrë; por sido që ta bësh, mos harro çastin kur u takove me Perëndinë! Bëhu si Jakobi: kur të vdesësh, kthehu mbrapa tek ai çast, dhe ngazëllohu me paqen që i the *Po* Perëndisë në atë ditë tepër të rëndësishme.

Dhe tani Jakobi bën një betim se, nëse Perëndia do t'i mbajë këto premtime personale për jetën e tij, “atëherë Zoti do të jetë Perëndia im”. Kjo do të thotë t'i besosh Perëndisë dhe t'i bindesh atij. Gjithashtu ai premtoi se do t'i jepte Perëndisë një të dhjetën e gjithçkaje që ai do t'i jepte. Perëndia na thërret që t'ia dorëzojmë financat tona atij ashtu si edhe pjesën që na ka mbetur nga jeta jonë. Shpesh thuhet se “pjesa e fundit që shpëtohet tek njeriu është xhepi.” Kjo mund të jetë thjesht një thënie kot, por mos lejo që e vërteta që gjendet ndonjëherë në të, të jetë e vërtetë për ty. Beso, bindu, jep; lejoje Perëndinë të jetë Perëndia yt.

Së fundi, nuk ishte vetëm Jakobi ai që e mbante mend atë natë jetike: edhe Perëndia e vuri re dhe e mbajti mend përgjigjen e Jakobit. Njëzet vjet më vonë... një çast: sa vjeç do të jesh pas njëzet vjetësh? A do të jesh në gjendje, që të kthehesh te ky çast i jetës sate, dhe të dish se ti dhe Perëndia e shikoni si kohën kur u afrove me Perëndinë dhe e bërë Perëndinë tënd?

Njëzet vjet më vonë (31:13) Perëndia i foli përsëri Jakobit: “Unë jam Perëndia i Bethelit, ku ti ke vajosur një përmendore dhe më lidhe një kusht.”

Sa ndryshim i madh! Nga një karakter i mëkatshëm dhe i pakëndshëm, filloi të bëhej një njeri të cilin Perëndia e ndryshoi dhe e bekoj gjatë gjithë këtyre viteve. Ashtu qoftë edhe me ty edhe me mua!

Kapitulli 5 - Tamari

Ky kapitull shqyrton një shembull sesi Perëndia i shikon burrat dhe gratë që janë armiqtë e tij, dhe mënyrën sesi dëshiron t'i trajtojë. Gjithçka filloi kur lexova Zanafillën 38 gjatë kohës personale që kaloj përditë duke lexuar Biblën – dhe nuk nxora asgjë prej saj! Vendosa se duhet të mendoja përsëri mbi kapitullin, dhe këto janë mendimet që më erdhën. Shpresoj që t'ju ndihmojnë edhe juve.

Vargjet 1-10 na tregojnë historinë e dy vëllezërve të quajtur Er dhe Onan. Eri ishte më i madhi, dhe ishin bijtë e Judës, një nga bijtë e Jakobit, për të cilin lexuam në kapitujt 3 dhe 4. Juda zgjodhi një grua të quajtur Tamari si grua për Erin. Por Eri “ishte i keq në sytë e Zotit, dhe Zoti e bëri të vdesë” (v. 7). Nuk na thuhet se ç’formë kishte ligësia e tij, dhe nuk ka shumë rëndësi për historinë; por ajo që ka rëndësi është se ai e la gruan e tij, Tamarin, të ve dhe pa fëmijë.

Sipas ligjit të Moisiut (LiP. 25:5-10), nëse një burrë vdiste pa lënë fëmijë, vëllai i tij duhej të martohej me të venë dhe të lindte pasardhës për vëllanë e vdekur. Ndonëse kjo praktikë ishte përfshirë formalisht në ligjin e dhënë nga Moisiu, ajo kishte ekzistuar edhe përpara kohës së tij. Këtë praktikë e gjejmë jo vetëm në këtë kapitull të Biblës, por gjurmë të saj gjenden edhe mes indianëve dhe persianëve të lashtë, dhe gjithashtu është praktikuar edhe mes tartarëve, afganëve dhe abisinaseve.

Mes judenjve, kjo detyrë i takonte vëllait më të madh, pra megjithëse ishte edhe një vëlla tjetër, Shelahu, Juda i tha Onanit: “Shko tek gruaja e vëllait tënd, martohu me të dhe krijoi trashëgimtarë vëllait tënd.” Megjithatë, Onani nuk pranoi. Bibla nuk na thotë pse, por me siguri që Onani e dinte se fëmijët nuk do të ishin të tijtë, dhe çdo djalë që Tamari do të lindte prej tij, do të vlerësohej ligjërisht si bir i Erit, dhe kështu do të eliminonte mundësitë e Onanit për të trashëguar pjesën e Erit nga pronësia e familjes. Ndoshta kjo ka qenë arsyeja: sidoqoftë, ai refuzoi detyrën që kishte ndaj të vëllait.

Thuhet: “E hidhte farën e tij përtokë ... kjo nuk i pëlqeu Zotit.” Këtë pasazh ndoshta mund ta dëgjoni të përdoret si tekst kundër planifikimit familjar, duke nxjerrë si përfundim se Perëndia nuk e pëlqen planifikimin

familjar. Por ky është një keqpërdorim i tekstit: arsyeja pse Perëndia nuk ishte i kënaqur me Onanin ishte se ai nuk pranoi të siguronte fëmijë për vëllanë e tij të vdekur. Kështu që Zoti “e bëri të vdesë edhe atë” (v. 10).

Perëndia nuk i vret shumë shpesh të këqijtë, përkundrazi, ai i mbledh mëkatet e tyre deri në ditën e gjykimit. Por ndonjëherë edhe i vret: një rast tjetër është ai i Ananias dhe Safirës tek libri i Veprave. Asnjëherë nuk është e drejtë ose e mençur të bësh lojëra me Perëndinë, ose të mëkatosh duke menduar se ai do të të lejojë të shpëtosh pa u lagur. Të jesh i sigurt se mëkati yt do të të gjejë, qoftë në këtë jetë apo në ditën e gjykimit. 1 Timoteu 5:24 na thotë se mëkatet e disa njerëzve duken sheshit, edhe përpara gjyqit, por mëkatet e të tjerëve shfaqen më pas. Romakët 15:4 dhe 1 Korintasve 10:11 na tregojnë se tregimet e Dhiatës së Vjetër janë shkruar për të na udhëzuar dhe paralajmëruar. Siç shkroi Ælfrici, “Ic þohte þæt ge woldon þurh þa wundorlican race eower mod awendan to Godes willan on eornost” [Synimi im ishte që, me anë të rrëfimit të mrekullueshëm, të dëshironit ta kthenit zemrën plotësisht drejt vullnetit të Perëndisë.]

Megjithatë më poshtë vijojnë diisa vargje të shkrimit që tregojnë për atë që Perëndia i bën ndonjëherë të ligut:

Mallkimi i Zotit është në shtëpinë e të pabesit, por ai bekon banesën e të drejtëve. – Fjalët e Urta 3:33

Lum ai njeri që ka frikë vazhdimisht nga Zoti, por ai që e fortëson zemrën e tij do të bjerë në fatkeqësi. - Fjalët e Urta 28.14

Njeriu që fortëson qafën kur qortohet, do të thyhet papritmas pa tjetër. - Fjalët e Urta 29.1

Dhe këto fjalë nga Romakët 12:19 (“Mos u hakmerrni për veten tuaj, o të dashur, por i jepni vend zemërimit të Perëndisë, sepse është shkruar: ‘Mua më takon hakmarrja, unë kam për të shpëguar.’ - thotë Zoti.”) janë një deklaratë e hapur sesi Perëndia vepron me njeriun e lig të papënduar.

Nga kjo mund të mësojmë të paktën tre gjëra:

- Nuk duhet të luajmë me mëkatin
- Nuk duhet të hakmerremi vetë kundër të tjerëve: kjo është e drejta e posaçme e Perëndisë
- Nuk duhet të druajmë se mos nuk ka drejtësi në univers, dhe se mos njerëzit që mëkatojnë ndaj të tjerëve do të lejohen të shpëtojnë pa u lagur.

Por të kthehemi tek historia e Zanafillës 38. Juda kishte frikë se mos edhe vëllai i tretë, Shelah, nuk do të pranonte detyrën si kunat dhe nuk do të martohej me Tamarin, dhe që të mos rrezikonte, në vend që t'i thoshte Shelahut të merrte Tamarin, ai i thotë Tamarës që të kthehet tek shtëpia e të atit “derisa biri im Shelah të rritet”. Ky ishte një mashtrim: ai i tha Tamarës se kthimi i saj te shtëpia e babait ishte vetëm e përkohshme por Juda kishte ndërmend që ajo të rrinte përgjithnjë atje. Ai do që ta heqë qafe atë dhe detyrimet familjare ndaj saj. Ai mendon se mund t’ia punojë si Tamarit ashtu dhe Perëndisë. Ndonjëherë, ne gjejmë mënyra – apo jo? – për të mëkatuar me vetëdije dhe mendojmë se mund të shpëtojmë pa u lagur duke e vendosur Perëndinë në një pozicion ku ai s’mund të bëjë asgjë (ose të paktën kështu mendojmë). Ligji i Përtërirë 6:16 thotë: “Nuk do të tundoni Zotin.” Pikërisht këtë gjë bëjmë kur veprojmë ashtu. Harrojmë se Perëndia është Perëndi, dhe kërkon që t’i bindemi; ose e heqim këtë gjë nga mendja.

Por Juda nuk shpëtoi pa u lagur! Me kalimin e kohës, pasi Shelahu ishte bërë burrë, Juda shkoi të vizitonte një mik që jetonte afër Tamarit, dhe ajo e mori vesh se ai po vinte. Tani ia punoi *ajo*.

Ajo i hoqi rrobat e vejërisë, vuri një shami, u mbështoll e tëra dhe shkoi e u ul “te porta e Enaimit”, që ishte rrugës ku po vinte Juda. Kur Juda e pa mendoi se ajo ishte një prostitutë, dhe ai dëshironte ta përdorte si të tillë, pa e ditur se ajo ishte nusja e djalit. Përpara se të pranonte, ajo bëri një marrëveshje me të: ai do t’i jepte një kec nga tufa, dhe si peng i dha vulën, kordonin dhe shkopin e vet. Ai ia dha këto pengje dhe ajo e lejoi që ta përdorte si prostitutë. Pastaj u largua, akoma e veshur me shaminë. Dhe, ashtu siç ajo shpresonte, ai e la shtatzënë.

Juda e mori kecin e premtuar nga miku ku kishte shkuar për vizitë dhe u përpoq t’ia dërgonte “prostitutës” që punonte “tek porta e Enaimit”, por sigurisht që nuk e gjeti dot. “Nuk ka pasur asnjë prostitutë këtu” - i thanë.

Më tej, shikojmë diçka më të thellë përse i përket karakterit dinak të Judës, standardeve të tij të dyfishta dhe shfaqjes së vetë-drejtësisë. Sa tipare të shëmtuara! Rreth tre muaj më vonë Judës i thonë se Tamari është bërë prostitutë dhe si rrjedhojë ka ngelur shtatzënë, “Nxirreni jashtë dhe digjeni.” – thotë ai. A ke ndonjëherë standarde të tilla të dyfishta kur vepron me njerëz të tjerë? Ai s’e kishte problem të përdorte një prostitutë, por ama mendonte se një prostitutë që i përkiste familjes së tij duhej të digjej: një standard për veten, dhe një tjetër më të lartë për të tjerët.

Tamari i çoi fjalë Judës, bashkë me vulën, kordonin dhe shkopin që ai i kishte dhënë si peng për kecin. “Njeriu të cilit i përkasin këto sende, më la me barrë.” Më së fundi, ai e pranoi fajin: “Ajo është më e drejtë se unë, se unë nuk ia dhashë Shelahut, birit tim.”

Ajo lindi djem binjakë, Perezin dhe Zerahun. Perezi ishte paraardhës i drejtpërdrejtë i Jozefit, gruaja e të cilit, Maria, lindi shpëtimtarin tonë Jezu Krisht, dhe i cili rriti Zotin tonë si babai i tij tokësor. Këtë e shikojmë tek Mateu 1:1-3.

Dua të bëj disa komente në lidhje me dy personazhet kryesore të kësaj historie: Judën dhe Tamarin. Kemi parë mëkatet dhe mashtrimet e Judës. Pamë edhe padrejtësitë që iu bënë Tamarit. Ashtu si Juda, edhe ti je mëkatar, njësoj si unë; si Tamari, ndoshta njerëzit kanë bërë padrejtësi edhe kundër teje – kjo më ka ndodhur edhe mua.

Megjithatë, mëshira erdhi në botë edhe nëpërmjet kësaj historie të trishtë tek Zanafilla 38. Qëllimi i Perëndisë u krye pavarësisht nga mëkatet dhe mashtrimet e Judës, dhe pavarësisht nga padrejtësitë që iu bënë Tamarit. Dhe qëllimi i Perëndisë do të kryhet në jetën tënde, pavarësisht nga mëkatet e shkuara dhe të tashme, me kusht që tani të kthehesh tek ai me pikëllim dhe pendim, dhe të fillosh të ecësh me të.

Dhe ji i sigurt se qëllimi i Perëndisë do të kryhet në jetën tënde dhe nëpërmjet saj, pavarësisht nga padrejtësitë që të bëjnë njerëzit – mënyra sesi të mashtrojnë dhe të përdorin ligësisht – nëse i beson atij.

Kapitulli 6 - Manasi

A ka kuptim emri yt? I imi po: “David” do të thotë *i dashuri*, dhe është një emër i bukur. Në fakt prindërit e mi zgjodhën këtë emër sepse kam lindur ditën e Krishtlindjes, dita kur festojmë lindjen e Shpëtimtarit tonë në Betlehem, qyteti i Davidit. Në fakt, shpesh bëhem kurioz për arsyen se pse prindërit zgjedhin emra të veçantë për fëmijët e tyre.

Një njeri në Bibël quhej Manas, që do të thotë “bëj që të harroj”, njësoj sikur një djalë shqiptar të quhej Harrim. Pse i vunë Manasit një emër kaq të pazakontë?

Jozefi ishte babai i tij, dhe Perëndia e bëri Jozefin të harrojë dy lloj gjërash: të këqijat dhe të mirat. Gjatë leximit, mendoj se do të shikoni që Perëndia, në mirësinë e tij, bën që edhe ne të harrojmë gjërat. Së pari do të shikojmë gjërat e këqija që Jozefi harroi, të cilat i quan “çdo shqetësim”. Ato kanë të bëjnë me vëllezërit e tij, gruan e zotërisë dhe një kupëmbajtës; kanë të bëjnë përkatësisht me mizorinë, gënjeshttrat dhe mosmirënjohjen e tyre.

Të Vëllezërit

Jozefi ishte djali i preferuar i të atit, Jakobit. Do të donim të mendonim se Jakobi do të kishte pasur aq mend sa të mos bënte dallime mes djemve, duke pasur parasysh të gjitha telashet që i shkaktuan anësitë e vetë prindërve të tij në jetë: për të mos përmendur trajtimin favorizues që gjyshi i tij, Abrahami, i bëri Isakut kundrejt Ismaelit. Edhe në ditët e sotme, duket se ndonjëherë përsëritet e njëjta marrëzi në familjet tona brez pas brezi. Jozefi ishte djali i madh i dy bijve të lindur nga Rakela, bashkëshortja (siç e mbani mend nga kapitulli 3) që Jakobi e donte me të vërtetë. Por vëllezërit e urrenin Jozefin për shkak të preferencës së të atit, dhe rrallë, për mos të thënë kurrë, i flisnin mirë të vëllait.

Jozefi filloi të shikonte ëndrra që nënkuptonin se një ditë ai do të sundonte mbi vëllezërit, ndonëse ata ishin më të mëdhenj. Kjo nuk ishte aspak e keqe: në fund të fundit, ishte e vërtetë, dhe Perëndia po i tregonte që tani diçka nga ajo që e priste gjatë viteve të mëvonshme. Por ndonjëherë nuk është gjë e mençur t’ua tregosh me zë të lartë shumë njerëzve atë që të ka

garantuar Zoti në fshehtësinë e zemrës. Kur u tregoi vëllezërve, ata i thanë: “A duhet të mbretërosh ti mbi ne?” (Zan. 37:8).

Një ditë, kur vëllezërit e tij po kullotnin kopenë afër Sikemit, Jakobi e dërgoi Jozefin që të merrte lajme sesi po shkonin gjërat me ta dhe me kopenë. Ata kishin shkuar në Dothan, dhe pasi i kërkoi, Jozefi i gjeti. Ata e panë Jozefin që po vinte që nga larg, dhe ranë dakord që ta vrisnin - kaq e fortë ishte zilia dhe urrejtja që kishin kundër tij. Ata planifikuan ta vrisnin, t’ia hidhnin trupin në një pus, dhe t’i thoshin të atit që një kafshë e egër e kishte vrarë. “Kështu do të shohim se ç’përfundim do të kenë ëndrrat e tij.” Por sigurisht që ata nuk mund të pengonin qëllimin dhe punën e Perëndisë! Asnjëri nuk e bën dot.

Në shpirtin e Rubenit, vëllait më të madh, kishte ca mirësi. Ndoshta, si më i madhi, ai pati një ndjenjë përgjegjësie: në fund të fundit, ai priste që një ditë të bëhej kreu i familjes. Ai tha: “Mos derdhni gjak, por hidheni në këtë pus të shkretëtirës, dhe mos e goditni me dorën tuaj.” Ai kishte ndërmend që të kthehej më vonë e ta shpëtonte, dhe ta çonte tek i ati. Kështu, ata ia morën veshjen Jozefit – një veshje të veçantë që Jakobi i kishte bërë dhuratë – dhe e hodhën në pus. Pusi ishte bosh, nuk kishte ujë në fund.

Për habi, dhe në mënyrë të pashpirt, të gjithë përveç Rubenit u ulën pastaj për të shijuar ushqimin. Rubeni ishte larguar nga grupi për pak kohë, me siguri duke pritur të shpëtonte Jozefin. Ndërsa po hanin, u afrua një karvan ismaelitësh, tregtarë që transportonin erëza, balsame dhe mirrë për në Egjipt. Atëherë, Juda (të cilin e takuam në kapitullin e mëparshëm) sugjeroi që mos ta vrisnin Jozefin por t’ia shisnin tregtarëve. “Ç’dobi do të kemi po të vrasim vëllain tonë? – pyeti ai. Edhe atij i kishte mbetur një fije ndërgjegje, sepse shtoi: “Dhe të mos e godasë dora jonë, sepse është vëllai.” Vëllezërit e tjerë e pranuan këtë ide, e nxorën Jozefin nga pusi dhe ia shitën tregtarëve për njëzet monedha argjendi. Dhe ismaelitët e morën Jozefin në Egjipt.

Rubeni u tmerrua kur u kthye tek pusi dhe nuk e gjeti Jozefin, dhe u bërtiti vëllezërve: “Po unë, ku do të shkoj unë?” Padyshim me këtë nënkuptonte se i ati do ta fajësonte atë për zhdukjen e vëllait të vogël. Ata ranë dakord që të vrisnin një cjaq dhe ta lyenin rrobën e Jozefit me gjak, dhe t’ia tregonin Jakobit, i cili, kur e pa, arriti (ashtu siç kishin dashur ata) në këtë përfundim: “Me siguri Jozefin e kanë bërë copë e çikë.” Dhe nuk gjente ngushëllim.

Jozefin e shitën si skllav tek Potifari, oficer i faraonit, madje kapiten i trupprojës së faraonit.

Ç'mizori!

Gruaja e të Zotit

Kapitulli tjetër i Zanafillës na tregon historinë e Tamarit, dhe pastaj kapitulli 39 vazhdon përsëri historinë e Jozefit.

Mund ta përmbledhim shumë thjesht. Perëndia ishte me Jozefin – ashtu siç është me popullin e tij edhe sot e kësaj dite, edhe në rrethana të mjerueshme. Perëndia i dha sukses dhe gjithçka që ai bënte i ecte mbarë. Kështu që Potifari e bëri mbikëqyrës në shtëpinë e tij; e vuri në ngarkim të gjithçkaje që kishte.

Jozefi ishte i ri dhe i pashëm, dhe gruaja e Potifarit ndihej shumë e tërhequr prej tij. Ajo i kërkoi që të bënte seks me të, por ai nuk pranoi, si nga respekti për Potifarin, ashtu edhe nga frika e Perëndisë: “Si mund ta bëj unë këtë të keqe të madhe dhe të kryej një mëkat kundër Perëndisë?” Por ajo i bënte presion çdo ditë Jozefit, derisa një ditë e kapi prej rrobave dhe u mundua ta tërhiqte pas vetes. Por ai i la rrobën në dorë dhe iku nga shtëpia.

Tani, ajo u ndje e përbuzur, e zemëruar dhe donte të merrte hak. Kështu, thirri burrat e shtëpisë dhe u tha se Jozefi kishte dashur të bënte seks me të, por ajo kishte bërë titur shumë dhe ai ishte larguar, duke lënë pas rrobën e vet.

Kur i tha Potifarit, që me sa duket nuk njohte mirë as gruan as skllavin, ai i besoi asaj dhe burgosi Jozefin, dhe Jozefi qëndroi aty për më shumë se dy vjet.

Mashtrime!

Kryekupëmbajtësi

Bashkë me Jozefin në burg ishte edhe kryekupëmbajtësi i Faraonit, i cili kishte ofenduar Faraonin për diçka që nuk na thuhet. Kryekupëmbajtësi pa një ëndërr, dhe Jozefi ia interpretoi:

Në krye të tri ditëve Faraoni do të të bëjë të ngresh përsëri kokën lart, do të të rivendosë në detyrën tënde dhe ti do t'i japësh në dorë kupën faraonit, siç bëje më parë, kur ishe kupëmbajtësi i tij. Por më kujto mua kur të jesh i lumtur, të lutëm trego dashamirësi ndaj meje, duke i folur për

mua faraonit, dhe më nxirr nga kjo shtëpi; sepse... s'kam bërë gjë për t'u futur në këtë burg të nëndheshëm.”

Dhe vërtet, interpretimi doli i saktë, dhe kryekupëmbajtësin e rivendosën në detyrë. Por ai e harroi Jozefin, dhe nuk ia përmendi asnjëherë faraonit për dy vjet.

Çfarë mosmirënjohjeje!

* * *

Dhe megjithatë më vonë Jozefi tha: “Perëndia bëri që të harroj çdo shqetësim timin” (41:51). Si na bën Perëndia të harrojmë gjërat që është mirë t'i harrojmë? Në tri mënyra:

- natyra
- providenca
- hiri

Nga ana natyrore, ai na ka krijuar në një mënyrë të tillë që mendja jonë zakonisht i pakëson ose i filtron kujtimet e pakëndshme. Njoh një njeri në Krishtin, që e la gruaja për një tjetër, dhe atij iu desh jo vetëm të duronte turpin e këtij veprimi, por edhe ndjenjën e boshllëkut jashtë vetes në shtëpinë bosh, e cila i shqyente shpirtin. Kur ajo u kthye, tre vjet më vonë, ajo periudhë kohore s'iu duk asgjë, dhe i kujtoheshin shumë qartë miqtë e rinj dhe aktivitetet e reja që kishte bërë me ta gjatë atyre viteve. Kjo është mirësia e Perëndisë që vepron në krijim, në natyrën njerëzore që na ka dhënë.

Perëndia, në providencën e tij, shpesh i ndryshon gradualisht rrethanat tona, duke na çuar drejt kullotave dhe përvojave të reja. Tek Zanafilla 41:41, faraoni i ka njohur kaq mirë aftësitë e Jozefit sa thotë: “Shiko, unë të emëroj mbi gjithë shtetin e Egjiptit.” Pra, si të thuash, ai u bë kryeministër. Më vazhdim të kapitullit shikojmë që ai shijon një martesë të lumtur me një grua egjiptiane, dhe ka dy djem. Të parëlindurin e tij e quajti Manasi – Harrim – “bëri që të harroj”: “Sepse Perëndia bëri që të harroj çdo shqetësim timin.”

Në aspektin e hirit, Perëndia na bën thirrje që të falim dhe të harrojmë kur të tjerë na kanë bërë padrejtësi.

Ju keni dëgjuar se qe thënë: ‘Duaje të afërmin tënd dhe urreje armikun tënd’. Por unë po ju them: ‘Duani armiqtë tuaj, bekoni ata që ju

mallkojnë, u bëni të mirë atyre që ju urrejnë, dhe lutuni për ata që ju keqtrajtojnë dhe ju përndjekin. - Mateu 5:43-48

Sepse në qoftëse ju ua falni njerëzve gabimet e tyre, Ati juaj qiellor do t'ju falë edhe juve; por në qoftë se ju nuk ua falni njerëzve gabimet e tyre, as Ati juaj nuk do t'ua falë juve gabimet tuaja. - Mateu 6:14-15

Kur vëllezërit e Jozefit u detyruan së fundi të vinin në Egjipt në kërkim të grurit për shkak të zisë së bukës, Jozefi u tha: “Afrohuni pra tek unë! Unë jam Jozefi vëllai juaj... Por tani mos u trishtoni dhe mos t’ju vijë keq që më shitët me qëllim që të çohesha këtu poshtë; sepse Perëndia më ka dërguar para jush për të ruajtur jetën tuaj... Nuk jeni ju, pra, që më dërguat, por është Perëndia.” Më vonë ai u tha: “Ju keni kurdisur të këqijat kundër meje, por Perëndia ka dashur që t’i shërbejë së mirës.”

Këto ishin gjërat e këqija që Perëndia e bëri Jozefin t’i harronte; cilat ishin ato të mirat që përmenda më parë? Sepse Jozefi thotë: “Sepse Perëndia bëri që të harroj çdo shqetësim timin dhe *tërë shtëpinë e atit tim.*” (Zan. 41:51) Në shtëpi kishte gjëra të mira që ai humbi, por kishte edhe gjëra të mira që mund t’i kishte pasur, por që kurrë nuk i pati, nëse do të kishte qëndruar me familjen.

Zanafilla 30:1 na tregon sesa me këmbëngulje e kishin dashur prindërit Jozefin përpara se ai të lindte. Është një privilegj i çmuar, që është e pamundur t’ia llogaritësh vlerën, kur je një fëmijë që mezi e presin të lindë dhe një fëmijë që sjell gëzim. Dhe i tillë ishte Jozefi.

Pastaj, deri në moshën 17 vjeçare, përpara se të shitej, të dy prindërit e donin, dhe tek Zanafilla 33:2 shikojmë të atin që siguron mbrojtje të veçantë për të dhe Rakelën - të ëmën.

Si djali i një familjeje që kulloste dhen, ai punonte në një ambient të sigurt, të shëndetshëm dhe të begatë.

Ai i humbi të gjitha këto gjëra kur vëllezërit e shitën si skllav. Por ai arriti në pikën ku mundi të thoshte: “Perëndia më bëri që të harroj.” Në jetën tonë, ka momente kur duhet t’i harrojmë gjërat e mira që Perëndia na ka marrë, dhe të pranojmë me besim dhe mirënjohje rrethanat e reja nëpër të cilat na drejton ai, ku ai dëshiron që ne të shkëlqejmë për lavdinë e tij.

Nëse Jozefin nuk do ta kishin shitur si skllav, ai do të ishte rritur dhe do të kishte zënë vendin e vet në vazhdimësinë e familjes. Ndonjëherë ne duhet t’i harrojmë ambiciet dhe të ardhmen e papërmbushur, dhe ashtu si Jozefi,

duhet të drejtohem prej Perëndisë në rrethana të reja, të ndryshme dhe të papritura. Në fakt, Perëndia u përfshi në mënyrë aktive që në momentin që u ngjiz dhe lindi Jozefi, dhe po kështu është i përfshirë edhe me ne, sepse është shkruar se Perëndia u kujtua edhe për Rakelën dhe e bëri të frytshme (30:22). Perëndia qëndroi me Jozefin që nga fillimi deri në fund të jetës, duke i dhënë, në kohën e duhur, punë që i jepte kënaqësi dhe vlerë (veçanërisht gjatë zisë së bukës kur ai shpëtoi shumë jetë njerëzish), një jetë familjare të lumtur, dhe së fundi – atë koncept të çuditshëm të Biblës – një vdekje të mirë. Ai jetoj aq sa pa stërnipërit dhe stërmbesat me anë të Manasit, dhe ndoshta edhe një brez më shumë të pasardhësve nga djali tjetër, Efraimi (Zan. 50:23). Kur vdiq, ai ishte kaq i afërt me Perëndinë, sa ishte në gjendje të shpallte një profeci të vërtetë nga Fryma e Shenjtë, dhe ra në paqe me premtimin për një varrosje të denjë në vendin e lindjes. Kjo është vdekje për së mbari.

Një harresë e tretë

Por nuk harrojmë vetëm ne, por edhe Perëndia na jep një premtim të fortë se ai vetë do t'i harrojë disa gjëra të caktuara; ai premtonte se do të harrojë mëkatet tona:

Dhe nuk do t'i kujtoj më mëkatet e tyre dhe paudhësitë e tyre. - Hebrenjve 10:17

Sepse unë do të jem i mëshirshëm për paudhësitë e tyre dhe nuk do të kujtoj më mëkatet e tyre dhe keq bërjet e tyre. - Hebrenjve 8:12

Ata nuk do të mësojnë secili të afërmin e tij dhe secili vëllanë e tij, duke thënë: 'Njihni Zotin!', sepse të gjithë do të më njohin, nga më i vogëli e deri te më i madhi, - thotë Zoti. – Sepse unë do ta fal paudhësinë e tyre dhe nuk do ta kujtoj më mëkatet e tyre. - Jeremia 31:34

Unë, pikërisht, unë, jam ai që për hir të vetvetes fshij shkeljet e tua dhe nuk do t'i mbaj mend mëkatet e tua. - Isaia 43:25

Mund të të duket e vështirë të harrosh mëkatet, dhe ato mund të të shqetësojnë për vite të tëra edhe pasi i ke rrëfyer plotësisht dhe ke parë që Shpëtimtari yt Jezu Krisht i mori në kryqin e Kalvarit. Por nëse Perëndia i ka harruar, ka ardhur koha që t'i harrosh edhe ti – t'i lësh aty ku e kanë vendin: në të shkuarën dhe plotësisht të falura. Patjetër që je hidhëruar për mëkatet që ke bërë, i ke rrëfyer dhe i ke besuar Perëndisë për faljen, e cila është blerë me anë të gjakut që Krishti derdhi për të gjitha mëkatet tona.

Duhet t'i kesh kthyer kurrizin atyre mëkateve, për aq sa ke në dorë, dhe nëse i ke bërë keq dikujt tjetër kur ke mëkatuar, atëherë duhet t'i kërkosh falje (nëse është ende gjallë dhe mund ta kontaktosh), dhe duhet ta kesh zhdëmtuar personin që ke dëmtuar, me aq sa është e mundur. Por nëse i ke bërë këto gjëra me sinqeritet, Perëndia, që na bën të harrojmë, na ka premtuar vetë se ai nuk do të t'i kujtojë më mëkatet. Mos lejo që ato të të shqetësojnë më.

Pra Perëndia dëshiron “të na bëjë të harrojmë” padrejtësitë që na kanë bërë të tjerët; dëshirat që asnjëherë nuk na i plotësoi; dhe mëkatet që kemi lënë pas. Por ka diçka që Perëndia ka premtuar se *nuk* do të harrojë: neve!

A mundet një grua të harrojë foshnjën e gjirit dhe të mos i vijë keq për fëmijën e barkut të saj? Edhe sikur ato do të harrojnë, unë nuk do të harroj. Ja, unë të kam gdhendur mbi pëllëmbët e duarve të mia. - Isaia 49:15-16A

Kapitulli 7 - Moshyrja në Bekimin e Perëndisë

Bekimet e Perëndisë na vijnë si ftesë dhe si thirrje. Një premtim që ai i bëri popullit të tij të në lashtësi, judenjve, ishte se do t'i nxirrte nga Egjipti dhe do t'u jepte tokën e Kananit:

Dhe kam thënë: 'Nga shtypja e Egjiptit do t'ju çoj në vendin e Kananejve, të Hitejve, të Amorejve, të Perezejve, të Hivejve, dhe të Jebusejve, në një vend ku rrjedh qumësht dhe mjaltë. - Eksodi 3:17

Dhe do t'ju bëj të hyni në vendin në vendin, që u betova t'i jap Abrahamit, Isakut dhe Jakobit; dhe do t'jua jap atë në trashëgimi. Unë jam Zoti. - Eksodi 6:8

Por juve ju thashë: Ju do të shtini në dorë vendin e tyre; do t'ju jap si pronë; është një vend ku rrjedh qumësht dhe mjaltë. Unë jam Zoti, Perëndia juaj, që ju ka ndarë nga popujt e tjerë. - Levitiku 20:24

Perëndia planifikoi që toka e Kananit të ndahej mes fiseve të popullit të tij, ku secili prej tyre të merrte një zonë që do t'i caktohej:

Atëherë Zoti i foli Moisiut, duke i thënë: 'Vendi do të ndahet midis tyre si trashëgimi, sipas numrit të personave. Atyre që janë më të shumtë do t'u japësh në trashëgimi një pjesë më të madhe, atyre që janë në numër më të vogël do t'u japësh një pjesë më të vogël, secili do të marrë pjesën e tij në bazë të regjistrimit. - Numrat 26:52-54

Padyshim që ata duhej t'i përgjigjeshin premtimit, duke e konsideruar si thirrjen e Perëndisë për ta. Ata duhet të largoheshin nga Egjipti, të udhëtonin nëpër shkretëtirë, të kapërcenin Jordanin e të futeshin në tokën e premtuar, ta shtinin në dorë dhe të vendoseshin aty. Dhe në kuptimin e përgjithshëm, e bënë këtë gjë.

Por fiset e Rubenit dhe Gadit menduan se mund të merrnin diçka më të mirë sesa territori që u kishte premtuar Perëndia. Ata i hodhën sytë nga toka e Jazerit dhe Galaadit dhe panë se ajo ishte “një tokë e përshtatshme për të rritur bagëtinë”, dhe ata kishin një sasi të jashtëzakonshme bagëtish (Num.

32). Por Jazeri dhe Galaadi ishin në lindje të Jordanit, jashtë tokës që Perëndia u kishte premtuar, dhe ku i kishte thirrur.

Kështu që rubenitët dhe të gaditët erdhën tek Moisiu, tek prifti Eleazar dhe tek udhëheqësit e tjerë, dhe parashtruan këtë kërkesë: “jepua këtë vend shërbëtorëve të tu në pronësi dhe mos na bëj të kalojmë Jordanin... nuk do të pranojmë asnjë trashëgimi bashkë me ta matanë Jordanit e më tutje.”

Ata e dinin vullnetin dhe qëllimin e Perëndisë; i dinin bekimet dhe të ardhmen që ai u kishte premtuar. Por zgjodhën diçka tjetër. Kjo më kujton njerëzit që e dëgjojnë dhe pranojnë fjalën e ungjillit, që fillojnë të ecin me Zotin, dhe pastaj, ashtu siç thuhet tek Marku 4:19 “mashttrimet e pasurisë dhe lakmitë për gjëra të tjera që hynë, e mbytën fjalën dhe ajo po bëhet e pafrytshme.” Fillon mirë, ecën deri diku, pastaj nuk bën më përpara.

Atyre iu plotësua kërkesa, por kjo pati pasoja si për ta ashtu edhe për judenjtë e tjerë.

Së pari, Moisiu i pyeti: “A duhet të shkojnë në luftë vëllezërit tuaj, ndërsa ju po rrini këtu?” Ata nuk mund t’i çonin përpara qëllimet e Perëndisë si partnerë me vëllezërit e tyre, ndërsa ata vetë zgjedhin të qëndrojnë jashtë bekimit të Perëndisë. Kështu ndodh edhe me ty: nëse nuk bën përpara me Perëndinë në plotësinë e premtimit dhe thirrjes së tij me sa e njeh ti, nuk do të jesh në gjendje të përmbushësh rolin që ai dëshiron të luash në punën e kishës dhe të ungjillit.

Së dyti, Moisiu thotë: “Pse duhet të demoralizoni zemrat e bijve të Izraelit që të hyjnë në vendin që u ka dhënë Zoti?” Nëse rubenitët dhe gaditët qëndronin prapa, ky do të ishte një shkurajim për të gjithë të tjerët. Dhe përsëri, kështu ndodh edhe me ty: nëse stepesh përpara hyrjes së plotë në bekimin dhe punën që Perëndia ka për ty, atëherë shembulli yt i keq do të shkurajojë të tjerët që të mos ecin përpara. Ata do të tundohen të ndjekin shembullin tënd, dhe të ngelin mbrapa. Gjithashtu, nëse ata përpiqen t’i shërbejnë Zotin në një punë ku duhet të jesh edhe ti, barra e tyre do të jetë më e rëndë, dhe kjo peshë do të shkaktojë rraskapitje dhe shkurajim.

Moisiu vazhdon t’u thotë se ata po veprojnë jo më mirë se etërit e tyre: “Kështu veprouan etërit tuaj kur i nisa në Kadesh-Berneu për ta vëzhguar vendin... i demoralizuan zemrat e bijve të Izraelit, dhe kështu këta nuk hynë në vendin që Zoti u kishte dhënë.” A të kujtohen njerëz që kanë filluar dishepullizimin e krishterë më parë se ty dhe e kanë zhgënjyer Perëndinë e

nuk arritën të jetojnë sipas shpresave dhe pritjeve të të tjerëve? A do të veprosh edhe ti njësoj si ata?

Një hezitim i tillë, një shkarje e tillë nga besimi e zemëron Zotin: “Kështu zemërimi i Zotit u ndez atë ditë... Dhe ja, ju po zini vendin e etërve tuaj, një farë mëkatarësh, për të rritur edhe më zemërimin e zjarrtë të Zotit kundër Izraelit!” Perëndia nuk ulet madhështor dhe i largët në fronin e tij në qiell, pa u interesuar dhe pa u prekur nga bindja apo mosbindja jonë. Kur nuk pranojmë të bëjmë përpara në vullnetin e tij, ai zemërohet me ne.

Për më tepër, vendimet e tua dhe të miat ndikojnë tek njerëzit e tjerë. Nuk jemi individë të izoluar; jemi pjesë e trupit të Krishtit, populli i Perëndisë. “Sepse, po të refuzoni të shkoni pas tij, ai do të vazhdojë ta lërë Izraelin në shkretëtirë, dhe ju do të shkaktoni humbjen e tërë këtij populli.” (v. 15)

Mund të mendojmë se ky kombinim premtimesh dhe kërcënimesh të tilla do t’i bindte ata që të ndryshonin mendje, por mjerisht, ata ishin të vendosur të dilnin nga thirrja e Perëndisë dhe të bënin sipas kokës së vet. Kështu që arritën në një kompromis. Kjo fjalë e tmerrshme “kompromis”! Nuk duhet të plekseni me këtë fjalë kur vjen puna t’iu bindur Perëndisë. Shkoni deri në fund; mos bëni asnjë kompromis me mosbindjen. Ata thanë:

Atëherë ata iu afruan Moisiut dhe i thanë: ‘Ne do të ndërtojmë këtu vathë për bagëtinë tonë dhe qytete për të vegjlit tanë; por ne jemi gati të marshojmë me armë në krye të bijve të Izraelit, derisa t’i çojmë në vendin e tyre; ndërkaq të vegjlit tanë do të banojnë në qytetet e fortifikuara për shkak të banorëve të vendit. Nuk do të kthehemi në shtëpitë tona derisa secili nga bijtë e Izraelit të ketë shtënë në dorë trashëgiminë e tij. (v. 32:16-18)

Ata do të bashkoheshin në punën e Perëndisë, ndërsa shtëpitë do t’i mbanin në largësi. Po, është e mundur që të bashkohesh në veprimtarinë e ungjillizimit dhe në shërbesa të tjera të kishës ndërkohë që zemra jote është larg Zotit. Por ky është kompromis. Moisiu e pranoi marrëveshjen, dhe u tha se, pasi puna e Perëndisë të përfundojë, “nuk do të keni më detyrime përpara Zotit”.

*Perëndi, mos lejo **kurrë** që unë të mos kem më detyrime përpara teje!* I krishteri i vërtetë dëshiron fort që të ecë me Perëndinë, t’i shërbejë, të kënaqet në praninë, buzëqeshjen dhe bekimin e tij, gjithë ditët e jetës së vet. Të çlirohesh nga detyrimet përpara Zotit? Në ç’vend tjetër duhet të

shkojmë? Vetëm ai ka fjalët e jetës së përjetshme. Por kjo marrëveshje e hollë dhe e dobët u bë për rubenitët dhe gaditët. Do Zoti që ajo të jetë larg meje, dhe larg çdo lexuesi të këtij libri të vogël!

Në vargjet 33 dhe 40, Moisiu u jep tokën që lakmuan; me ta u bashkua edhe gjysma e fisit të Manasit, në lindje të Jordanit, jashtë tokës së premtuar. Ata ishin jashtë thirrjes së Perëndisë, jashtë bekimit të tij, dhe më afër armiqve të tyre.

Dhe patjetër që ata armiq erdhën. Hapeni tek 1 Kronikave 5:26 dhe lexoni:

Prandaj Perëndia i Izraelit nxiti frymën e Pulit, mbretit të Asirisë, domethënë frymën e Tilgath-Pilniserit, mbretërit të Asirisë, që internoi rubenitët, gaditët dhe gjysmën e fisit të Manasit, dhe i vendosi në Halah, në Habor, në Hara dhe pranë lumit të Gozanit, ku gjenden edhe sot. - 1 Kronikave 5:26

Kjo është hera e parë që Bibla përmend një robëri në historinë e popullit të Izraelit, pasi ishin larguar nga Egjipti, dhe kush ishin të parët që ranë? “Rubenitët, gaditët dhe gjysmën e fisit të Manasit.” Ata u “internuan” në robëri dhe u dërguan në mërgim nga mbreti i Asirisë.

Nëse qëndron në vend në ecjen dhe punën e krishterë, dhe nëse ngurron të kryesh vullnetin që të ka bërë të njohur Perëndia, si dhe të marrësh bekim e premtuar, atëherë do të ekspozohesh më shumë ndaj tundimeve që vijnë nga bota, mishi dhe djalli. S’mund të ndalemi dhe të qëndrojmë në vend: ose do të ecim përpara në jetën e krishterë, ose do të ndalemi dhe do të na ngurtësohet zemra, do të na dobësohet rezistenca, dhe do të na shkatërrohet puna dhe dëshmia. Tek po lexon këto fjalë, unë nuk di se në çfarë fazë të shtegtimit tënd të krishterë gjindesh; por nëse s’po ecën më përpara me Perëndinë, nëse ke ngelur në vend, ose nëse ke shkarë nga vendi ku ke qenë, mëso nga shembulli paralajmërues i rubenitëve dhe gaditëve; pendohu; kthehu në lidhje të ngushtë me Zotin, të cilit dikur fillove t’i shërbeje dhe ta doje; dhe hyr në bekimin ku do të të drejtojë Perëndia.

Kapitulli 8 - Kujdes për veten

Perëndia është ai që të shpëton shpirtin, por në këtë kapitull do të shikojmë disa aspekte të pjesës që të takon ty në lidhje me mënyrën sesi i përgjigjesh hirit të tij. Shqyrtoni këto vargje:

Megjithatë themeli i fortë i Perëndisë qëndron i patundur, dhe ka këtë vulë: 'Zoti i njehtë vetët', dhe: 'Le t'i largohet paudhësisë kushdo që përmend emrin e Krishtit'. - 2 Timoteut 2:19

Prandaj, vëllezër, përpikuni gjithnjë e më shumë ta përforconi thirrjen dhe zgjedhjen tuaj, sepse duke bërë këto gjëra, nuk do të pengoheni kurrë. - 2 Pjetrit 1:10

Vetëm kini kujdes për veten tuaj dhe tregohuni të zellshëm për shpirtin tuaj, në mënyrë që të mos harroni gjërat që sytë tuaj kanë parë dhe këtë të mos largohen nga zemra juaj për të gjitha ditët e jetës suaj. – Ligji i Përtërirë 4:9

Këtu shikojmë se shpëtimi ynë ka dy anë: Perëndia që na shpëton dhe ne që e ushtrojmë shpëtimin duke iu përgjigjur me bindje dhe shenjtëri. Tek shprehja “tregohuni të zellshëm për shpirtin tuaj”, siç thuhet tek pasazhi i Ligjit të Përtërirë, gjejmë dy gjëra që duhet të shmangim dhe tri të tjera që duhet të bëjmë. Duhet të shmangim mëkatën, si dhe dobësitë ose tundimet personale. Duhet të lutemi, të ushqehemi me shkrimet dhe të praktikojmë gjërat që janë radhitur tek Veprat 2:42: doktrinën e shëndoshë të krishterë; bashkësinë me besimtarët e tjerë; Darkën e Zotit (ndonjëherë e quajtur *Eukaristi* ose kungatë).

Ligji i Përtërirë tek kapitulli 4 na paralajmëron për ato që mund të ndodhin nëse nuk e ruajmë shpirtin me zell.

Vargu 9, i kthyer në një zbatim të krishterë, na paralajmëron se do ta harrojmë shumë shpejt kthimin tonë tek Krishti, atë kohë kur besuam për herë të parë tek ai, dhe gjithçka që ajo kohë nënkuptonte atëherë për ne. “Tregoni kujdes të veçantë për shpirtrat tuaj.” (v. 15)

Vargu 10 na paralajmëron se ndoshta do të harrosh që Perëndia të thirri në besëlidhjen e tij, në atë marrëveshje të vendosur midis teje dhe Perëndisë, ku ai do të ishte Perëndia yt dhe do të kujdesej për ty gjatë gjithë jetës dhe

vdekjes, dhe ku ti do të ishe pjesë e popullit të tij, duke ecur me bindje me të; ashtu siç është shkruar tek Ezeieli 11:20, “ata do të jenë populli im dhe unë do të jem Perëndia i tyre” dhe tek Zbulesa 21:7, “Kush fiton do t’i trashëgojë të gjitha gjërat, dhe ai do të jetë për mua bir.”

Vargu 14 na paralajmëron se do t’i harrojmë standardet e Perëndisë, nëse nuk e ruajmë me zell shpirtin tonë – standardet e tij për besimin dhe moralin në familje, në punë, mes fqinjëve dhe miqve tanë. Ne ia diskreditojmë emrin e mirë kur njerëzit na shohin të rrëzohemi.

Vargjet 15-18 na paralajmërojnë se do të harrojmë edhe se si është Perëndia në të vërtetë, dhe se do të krijojmë një pamje të shpërfytyruar të tij në mendjen tonë – një pamje të gabuar të karakterit dhe mënyrës sesi vepron ai. Nëse harron natyrën e tij, nuk do arrish t’i shërbesh dot.

Vargu 19 na paralajmëron për rrezikun se mos biem në idhujtari, përfshi këtu edhe adhurimin e yjeve: “gjërave që Zoti, Perëndia yt, u ka dhënë tërë popujve nën të gjithë qiejt.” Asnjëherë nuk duhet të drejtohesh te horoskopi që të të parashikojë rrugën, dhe as të ndonjë formë shortarie, si p.sh. filxhani i kafesë. Perëndia i bëri të gjitha gjëra, dhe vetëm ai sundon mbi universin e tij. E ardhmja jote është në duart e tij, dhe vetëm ai e vendos kursin e kësaj bote dhe jetën e njerëzve. Idhujtaria mund të jetë adhurimi i një perëndie të rremë; por mund të jetë edhe kur i trajtojmë gjërat që Perëndia i ka bërë sikur të ishin Perëndi ose sikur të kishin nderim dhe fuqi hyjnore. Kolosianët 3:5 na tregon se edhe lakmia është idhujtari: diçka që nuk e ke, por dëshira për ta pasur fillon të ketë më shumë vlerë për ty sesa ka Perëndia, ose diçka që e ke tashmë bëhet më e vlefshme për ty sesa shpëtimi nëpërmjet Krishtit. Edhe kjo është idhujtari.

Mos iu drejtoni mediumeve dhe magjistarëve; mos u konsultoni për të mos u ndotur me anë të tyre. Unë jam Zoti, Perëndia juaj. - Levetiku 19:31

Të mos gjendet midis teje ndonjë që kalon birin ose bijën e vet nëpër zjarr, as ndonjë që praktikon shortarinë, bën parashikime, interpreton shenjat dhe merret me magji, as ai që përdor yshtje, as mediume që konsultojnë frymat, as magjistarë, as ai që ndjell të vdekurit, sepse të gjithë ata që merren me këtë punë neveriten nga Zoti. - Ligji i Përtërirë 18:10-12

Mos mësoni të ndiqni rrugën e kombeve dhe mos kini frikë nga shenjat e qiellit... sepse zakonet e popujve janë kotësi. - Jeremia 10:3

Ruaje zemrën tënde me shumë kujdes, sepse nga ajo dalin burimet e jetës. Kështu thuhet tek Fjalët e Urta 4:23, dhe kanë të njëjtë ide si ato të kapitullit tonë tek Ligji i Përtërirë. Çfarë dëshiron që të burojë nga zemra jote drejt të tjerëve dhe drejt Perëndisë? “Ujë” i pastër lavdërimi, perëndishmëri dhe bekime. Atëherë, ruaje zemrën me shumë kujdes.

Çlirimi i Izraelitëve nga Egjipti përdoret shpesh si simbol i çlirimit tonë nga faji, fuqia dhe dënimi i mëkatit. Pasazhi ynë tek Ligji i Përtërirë thotë në vargun 20 se Perëndia “ju nxori nga Egjipti”. Ne e falënderojmë Perëndinë për shpëtimin që Jezus Krishti bleu dhe kreu për ne me anë të vdekjes dhe ringjalljes së tij. Vargu vazhdon duke thënë “për të qenë populli i tij, trashëgimia e tij”. Ky është plani dhe vullneti i Perëndisë, qëllimi i veprës së tij në ty. Që t’i përkasësh atij.

Ec afër tij në shenjtëri. Nëse ke qenë duke u endur, thuaji se të vjen keq, ndrysho mënyrën e jetesës, dhe kthehu tek Zoti. Nëse po ecën me të, qëndroji afër gjatë gjithë jetës.

Kapitulli 9 - Samsoni

Nxitni njëri-tjetrin çdo ditë... që të mos ngurtësohet ndonjë nga ju prej mashtrimit të mëkatit. Këto fjalë gjenden tek Hebrenjtë kapitulli 3. Pse mëkati quhet mashtrues?

Tek libri i tij, “God’s Smuggler” (Kontrabandisti i Perëndisë)¹, Vëlla Andrew tregon një histori që e kishte dëgjuar nga një murgeshë françeskane për mënyrën sesi i kapin majmunët në pyll. Ajo thoshte:

Majmuni asnjëherë nuk e lëshon atë që do, edhe pse kjo mund t’i kushtojë lirinë.

Kështu, vendasit hapin një vrimë në fund të arrës së kokosit, aq të madhe sa një majmun mund të fusë putrën brenda. Ata hedhin një guralec tek arra e kokosit nëpërmjet vrimës dhe presin fshehurazi me një rrjetë. Majmuni vjen, e gjen arrën e kokosit, e tund dhe vret mendjen se ç’ka brenda. Kurioziteti e bën që të shikojë brenda. Pastaj e fut putrën brenda dhe kap guralecin. Por nuk mund ta nxjerrë putrën pa e lëshuar guralecin, të cilin do që ta marrë. Ndërsa ai vret mendjen për t’u munduar sesi ta nxjerrë guralecin, vendasit arrijnë ta kapin shumë lehtë me rrjetat.

Murgesha e pyeti Andrew-un: “A po kapesht fort pas diçkaje – diçka që po të mban larg lirisë sate?” Ka qenë një njeri në Bibël që lindi sipas një premtimi të veçantë të Perëndisë, në një kohë kur populli i Izraelit po jetonte me ligësi dhe Zoti, për t’i ndrequr, i kishte dorëzuar në duart e armiqve për dyzet vjet. Ai njeri quhej Samson. E ëma kishte qenë shterpë, por Perëndia i dërgoi një engjëll me një premtim: “Ti do të mbetesh me barrë... ai do të fillojë të çlirojë Izraelin nga duart e filistejve” (Gjy. 13:1-6). Ai i dha edhe një urdhër: “Fëmija do të jetë një Nazireo kushtuar Perëndisë që në barkun e nënës së tij.” Nazireot ishin njerëz të veçantë që veçoheshin për Perëndinë për të qenë të ndarë dhe të shenjtë. Mund të lexoni për ta tek Numrat 6.

Një mënyrë sesi Nazireot e tregonin përkushtimin e tyre ndaj Perëndisë ishte që gjatë kohës së betimit, ata nuk i prisnin flokët, dhe kështu engjëlli i dha një urdhërim të ëmës së Samsonit: “mbi kokën e të cilit nuk do të kalojë brisku.”

Tek kapitujt 14 dhe 15, Samsoni kryen vepra me një fuqi të jashtëzakonshme, dhe gjykon mbi Izraelin për njëzet vjet. Ai vetë e dinte domethënien e mosprerjes së flokëve, si një shenjë e përkushtimit të tij, dhe në kapitullin 16, gruaja që ai e donte si budalla – sepse ajo e tradhtoi – e shtyu tre herë që t’i tregonte sekretin e fuqisë së tij të madhe. Të trija herët, ajo ua transmetoi përgjigjen armiqve të tij, por ato përgjigje kishin qenë gënjeshtër. Por herën e katërt, ai i tha: “Kurrë nuk më ka kaluar brisku mbi kokën time, sepse jam një Nazireo i Perëndisë, qysh në barkun e nënës sime; po të rruhesha, forca ime do të ikte, do të bëhesha i dobët dhe i njëllojtë si të gjithë burrat e tjerë.”

E kuptoni? Ai e dinte të vërtetën në mendje, por nuk e mori seriozisht. Mbi të gjitha, ishte hera e katërt që Delila e pyeti; ai nuk kishte asnjë arsye të besonte se ajo do ta ruante sekretin nga armiqtë e tij tani që ai i tregoi arsyen e vërtetë për forcën e tij të pazakontë. Samsoni duhet të ketë besuar se mund ta thyente betimin e Nazireos dhe të mos i vuante pasojat.

Erdhën armiqtë dhe Delila i tha: “Samson, filistejtë i ke mbi kokë!” Por ai tha: “Unë do t’ia dal si herët e tjera, do të shpengohem.” Ai nuk e dinte që Zoti e kishte braktisur.

Sa fjalë tmerrësisht të paharrueshme: “Ai nuk e dinte që Zoti e kishte braktisur”. Këto fjalë mund të bëhen të vërteta për secilin prej nesh. Ato na shërbejnë si paralajmërim.

Filistejtë e kapën, ia nxorën sytë, e morën rob dhe e vunë të rrotullojë mokrën në mullirin e burgut.

Ky ishte mashtrimi i tij. Ai mendoi se do të shpëtonte pa u lagur kur braktisi përkushtimin ndaj Perëndisë. Në fund të fundit, ai madje kishte lindur me një premtim për jetën e vet! Pra, e theu betimin, dhe mendoi se asgjë nuk do të ndryshonte. Por Perëndia e braktisi.

Tani shikojeni tek 16:21, të verbër, të lidhur me zinxhirë prej bronzi, dhe të detyruar të punonte në një burg të huaj. Ky ishte njeriu që e gjykoi vendin për njëzet vjet! Tradhtia kundër përkushtimit ndaj Perëndisë i shkatërroi jetën dhe punën.

Por shikoni sesi përfundon historia. Gjatë një feste, filistejtë filluan të deheshin, dhe dërguan që të thërrisnin Samsonin e të talleshin me të. Ai qëndron mes dy shtyllave në një shtëpi bashkë me të gjithë zotat e filistejëve, dhe rreth 3000 njerëz mbi çati shikonin kur po e tallnin për t’u dëfryer.

Së fundi, tek vargu 16:28, ai i drejtohet Perëndisë me lutje: “O Zot, o Zot, të lutem mos më harro! Më jep forcën e nevojshme për këtë herë vetëm, o Perëndi, që të hakmerrem me filistenjtë me një goditje të vetme, për shkak të humbjes së dy syve të mi.” Ai nuk shqetësohej më për veten: “Le të vdes bashkë me filistejtë.” Dhe pastaj u përkul me gjithë fuqinë, dhe shtëpia ra mbi zotat dhe mbi të gjithë njerëzit brenda. Edhe vetë Samsoni vdiq gjatë shkatërrimit. Por Bibla na thotë: “qenë më shumë ata që ai vrau duke vdekur se ata që kishte vrarë kur qe gjallë.”


Gjatë minutave të pakta dhe të fundit kur i thërriti Perëndisë, ai përmbushi premtimin e lindjes: “Ai do të fillojë ta çlirojë Izraelin nga duart e filistenjve.”

Nëse po tundohesh dhe po largohesh nga Perëndia nga mashtrimi i mëkatit, le të të paralajmërojnë seriozisht që të kthehesh pas fjalët e Fjalëve të Urta 29:1 “Njeriu që fortëson qafën kur qortohet, do të thyhet papritmas patjetër.” Çlirohu nga mëkati dhe kthehu tek përkushtimi yt i mëparshëm ndaj Zotit.

Nëse je ngurtësuar tashmë nga mashtrimi i mëkatit, atëherë, ashtu si Samsoni, bëji thirrje Perëndisë me lutje të zjarrtë, lëre veten pas dhe lejoje Perëndinë të veprojë, pavarësisht sa do të të kushtojë; dhe beso se Perëndia mund, dhe do, të t’i dëgjojë ende lutjet, dhe do të të përdorë në shërbim të tij.

Kapitulli 10 - Absalomi

Në mënyrë që ta kuptoni këtë histori, duhet të dini disa gjëra në lidhje me familjen e mbretit David. Nuk do t'ju tregoj gjithçka për të gjithë familjen, por vetëm për anëtarët që kanë të bëjnë me këtë histori. Mbreti David kishte dy gra, Ahinoami dhe Mikal. Ahinoami i dha një djalë me emrin Amnon; Mikali i dha një djalë të quajtur Absalom dhe një vajzë të quajtur Tamara. Pra:



Amnoni u marros pas gjysmëmotrës së tij, Tamarës, dhe e detyroi të bënte seks me të. Pastaj, “dashuria” e tij u kthye shumë shpejt në urrejtje: ndoshta ai u tmerrua nga incesti që kishte kryer; ndoshta ishte reagimi i tij ndaj përgjigjes që ajo i dha. Sidoqoftë, ai e urreu Tamarën.

Prandaj Absalomi, vëllai i vërtetë i Tamarës, e urreu Amnonin. Kjo është normale: nëse dikush urren motrën tënde, ndoshta edhe ti do ta urresh atë njeri.

Dy vjet më vonë, Amnoni u “deh nga vera”. Nuk thuhet që ishte bërë xurxull, por sigurisht që ishte i qetësuar dhe në qejf. Absalomi, që ende ushqente urrejtje kundër tij, pa mundësinë që kishte dhe i bëri shërbëtorët të vrisnin Amnonin kur ai po dehej.

Pastaj, Absalomi duke e ditur se kishte vrarë një bir të mbretit, u arratis në Geshur, në verilindje, dhe qëndroi aty për tre vjet. Si do të ndihej cildo baba për vdekjen e të birit? Ai e priste zemërimin e Davidit.

Megjithatë, edhe Absalomi ishte djali i mbretit. Sa situatë e koklavitur! Davidi u mundua ta zgjidhte këtë situatë duke dërguar komandantin ushtarak, Joabin, që të kthente Absalomin në Jeruzalem. Ai erdhi, por i kërkuan që të jetonte veçmas në shtëpinë e vet dhe të mos vinte në praninë e Davidit për dy vjet.

Kjo gjë nuk i pëlqeu Absalomit; ai donte që të kishte pranim të plotë në oborrin mbretëror. Ai dogji fushën me elb të Joabit (i cili ishte i besuari i

mbretit) për t'i bërë presion që ta bindte Davidin të ripranonte Absalomin. Kjo mënyrë veprimi pati sukses dhe Absalomi u kthye në praninë e mbretit.

Pastaj (2 Sam. 15:1-6), Absalomi – i cili duket qartë se, në përgjithësi, është një bela e madhe – kalon katër vjet duke vjedhur zemrat e njerëzve mbi të cilët Davidi sundonte, duke i magjepsur drejt një revolte kundër mbretit. Në krye të katër viteve, ai u vetëdeklarua mbret në vend të Davidit dhe ceremonia u mbajt në Hebron – ish-kryeqyteti i Judës.

Davidi ia mbath nga Jeruzalemi, por lë mbrapa spiunët. Ndërsa Davidi po arratisesh, një personazh tjetër i pakëndshëm, i quajtur Shimei, e ndjek nga pas duke e mallkuar, si dhe duke i hedhur gurë dhe pluhur.

Absalomi shkon edhe më tej: tek 17:2,5 kërkon jetën e Davidit, dhe tek 17:24 dhe 18:6-8 lufton me të. Ç'lloj njeriu është ai që i shpall luftë të atit? Ç'lloj njeriu është ai që përpiqet të vrasë babanë e vet? Jo vetëm kaq, por më shumë se 20,000 vetë humbasin jetën në këtë luftë që filloi Absalomi: shumë gjak në duart e një njeriu; shumë familje të shkatërruara dhe të thyera që ngelën pa burrë dhe pa baba.

Forcat e Davidit dalin fitimtare, dhe Absalomit aksidentalisht – ose më mirë duhet të them nga providenca – i ngeci koka tek një lis. Mushka e tij vazhdoi të ikte, ndërsa ai ngeli i varur atje, i pambrojtur. Joabi e gjen dhe e vret (18:14-15).

E tillë ishte jeta dhe vdekja e një njeriu të shprishur. Si ndihej Davidi, i ati, për të? Mund të ngelni të habitur. Duhet të kuptoni me patjetër sesi Perëndia ndihet për fëmijët e vet që largohen nga rrugët e tij dhe zhyten thellë në mëkat.

2 Samuelit 13:39, kur Absalomi ishte në Geshur: *Mbreti David dëshironte të shkonte tek Absalomi.*

2 Samuelit 18:5, në fillim të luftës kundër Absalomit: *Për hirin tim, silluni me kujdes me të riun Absalom!*

2 Samuelit 18:29 pas fitores së Davidit, pyetja e parë që Davidi bën pasi mëson për fitoren është: *A është mirë i riu Absalom?*

2 Samuelit 18:33, kur Davidi merr vesh se Absalomi ka vdekur: *Atëherë mbreti, duke u dridhur i tëri, u ngjit në dhomën që ishte mbi portë dhe qau; dhe thoshte: 'O biri im Absalom; biri im, biri im Absalom! Të kisha vdekur unë në vendin tënd, o Absalom, biri im, biri im!'*

Kjo duhet të jetë një nga shfaqjet më befasuese të dashurisë atërore në të gjithë letërsinë botërore! Dhe mos harroni se Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re e quajnë Davidin një njeri sipas zemrës së vetë Perëndisë (1 Sam. 13:13; Vep. 13:22-23). Dashuria e Davidit për rebelin e lig Absalom është e ngjashme me dashurinë që Perëndia ka për fëmijët e tij mëkatarë, kur ata shkasin nga besimi: atij i lëngon zemra që ata të kthehen, të gjejnë faljen, pajtimin dhe paqen.

Por ka një ndryshim midis Davidit dhe Perëndisë. Davidi tha: *“Të kisha vdekur unë në vendin tënd, o Absalom, biri im, biri im!”* – por ai nuk kishte mundësi ta bënte këtë gjë. Ai do të kishte vdekur në vend të Absalomit, por nuk mundi. Por për Perëndinë kjo ishte e mundur: ai dërgoi Birin e tij, Personin e dytë të Trinisë, si njeri, Zotin tonë Jezu Krisht, që vdiq vërtet në vendin tonë. Siç shkruhet tek 1 Pjetrit 3:18: “Sepse edhe Krishti ka vuajtur një herë për mëkatet, i drejti për të padrejtët, për të na çuar tek Perëndia.”

Ashtu siç thotë Isaia, në pasazhin nga i cili predikova për herë të parë në jetën time: “Por ai u tejshpua për shkak të shkeljeve tona... dhe Zoti bëri që të bjerë mbi të paudhësia e ne të gjithëve.” (53:5-6)

Atëherë, çfarë duhet të bësh? Nëse më përpara ke jetuar si i krishterë, duke e dashur dhe duke iu bindur Perëndisë në shërbesën e krishterë dhe në jetesë të pastër, dhe nëse pastaj je larguar nga kjo lloj jete – kthehu. Je i ftuar; rruga është e hapur. Perëndia do të të pranojë. Kthehu tek ai, tregoji të gjitha ato që ke bërë; thuaji se të vjen keq me të vërtetë; kërkoji që të të falë, dhe që, me anë të Frymës së tij, të të japë një fillim të ri për të ndjekur Krishtin. Dhe vendos që, tani e tutje, të jetosh afër me Krishtin deri në ditën e fundit të jetës.

Kapitulli 11 - Josia

Shpeshherë mund ta gjejmë veten, përvojat, jetën dhe situatat tona në faqet e shkrimit, dhe padyshim që kjo është e vërtetë edhe në historinë e mbretit Josia të Judës, i cili sundoi në shekullin e VII para K. Për të lexojmë tek 2 Kronikave 34 dhe 35. Ne fakt, ai u bë mbret që kur ishte një djalë 8 vjeç; dhe mbretëroi në Jeruzalem për 31 vjet.

Në vitin e tetë të mbretërimit të tij, kur ishte 15 ose 16 vjeç, si shumë adoleshentë të tjerë, ai filloi të mendonte seriozisht për Perëndinë dhe jetën, për qëllimin e Perëndisë për jetën e tij – ose, siç thotë Bibla tek vargu 34:3 “ai filloi të kërkojë Perëndinë e Davidit” (pra të paraardhësit të tij).

Përpara se Josia të hipte në fron, kishin qenë një mbret i mirë dhe dy të këqinj. Shumë gjëra të mira u bënë nën sundimin e mbretit të mirë, Hezekias, por mbreti i lig, Manasi (696 – 642), i ktheu të gjitha përmbys, dhe të mirat humbën. Manasi e përdhosi tempullin; ai futi zakonet asiriane në fe; solli adhurimin yjor, spiritizmin, shortarinë dhe sakrificën njerëzore. Ai “derdhi shumë gjak të pafajshëm” (2 Mbr. 21:16).

Mbretërimi i tij i gjatë u pasua nga mbreti Amon (642-640), i cili ndoqi shembullin e tij.

Të gjitha këto tregojnë se Josia u ngjit në fron gjatë një kohe kur kombi ishte i shkatërruar në fe dhe moral. Siç e pamë, në mes të adoleshencës, ai filloi të kërkonte Perëndinë. Rreth moshës 19 vjeçare, filloi t’i *shërbente* seriozisht Perëndisë, duke e pastruar Jeruzalemin dhe Judën nga praktikat fetare të rreme dhe pagane. Puna e tij u shtri përtej Jeruzalemit dhe Judës, duke arritur deri tek fiset e Manasit, Efraimit, Simeonit, Naftalit dhe “në të gjithë tokën e Izraelit”

Unë kam qenë në mes të viteve të adoleshencës kur kërkoja, dhe me hirin e Perëndisë, e gjeta Zotin, dhe isha rreth 18 vjeç kur fillova të gjeja mundësinë për të shërbyer seriozisht. Pyes veten nëse ti, lexues, ose nëse dikush që e njeh ose që po e këshillon, është po kështu.

Dhjetë vjet pasi u kthye tek Perëndia - tani ishte nja 25 vjeç - ai akoma po i shërben Perëndisë. Pasi e pastroi shpirtërisht fenë e kombit, ai tani fillon riparimet fizike në tempull. Gjatë kësaj pune, prifti Hilkiah gjeti librin e ligjit të Zotit që ishte dhënë nëpërmjet Moisiut, dhe sekretari Shefan ia lexoi

mbretit. Duke dëgjuar leximin e Biblës, Josia u përkushtohet thellë shkrimeve. Ai e shpreh këtë në mënyrën e lashtë të Lindjes së Mesme duke grisur rrobat e tij, dhe dërgon njerëz për t'iu lutur Perëndisë me zjarr për fjalët e shkrimit, sepse ai e di se “etërit tanë nuk e kanë ndjekur fjalën e Zotit, duke vepruar plotësisht sipas asaj që është shkruar në këtë libër” (2 Kro. 34:21). Disa vargje më poshtë, ai vetë bën një besëlidhje, pra një marrëveshje dhe përkushtim solem, që të ecë pas Zotit dhe të zbatojë urdhërimet e tij me gjithë zemër dhe me gjithë shpirt.

Përsëri shohim sesa shumë ngjan kjo me përvojën e shumë të krishterëve! Vijnë në një çast, edhe pse jemi besimtarë, kur përvoja jonë me Perëndinë bën një hap të madh dhe domethënës përpara. Pentakostalët quajnë këtë “pagëzim në Frymën e Shenjtë”; nazareasit dhe shumë metodistë përdorin fjalën “i shenjtëruar”; të tjerët nuk kanë ndonjë përkufizim specifik teologjik për përvoja të tilla, por e dinë se në një moment, ndoshta javë, muaj ose vite pas kthimit të tyre në besim, ata e takojnë Perëndinë në një mënyrë të re, më të thellë dhe më të plotë e cila ndikon jetën e tyre të brendshme dhe shërbesën e jashtme në mënyrë të qëndrueshme.

Dhe në asnjë mënyrë nuk dua të them se një eksperiencë e tillë vjen vetëm një herë. Në jetën e besimtarit mund të ketë, dhe shpesh ka, një sërë çastesh kthimi që ia ndryshojnë jetën.

Tani shikoni fundin e kapitullit (v. 33) dhe vëreni bekimin që përcolli tek të tjerët shërbesa dhe udhëheqja e Josias:

Kështu Josia zhduku tërë gjërat e neveritshme nga të gjitha vendet që u përkisnin bijve të Izraelit dhe i detyroi tërë ata që ishin në Izraelit t'i shërbenin Zotit, Perëndisë së tyre. Gjatë gjithë jetës së tij ata nuk hoqën dorë së ndjekuri Zotin, Perëndinë e etërve të tyre.

Pse po shkruaj për tërë këtë hir dhe bekim në një libër për shkarjen nga besimi? Sepse, siç ndodh shpesh, modeli i jetës së Josias dhe shërbesa e tij për Perëndinë vazhdoi në këtë drejtim për goxha vite: në fakt, për trembëdhjetë vjet të tjerë. Ai tani është 39 vjeç. Dhe ajo që dua të them është se **asgjë e veçantë, asgjë e spikatur nuk është regjistruar gjatë atyre viteve**. Ndoshta mund të ndodhë që të gjesh drejtimin dhe thirrjen e Perëndisë për jetën tënde kur je djalë ose vajzë e re, njësoj si Josia, dhe mund të thirresh të bësh të njëjtën shërbesë me besnikëri dhe në vazhdimësi, pa u lëkundur, për një kohë të gjatë. Pastaj vjen një çast kur

Perëndia të flet përsëri, por veshët e brendshëm të janë shurdhuar, dhe nuk e dëgjon, ose nuk e njeh, ose nuk e ndjek zërin e Perëndisë.

Kjo ishte ajo çfarë i ndodhi Josias. Kur ishte rreth 39 vjeç (35:20-24) ai nuk e dalloj çfarë po i thoshte Perëndia, dhe tani gjërat shkuan tmerrësisht keq. Neko, mbreti i Egjiptit (610-594 para K.), shkoi për të luftuar në lumin Euftrat me qëllimin (sipas qartësimit nga Kronika Babilonase) që të ndihmonte asirianët që mezi po u bënëin ballë babilonasve në Haran.

Josia u ngrit në luftë kundër Nekos, duke u përpjekur të bllokonte përparimin e forcave Egjiptiane. Neko i dërgoi lajmëtarë Josias duke i thënë se kjo luftë nuk kishte të bënte fare me Josian; Neko nuk po luftonte kundër Izraelit. Madje ai tha: “Perëndia më ka urdhëruar të shpejtohem; mos e kundërshto, pra, Perëndinë që është me mua, që ai mos të të shkatërrojë.”

Sigurisht që shumë kombe ndeshen me njëri-tjetrin dhe besojnë se Perëndia është në anën e tyre! Kjo nuk është gjithmonë e vërtetë. Por në këtë rast, Josia po fuste hundët në një luftë që nuk kishte të bënte me të, dhe fjalët e Nekos përmbanin të vërtetën. Por Josia bën dy gjëra:

1. Nuk tërhiqet nga kjo luftë që nuk ka të bëjë fare me të
2. Maskohet dhe lufton në fshehtësi kundër Nekos.

Pse përdori dredhinë? Bibla nuk na e thotë, por përpjekja e tij për të përdorur mashtrimin ishte marrëzi. Shkrimi thotë: *Nuk i dëgjoi fjalët e Nekos, që vinin nga goja e Perëndisë. Kështu doli të ndeshet në luginën e Megidos.* Mos ndoshta ishte mësuar t’i shërbente Perëndisë vit pas viti sipas mënyrës që ishte thirrur, aq sa kur Perëndia i foli në një mënyrë të re, ai nuk e dëgjoi? Apo mos ishte mësuar kaq shumë të jetonte në favorin e Perëndisë, sa u bë i vetëkënaqur ose tepër i sigurt, duke besuar se Perëndia do ta mbronte, çfarëdo që t’i ndodhte? Cilado qoftë arsyeja, është e qartë se ai nuk ishte më aq afër me Perëndinë sa të njihnte zërin e tij.

Harkëtarët e gjuajtën në betejë dhe shërbëtorët e tij e çuan të plagosur rëndë me një qerre në Jeruzalem. Dhe aty vdiq; aty përfundoi shërbimi i tij për Perëndinë. Kjo ishte një humbje e tmerrshme, jo vetëm për vetë Josian, por edhe për të gjithë kombin: “Tërë Juda dhe Izraeli mbajtën zi për Josian.” (v. 24)

Djali i tij, Jehoahazi, mbretëroi në vendin e tij për tre muaj, dhe pastaj mbreti i Egjiptit e rrëzoi nga froni dhe i vuri vendit haraç. Kjo humbje e pavarësisë ishte tragjedia e parë e madhe që pllakosi mbretërinë e Judës.

Kemi shumë për të mësuar nga ky përfundim tragjik i shërbimit të gjatë dhe besnik të një njeriu të mirë. Duhet të ecim sa më afër me Perëndinë, me intimitet, në mënyrë të gjallë dhe reale, për aq kohë sa të jetojmë, gati për ta dëgjuar dhe për t'iu bindur kur ai na flet.

Ndoshta do të të duhet ta dëgjosh zërin e Perëndisë në çdo kohë gjatë shërbesës dhe jetës sate. Ndoshta ai mund të ketë një thirrje, drejtim ose ndalesë të re për ty pas një periudhe të shkurtër ose ndoshta, ashtu si Josia, pas një periudhe të gjatë të shërbesës. Siguria jonë e vetme qëndron në ecjen e ngushtë me të, ditë për ditë, gjatë gjithë ditëve të jetës sonë.

Kapitulli 12 - Fundi i verës

Kështu thotë Zoti,
Në rast se dikush rrëzohet, a nuk ngrihet vallë? Në rast se dikush ndërron drejtimin, a nuk kthehet vallë? Pse pra, ky popull është shmangur me një rebelim të përjetshëm? Ngulin këmbë në mashtrim dhe nuk pranojnë të kthehen?

U kam kushtuar kujdes dhe i kam dëgjuar, por ata nuk flasin drejt; asnjëri nuk pendohet për ligësinë e tij dhe nuk thotë: “Çfarë bëra unë?” Secili merr përsëri vrapimin e tij, si një kalë që hidhet në betejë...

Si mund të thoni: “Ne jemi të urtë dhe ligji i Zotit është me ne?”

Kështu lexojmë tek Jeremia 8:1-8, dhe pastaj lexojmë çfarë kishin bërë skribët dhe njerëzit e urtë:

Ata mjekojnë shkel e shko plagën e bijës së popullit tim, duke thënë: “Paqe, paqe” kur nuk ekziston paqja.

Unë dhe ti duhet të ruhemi, kur shkasim nga besimi tek Zoti në mëkat, ose mosbindje, ose ftohje shpirtërore, se mos ndonjë mik ose drejtues fetar na “e shëron plagën shkel e shko”: se mos na thotë se gjërat s’janë aq të rënda sa na duken ne, dhe kështu na inkurajon që të mos na vijë vërtet keq për udhën që kemi marrë, dhe kështu të na pengojë që të kryejmë një pendim të thellë dhe rrënjësor dhe të kthehemi te Zoti. Nëse i kemi kthyer kurrizin Zotit, kthimi ynë tek ai duhet të jetë me dhimbje për të shkuarën dhe me një qëllim të sinqertë, të plotë dhe me gjithë zemër që të rregullojmë sjelljen që nga ky çast e tutje.

Nga fundi i këtij kapitulli, te Jeremia lexojmë këto fjalë të tmerrshme dhe të ashpra:

“Korrja ka mbaruar, vera ka marrë fund, dhe ne nuk kemi shpëtuar”.

Qoftë ky kapitull një paralajmërim për të gjithë ne: kur mëkatojmë, qoftë për një kohë të shkurtër ose të gjatë, duhet të kthehemi sinqerisht te Zoti në një mënyrë që na e prek dhe rrok gjithë jetën tonë.

Zoti na ndihmoftë që të veprojmë kështu!

Kapitulli 13 - Baal-peori

Kur vizitoj Shqipërinë, gjithmonë kënaqem kur dikush më fton në oborr në verë, këput rrush nga hardhia, dhe më fton të ulem për të biseduar në oborr, mes rrezeve të diellit, mes rrushit, dhe pastaj me jep një gotë raki dhe kafe turke. Kjo është një nga kënaqësitë më mbresëlënëse të punës sime. Por nuk kam qenë kurrë në shkretëtirë. Nëse rrushi të shijon kaq shumë kur e ha thjesht për miqësi dhe kënaqësi, pa një ndjenjë nevojë të vërtetë, imagjiloni sa më domethënëse do të ishte për ne nëse do të ishim duke udhëtuar nëpër shkretëtirë dhe përpara të na dilnin ca rrush të harlisur dhe joshës që varen nga hardhia nga ku mund të hamë lirisht!

Kështu e përshkruan Perëndia marrëdhënien e tij të hershme me popullin e vet. Ai thotë se i gjeti ata “si rrushi në shkretëtirë” (Ose. 9:10). Ata që thonë se Perëndia nuk ka emocione, me sa duket nuk e lexojnë Biblën shumë mirë, sepse këtu Perëndia po shijon besëlidhjen dhe marrëdhënien që ka vendosur me popullin e vet që në ditët e para të asaj besëlidhje.

Pastaj ai thotë: “Pashë etërit tuaj si fiqtë e parë mbi një fik të ri.” Unë jetoj në Britani, dhe ne importojmë ushqim nga e gjithë bota, kështu që zor se ndodh ndonjëherë që mos të arrish të gjesësh një ushqim të veçantë ngaqë është jashtë stinë – dhe ka disa ushqime që janë të stinës, si asparagu, qershitë ose domatet që rriten në vend, janë kaq të shtrenjta sa priremi të mos u afrohem për t’i blerë. Përjashtimet e vetme që më vijnë ndërmend ndërsa po shkruaj janë rrepat angleze, rrepat suedeze, pastinakët dhe lakrat e brukselit, të cilat pëlqehen më mirë pasi kanë marrë ngricën e dimrit, dhe nuk janë të shtrenjta, si edhe frutat e egra, p.sh. manaferrat dhe gështenjat. Por në vende si Greqia ose Shqipëria, ku njerëzit e kanë për zakon të hanë produkte të vendit sipas stinës, ata janë në një pozicion më të mirë për të kuptuar rëndësinë e këtyre fjalëve nga Osea: “si fiqtë e parë mbi një fik të ri”. Kjo është diçka që mezi e pret, bën plane për të, dhe e shijon kur vjen, sepse kënaqesh pasi e ke pritur. Perëndia thotë se kjo është pak a shumë sesi u ndje ai kur zgjodhi, kur thirri dhe kur pranoi popullin e tij në Dhiatën e Vjetër, dhe kur vendosi marrëdhënien dhe besëlidhjen ku tha: “Unë do të jem Perëndia i tyre, dhe ata do të jenë populli im.” Ishte njësoj sikur të provojë fiqtë e parë kur u vjen stina për t’u pjekur.

Por pikërisht fjalët që pasojnë tek Osea prezantojnë një ton acarues zhgënjimi dhe trishtimi: “Por ... arritën në Baal-peor.” Cili është Baal-peor, dhe çfarë ndodhi atje që ia shkatërroi kaq shumë gëzimin e Perëndisë për popullin e tij?

Tre vargjet e para tek Numrat 25 na thonë:

Populli filloi të shtthuret me bijat e Moabit. Ato e ftuan popullin të kryejë flijime për perënditë e tyre dhe populli hëngri dhe ra përmbys përpara perëndive të tyre. Kështu Izraeli u bashkua me Baal-Peorin, dhe zemërimi i Zotit u ndez kundër Izraelit.

Me fjalë të tjera, populli i Perëndisë bëri martesë me paganët dhe u largua nga Perëndia për të adhuruar perëndi të rreme. Pasazhi na thotë se ata u shtthurën: besimtari, sipas këtij krahasimi, është martuar me Perëndinë, dhe çdo adhurim që i bëhet një perëndie tjetër, krahasohet me kurvërinë.

Gjithashtu vëre, të lutem, këtë të vërtetë shumë të rëndësishme: nëse je i krishterë dhe nuk je i martuar, ti duhet të martohesh vetëm në Zotin. Mund të të kushtojë shtrenjtë të mbash qëndrim dhe të këmbëngulësh për këtë parim të jetës sate, por nëse martohesh me një jobesimtar, jeta dhe shërbesa jote e krishterë do të pengohet ose mund t’i zihet fare fryma. Ti dhe burri ose gruaja jote e ardhshme do të mund të ecni në harmoni, dhe jeta juaj do të jetë një sakrificë e ëmbël për Perëndinë, dhe shërbesa juaj për të, si një çift i martuar në shtëpinë tuaj dhe e njëjta mënyrë jetese, do të jetë një bekim për të tjerët dhe një gëzim i singertë për Zotin tuaj vetëm nëse ndani të njëjtin besim në Jezus Krishtin. Mund të mos jetë e lehtë; mund të jetë shumë e vështirë; por kështu duhet bërë.

Psalmi 115 na tregon se idhujt e perëndive të rreme “kanë gojë por nuk flasin, kanë sy por nuk shohin, kanë duar por nuk prekin, kanë këmbë por nuk ecin”, dhe pastaj shton: “Njëllon si ata janë ata që i bëjnë, tërë ata që u besojnë atyre”.

Nuk ka asnjë dyshim që ti do të bëhesh si perëndia që adhuron. Kështu thotë edhe Osea: “Ata u dhanë pas poshtërsisë dhe u bënë të neveritshëm si ajo që ata donin.”

Ashtu si populli i Perëndisë atëherë, edhe sot ka shumë njerëz që e nisin mirë kur ndjekin Krishtin, por që më vonë largohen shumë nga Perëndia, nuk janë si ai, dhe bëhen gjithmonë e më shumë pikërisht si ato gjëra që i larguan nga Perëndia.

Kështu Osea 9:1 thotë: “Je kurvëruar duke u larguar nga Perëndia yt... Ata u korruptuan thellë... dhe u bënë të neveritshëm si ajo që ata donin”.

Por vëreni edhe durimin mahnitës të Perëndisë. Ndoshta kishin kaluar 500 vjet që nga koha e Moisiut - kur njerëzit ishin si rrush dhe fík i ri për Zotin, - deri në kohën e Oseas. Gjatë asaj kohe: “Perëndia u foli së lashti shumë herë dhe në shumë mënyra etërve me anë të profetëve” (Heb. 1:1), duke i thërritur që të ktheheshin. Vetë Jezusi e shprehu këtë ndjenjë për kryeqytetin tek Lluca 13:34: “Jeruzalem, Jeruzalem, që i vret profetët dhe i vret me gurë ata që të janë dërguar! Sa herë desha t’i mbledh bijtë e tu sikurse kllloçka i mbledh nën krah zogjtë e vet, por ju nuk deshët!” Shikoni dashurinë, durimin dhe këmbënguljen e Perëndisë kur dërgon lajmëtarët e tij, dhe kur i fton këta njerëz kokëfortë që të kthehen tek ai.

A po të thërret edhe ty që të kthehesh tek ai?

Pesëqind vjet... por më në fund vjen koha kur Perëndia thotë, ashtu siç bëri tek Osea 9:7 “Kanë ardhur ditët e ndëshkimit... Izraeli do ta mësojë”. Fjalët e Urta 29:1 na thotë se “Njeriu që fortëson qafën kur qortohet, do të thyhet papritmas pa tjetër”. Ky është një paralajmërim i fortë dhe solemn që nuk guxojmë ta marrim lehtë. Tek e fundit, gjendet në Bibël! Kthehemi tek Osea 9, ku Perëndia thotë:

Mjerë ata kur të largohem prej tyre!

dhe Osea i bën jehonë duke thënë:

Perëndia im do t’i hedhë poshtë, sepse nuk e kanë dëgjuar. – vargjet 12, 17

Perëndia tha se do t’i ndëshkonte, por cili do të ishte ndëshkimi? Vargu 9:17 u thotë atyre: “Dhe ata do të shkojnë duke u endur midis kombeve”. Ata do të zboheshin nga toka e tyre, Izraeli, dhe do të shpërndaheshin nëpër botë. S’ka nevojë të dish shumë gjëra për periudhën Nacional-Socialiste (“Naziste”) në Gjermani për të zbuluar nëse judenjve iu desh të merrnin seriozisht premtimin e Perëndisë. Sipas vlerësimeve, vdiqën 6,000,000 prej tyre.

Çfarë i përzuri nga Izraeli? Kishte tre arsye kryesore: emigrimi, tregtia dhe persekutimi. Për shembull:

- Më 722 para K. shumë prej tyre u dërguan në emigrim nga asirianët.
- Në shekullin e VI para K. ndodhi mërgimi në Babiloni dhe Egjipt.

- Në kohën e Ptolemit (322-285 para K.) shumë prej tyre ikën në Aleksandri.
 - Në kohën e Antiokusit (223 para K. e më tej) shumë prej tyre shkuan në Frigji dhe Lidi.
 - Në kohën e Pompeit (shekulli I para K.) shumë shkuan në Romë.
 - Tiberiusi internoi 4000 në Sardenjë.
 - Në kohën e Krishtit, shumë prej tyre ishin në Greqi: edhe sot aty gjen një memorial të judenjve të Janinës.
 - Që nga viti 70 pas K., kur u shkatërrua tempulli i Jeruzalemit, ata u shpërndanë nëpër vendet e Mesdheut.
 - Gjatë epokës së hershme të krishterë, shumë prej tyre ikën në Gali, Spanjë dhe Afrikën e Veriut.
 - Gjatë periudhës 1000-1500 pas K., shumë prej tyre emigruan në Poloni, Hungari, Rusi dhe Ukrainë.
 - Më 1190 ndodhi nga masakër e judenjve në York të Anglisë.
 - Më 1217, judenjtë e Anglisë u detyruan të vishnin stema të verdha për të treguar se ishin judenj.
 - Më 1290, të gjithë judenjtë u përzunë nga Anglia – rreth 16,000 prej tyre.
 - Më 1492, rreth 200,000 judenj u përzunë nga Spanja dhe ikën në Portugali, Afrikën e Veriut dhe në Ballkan (kam vizituar një varrezë judenjsh në Prishtinë).
 - Pas kësaj, shumë prej tyre emigruan në Evropën veriperëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
 - Gjatë Luftës së Dytë Botërore, vetën Shqipëria i mbrojti judenjtë gjatë holokaustit dhe strehoi judenjtë që ikën nga Serbia, Austria dhe Greqia; më 1991, pothuajse të gjithë judenjtë shqiptarë emigruan në Izrael.
- Ja, një listë e shteteve që kishin më shumë se 10,000 judenj më 1991:

Afrika e Jugut	Kazakistani
Argjentina	Kili
Australia	Letonia
Azerbajxhani	Meksika
Belgjika	Moldavia

Bjellorusia	Rumania
Brazili	Rusia
Britania e Madhe	SH.B.A
Franca	Spanja
Gjeorgjia	Suedia
Gjermania	Turqia
Holanda	Ukraina
Hungaria	Uruguai
Irani	Uzbekistani
Italia	Venezuela
Izraeli	Zvicra
Kanadaja	

“Ata do të shkojnë duke e endur midis kombeve.” - tha Perëndia. Kjo fjalë u përmbush, dhe mbetet e vërtetë edhe sot e kësaj dite – ndonëse që nga fundi i shekullit të XIX, Zoti ka filluar t’i tërheqë ata drejt Izraelit për qëllimet e veta.

Çfarë lidhje ka kjo me mua dhe ty? Ne duhet të pranojmë faktin se fjala e Perëndisë është e vërtetë: jo vetëm premtimet e tij për bekim, por edhe premtimet për gjykim. Kjo është gjithmonë e vërtetë, në çdo epokë dhe në çdo vend, në të gjithë rrethanat. Qielli dhe toka do të kalojnë, por fjalët e tij nuk do të kalojnë kurrë.

Nëse e zbaton Hosean 9 për veten tënde, a je ti ashtu siç është populli i Perëndisë këtu? A ke filluar kohë më parë ta ndjekësh për së mbari Zotin, dhe tani e ke zhgënjyer dhe je prapësuar nga rrëfimi i besimit dhe nga përkushtimi yt ndaj autoritetit hyjnor të Krishtit?

Nëse Perëndia po të thërret që të kthehesh, mos e lër kur të jetë tepër vonë. Mos lejo që fjalët e Jeremias që cituam në kapitullin pararendës të bëhen të vërteta për ty: “Korrja ka mbaruar, vera ka marrë fund, dhe ne nuk kemi shpëtuar”.

Kapitulli 14 - Gibeahu

Ndoshta po mendoni pse në këtë libërth tonin kemi futur kaq shumë gjëra nga libri i Oseas. Përgjigja është e thjeshtë: Osea ishte një profet për të cilin çështja e shkarjes nga besimi dhe e kthimit kishte një kuptim shumë të thellë personal. Atë e kishte lënë e shoqja, dhe Perëndia tha se kjo ishte mënyra sesi populli i Perëndisë e kishte trajtuar Zotin. Por Osea e deshi gruan dhe e mori përsëri; Perëndia tha se këtë gjë donte të bënte edhe ai me popullin e vet.

Ashtu siç e pamë tek kapitulli 10, përvoja jonë e krishterë mund të bëjë një hap të papritur dhe të rëndësishëm përpara, por mund të bëjë edhe një kthesë të papritur e të re prapa - një kthesë që mund të ketë ndikim të thellë dhe serioz edhe për një kohë të gjatë. Tek Osea 10:9 Perëndia thotë: “Që nga ditët e Gibeahut ti ke mëkatuar, o Izrael.” Mos do të thotë kjo se njerëzit nuk mëkatuan para ngjarjes në Gibeah? Mos po jetonin të gjithë pa ndërprerje një jetë me pastërti, devocion, përkushtim dhe bindje gjatë gjithë kohës më përpara? Jo! Sigurisht që jo, sepse kush thotë se nuk ka mëkat, mashtron vetveten. Por ajo që ndodhi në Gibeah shënoi një fazë të re, një fillim të ri në zhvillimin e gjendjes së tyre të mëkatshme. Të shohim se çfarë ndodhi.

Historia na tregohet tek Gjyqtarët 19-21. Është një histori e gjatë, dhe mund ta lexoni vetë në Bibël, me kujdes, duke u menduar dhe duke u lutur. Do ta përmbledh shkurt:

Një farë Leviti mori një konkubinë. Pastaj u zunë, dhe ajo e la për katër muaj. Pastaj ai shkoi ta merrte përsëri, me dashamirësi: nuk u tregua i ashpër dhe gjykues, por e ftoi me mirësjellje që ajo të kthehej me të në shtëpinë e tyre. Ajo pranoi dhe nga mbrëmja u nisën të ktheheshin në shtëpi. Atë natë, arritën deri në Gibeah, por nuk gjetën vend ku të kalonin natën. Së fundi, një burrë plak i ofroi një vend ku të flinin gjatë natës, dhe ata shkuan në shtëpinë e tij, ku u lanë, hëngrën dhe pinë.

Pastaj dolën në skenë homoseksualët e qytetit, dhe i thanë burrit plak (19:22): “Nxirre jashtë atë burrë që ka hyrë në shtëpinë tënde.” Burri plak iu përgjigj: “Jo, vëllezërit e mi, mos u sillni në mënyrë kaq të keqe... mos

kryeni një poshtërsi të tillë.” Homoseksualët po thyenin të paktën tre nga ligjet e Perëndisë:

- Ligji i Përtërirë 26:13 kërkon që të tregohet mirësi ndaj levitëve.
- Levitiku 19:33 kërkon që “kur një i huaj banon bashkë me ju në vendin tuaj, mos e trajtoni keq”.
- Levitiku 18:22 i quan haptazi marrëdhëniet homoseksuale një gjë e neveritshme.

Por pastaj vijoi një natë tmerri, përdhunim nga banda dhe vrasjeje. Sipas fjalëve të shkrimit:

Por ata njerëz nuk e dëgjuan. Atëherë ai burrë mori konkubinën e tij dhe ua nxori atyre; ata e njohën dhe e përdorën tërë natën deri në mëngjes; e lanë të ikë vetëm kur filloi të zbardhë dita. Ndaj të gdhirë kjo grua erdhi e u rrëzua para portës së shtëpisë të njeriut pranë të cilit rrinte burri i saj dhe mbeti aty deri sa u bë ditë.

Në mëngjes burri i saj u ngrit, hapi portën e shtëpisë dhe doli për të vazhduar udhëtimin e tij; dhe ja, konkubina e tij rrinte shtrirë te porta e shtëpisë me duart në pragun e saj. Ai i tha: “Çohu dhe eja të shkojmë!” Por nuk mori asnjë përgjigje.

Të gjithë dalin keq nga kjo histori, përveç burrit plak që i mori në shtëpi dhe konkubinës. Homoseksualët e qytetit ishin burra të korruptuar dhe të dhunshëm, plotësisht të aftë për marrëdhënie seksuale me një grua, pavarësisht nga zgjedhja e tyre – të cilën Bibla e quan të neveritshme. Është e qartë se leviti nuk shqetësohej fare për konkubinën e tij, dhe veprimet e tij në këto vargje përgënjeshtrojnë fjalët e tij të mira që kishte thënë më parë. Ndoshta, ajo e kishte lënë më parë nga karakteri i tij i dobët, dhe prandaj ishte kthyer tek shtëpia e të atit në Betlehem.

Ai e ngarkoi në gomar, iku nga Gibeah dhe u kthye në shtëpi. Aty, mori një thikë dhe e preu gjymtyrë më gjymtyrë, në dymbëdhjetë copa, dhe i shpërndau copat në të gjithë territorin e Izraelit. Dhe të gjithë ata që e panë thanë: “Nuk ka ndodhur kurrë dhe nuk është parë asnjë herë një e gjë e tillë, qysh prej kohës që bijtë e Izraelit dolën nga vendi i Egjiptit e deri më sot”.

Gibeahu, ku ndodhi përdhunimi dhe vrasja, i përkiste fisit të Beniaminit. Fiset e tjera u mblodhën, dhe dërguan njerëz tek Beniamini duke u kërkuar që burrat që kishin bërë këtë ligësi të dorëzoheshin dhe t’i vrisnin, “që të heqim të keqen nga Izraeli”. Ata donin ta pastronin shoqërinë nga kjo

shthurje dhe nga njerëzit që e kishin kryer këtë gjë. Por beniaminitët nuk pranuan.

Kjo shkaktoi luftën, dhe “Zoti mundi Beniaminin përpara Izraelit”. Masakra ishte kaq e madhe sa u vranë 25,000 burra të Beniaminit; vetëm gjashtëqind beniaminitë i mbijetuan betejës. Qyteti i Gibeahut iu nënshtrua shpatës, dhe më vonë edhe qytete të tjera, dhe “izraelitët... vranë me shpatë tërë banorët e qytetit, duke përfshirë edhe bagëtinë dhe gjithçka gjenin; u vunë flakën edhe tërë qyteteve që u dilnin përpara.”

Lufta mund të përshkallëzohet në mizori, brutalitet dhe derdhje gjaku të pafund, ashtu siç e pamë në Kosovë gjatë viteve 1998-1999. Njerëzit nuk kanë ndryshuar.

Tani u shfaq rreziku se mos fisi i Beniaminit zhdukej plotësisht, sepse izraelitët e tjerë ishin betuar të mos martoheshin me ta. “Sot u zhduk një fis i Izraelit. Si do të bëjmë t’u gjejmë gra atyre që shpëtuan?”

Tmerri vazhdon. Ata u kujtuan se asnjë nga Jabesi i Gilaadit nuk kishte ardhur në asamblenë ku vendosën të kërkonin dorëzimin e përdhunuesve, dhe as nuk ishin bashkuar në luftë kundër beniaminitëve. Kështu që mizoria e tepërt e kryer mbi Beniaminin, po ndiqej tani nga një mëkat tjetër, dhe kështu ndodh një masakër tjetër dhe pengmarrje në masë. Ata dërguan në Jabes të Gilaadit 12,000 ushtarë, i vranë të gjithë burrat, fëmijët dhe gratë që nuk ishin të virgjëra. 400 të virgjërat u morën rob dhe iu dhanë 600 beniaminitëve që kishin ngelur. Por ngelën 200. Numri u kompensua nga rrëmbimi i 200 grave të reja që erdhën të kërcenin në festivalin e përvitshëm në Shiloh.

Shkrimtari i Gjyqtarëve na jep një koment të fundit. Pikërisht vargu i fundit i historisë, madje dhe i gjithë librit, thotë: “Në atë kohë nuk kishte asnjë mbret në Izrael; secili bënte atë që i dukej e drejtë në sytë e tij.”

Tani të kthehemi tek Osea 10:9, ku do t’ju kujtohen fjalët: “Që nga ditët e Gibeahut ti ke mëkatuar, o Izrael”. Në fakt, ata vazhduan edhe për rreth 300 vjet të tjera përpara se Osea t’u predikonte. Kjo ishte një kohë e gjatë që Perëndia t’i ndreqte, t’i falte, t’i ndëshkonte dhe t’i thërriste. Por së fundi, durimi sosi dhe u premtua gjykim. Në vargun tjetër Perëndia thotë: “Kur të më pëlqejë do t’i ndëshkoj; popujt do të mblidhen kundër tyre.” Duhet t’i marrim seriozisht kërcënimet dhe fjalët e Perëndisë dhe të veprojmë sipas tyre. Sepse gjykimi erdhi me të vërtetë. Më 722 para K. asirianët pushtuan Izraelin. Mund të lexoni për këtë ngjarje tek 2 Mbretërve 17:5-8.

Pastaj mbreti i Asirisë pushtoi tërë vendin, doli kundër Samarisë dhe e rrethoi gjatë tre vjetëve... i shpërnguli izraelitët në Asiri.

Vargu 7 shpjegon se “kjo ndodhi sepse bijtë e Izraelit kishin kryer mëkate kundër Zotit, Perëndisë të tyre, që i kishte nxjerrë nga vendi i Egjiptit.” Çfarë nënkupton përmendja e Egjiptit? Perëndia i kishte çliruar nën Moisiun nga skllavëria e rëndë nga egjiptianët dhe i kishte sjellë në tokën që u kishte premtuar, një tokë ku buronte qumësht, mjaltë dhe bekim hyjnor. Por ata u kishin kthyer kurrizin bekimeve të mëparshme të Perëndisë.

A të ka bekuar Perëndia në të shkuarën në ndonjë mënyrë që ti e di se ishte e vërtetë dhe reale? Dhe a i ke kthyer kurrizin atij, rrugëve dhe bekimeve të tij? Këto ngjarje janë shënuar në Bibël sepse njerëzit sot janë njësoj si njerëzit e atëhershëm.

Vini re dy mënyrat sesi e përshkruan Perëndia gjykimin që do të dërgojë. Ai thotë:

- Unë do t’i ndëshkoj
- Popujt do të mblidhen kundër tyre.

Perëndia gjendet pas gjykimit; ai është vepër e tij. Por Perëndia zgjedh instrumentin e vet për ta imponuar. Kështu ndodh edhe sot. Nëse Perëndia disiplinon ose ndreq me gjykim fëmijët e tij që kanë shkarë nga besimi – kjo është vepra e tij, por ai vetë zgjedh formën që merr gjykimi dhe “veglat” që përdor.

Madje, edhe në këtë kapitull ku është premtuar gjykimi, në vargun e dytë pas këtij vargu, përsëritet thirrja e Perëndisë që ata të pendohen dhe të kthehen tek ai.

Mbillni për vete sipas drejtësisë, korrni sipas dhembshurisë, lëroni arën tuaj të lënë djerrë, sepse është koha për të kërkuar Zotin, derisa ai të vijë dhe përhapë mbi ju shpëtimin.

“Toka e djerrë” që, ashtu si jeta e tyre, kishte kohë që nuk jepte fryt. Në mënyrë metaforike, ka ardhur koha që të lërohet toka e tillë; thirrja e qartë është se ka ardhur koha që të kërkojnë Zotin. U jepet përsëri premtimi i shpëtimit nëse e bëjnë këtë gjë. Por ata nuk ia vunë veshin, vazhduan në shkarjen e tyre nga besimi dhe në mosbesnikërinë e tyre, dhe gjykimi i premtuar erdhi mbi ta. Perëndia i largoi nga toka e tyre.

Pra, si përmbledhje:

- Mëkati mund të përparojë me një “marsh” të ri ose fazë të re të jetës sate.
- Mund t’u kesh kthyer kurrizin bekimeve të pasura që t’i dha Zoti në të kaluarën.
- Mund të mos kesh pranuar ta heqësh mëkatin, dhe ke shtuar mëkate të tjera.
- Mund ta anashkalojmë ftesën e Perëndisë për t’u penduar, për t’u thyer tek ai që të na falë, dhe për të na pranuar në një fillim të ri në Krishtin.
- Mund të vazhdojmë kështu derisa Perëndia të dërgojë gjykimin.

“Mbillni për vete sipas drejtësisë... sepse është koha për të kërkuar Perëndinë.”

Kapitulli 15 - Era e Lindjes

Efraimi... shkon pas erës së lindjes çdo ditë. – Osea 12:2

Nëse jeton në Angli, era e lindjes vjen nga Rusia, sepse nuk ka pengesa mes maleve Urale dhe vendit ku ndodhesh. Dimrit, i ftohti i saj të than. Por nëse jeton në Izrael, era e lindjes vjen nga shkretëtira siriane, dhe të përvëlton. Kjo ishte era që po ndiqte Efraimi: e nxehtë, e thatë, shkatërruese. Ajo quhet shirok, dhe e shohim të përmendet disa herë në Bibël:

- Zanafilla 41:6 “shtatë kallinj të hollë dhe të tharë nga era lindore”
- Isaia 27:8 “Ai e çoi në një vend të largët me frymën e tij të furishme, një ditë me erë lindore.”
- Jeremia 18:17 “Unë do t’i shpërndaj përpara armikut ashtu si vepron era e lindjes... ditën e mjerimit të tyre.”
- Ezekieli 17:10 “Mos vallë do të thahet krejt kur të preket nga era e lindjes?”
- Jona 4:8 “Perëndia solli një erë mbytëse nga lindja, dhe dielli i ra në kokë Jonës, që e ndjeu veten të ligështuar.”

Efraimi ishte fisi mbizotërues mes dhjetë fiseve të veriut që përbënin Izraelin, dhe këtu ai është simbol për të gjithë Izraelin. Ky varg është pak më i plotë nga sa e cituam më larg, ai fillon:

Efraimi ngopet me erë dhe shkon pas erës së lindjes çdo ditë; ai shumon gënjeshttrat dhe dhunën; bën aleancë me Asirinë dhe çon vaj në Egjipt.

Kombi është përfshirë në katër gjëra me të cilat Perëndia nuk është dakord: gënjeshttrat, dhunën, aleancën me Asirinë, lidhjet me Egjiptin. Dhe ata po i bëjnë “çdo ditë”: pra, ata ngulmojnë për të bërë gjërat me të cilat Perëndia nuk është dakord. Kështu mund të jemi edhe ti dhe unë kur fillojmë të shkasim nga besimi; bëjmë gjëra që një i krishterë nuk duhet t’i bëjë.

Në marrëzinë e tyre, ata mendojnë se mund të shpëtojnë pa u lagur. “Efraimi më qarkon me gënjeshttra dhe shtëpia e Izraelit me mashtrim.”

(12:1) Ata mendojnë se mund ta mashtrojnë Perëndinë; se Perëndia nuk do t'i vërejë ato që bëjnë, nuk do ta kuptojë sesa të rënda janë, dhe se do t'i lërë pa u ndjerë ta hedhin lumin.

Nuk e di sesi janë gjërat në vendin ku jeton, por në Britani, ku kultura dhe filozofia e nënkuptuar e ambientit është pothuajse kryekëput ateiste, njerëzit mendojnë se nuk ka perëndi, dhe si rrjedhim, as standarde të imponuara nga jashtë për atë çka është drejtë dhe e gabuar, dhe mendojnë se nuk do të vijë asnjë gjykim. Njerëzit nuk thonë se nuk ka perëndi; madje shumë njerëz shpallin se Perëndia ekziston. Por ai nuk është aspak si Perëndia i Biblës, sepse ata e kanë shpikur që t'u përshtatet dëshirave të tyre. Trillimi i tyre është një perëndi që i shkel syrin mëkatit, që nuk ndërhyr, dhe që të anashkalon fajin në gjykimin përfundimtar ngaqë ke bërë gjëra të mira që mjaftojnë të balancojnë gabimet e tua, ose ngaqë ai është tepër i mirë që të ndëshkojë ndonjë njeri (ndoshta përveç atyre që konsiderohen *me të vërtetë* të këqij, si Adolf Hitleri). Edhe shoqëria është modeluar në këtë mënyrë, dhe kemi ligje të buta që shpesh e bëjnë jetën më të vështirë për viktimën e krimit sesa për kriminelin; gjyqtarët marrin vendime të buta dhe gati qesharake; qëndrimi mbizotërues i prindërve dhe shkollave është se disiplina dhe ndëshkimi janë të papërshtatshme dhe jashtë mode. Si rezultat, njerëzit bëjnë gjëra të tmerrshme dhe arrijnë të shpëtojnë pa u lagur nga shoqëria. Ata krijojnë kaq shumë eksperiencë të këtyllë gjatë viteve, sa arrijnë të mendojnë se mund të veprojnë kështu edhe para Perëndisë (nëse ka një të tillë). Është e rrezikshme të mendosh dhe veprosh në këtë mënyrë, sepse Perëndia ekziston, dhe ka karakterin e vet, jo atë që i kemi shpikur ne (që të na plotësohen dëshirat tona), dhe ai ka vendosur standardet e të mirës dhe të keqes. Biri i tij do të jetë gjykatësi ynë. Asnjëherë të mos e marrim lehtë këtë gjë.

Në të vërtetë, mëkati ynë është si era e lindjes në Izrael: ai të dëmton, është shkatërrues. Duhet të ruhemi prej tij, jo t'i vihemi pas.

Po kështu, meditoni për një çast në lidhje me përshkrimin e asaj që po bën Efraimi. A keni parë ndonjëri të përpiqet ta hajë erën? Mund të hash lloj lloj ushqimesh, por nuk mund ta hash erën. Efraimi po bën një marrëzi. Ne jemi të marrë kur mëkatojmë, dhe sidomos kur ngulmojnë në mëkat, ashtu si po bënte Efraimi.

Tani të shkojmë tek Osea 13:15

Edhe në rast se është frytdhënës midis vëllezërve të tij, do të vijë nga shkretëtira era e lindjes, do të ngrihet nga shkretëtira era e Zotit, atëherë burimi i tij do të thahet, gurra e tij do të shterojë. Ai do të plaçkitë thesarin e çdo ene të çmuar.

Çfarë ka ndodhur?

Metafora është kthyer në krahun e kundërt: tani është era që po e ndjek Efraimin! Dhe kjo është ajo që ndodh kur ngulmojmë në mëkat dhe në shkarjen nga besimi. Në fillim, i kemi gjërat nën kontroll, marrim vendimin të shkasit mbrapsht në mëkat dhe larg prej Zotit. Mendojmë se mund të shkojmë deri në njëfarë pike, dhe pastaj të ndalojmë. Pastaj mëkati merr kontrollin, dhe na merr përpara. Tani është ai që na sundon.

Ju lutem, vini re se ajo është era e Zotit. Perëndia shikon shkarjen tonë të vazhdueshme nga besimi, dhe në fund e thekson zgjedhjen tonë dhe e vë në zbatim. Ne zgjedhim mëkatin: Ai na e jep, dhe në masë më të plotë se ç'e parashikuam. Humbasim kontrollin mbi vetveten, mbi mendimet, planet dhe sjelljen tonë. Perëndia na ka lejuar të marrim atë që zgjedhim.

Nëse i kthen kurrizin Zotit tënd dhe zhytesh në mëkat, ngulmon në të, në fund mëkati do të të ndjekë dhe të të marrë nën kontroll.

Vargu tjetër (13:16) na tregon se tani Perëndia do të ndëshkojë dhe ndreqë. “Samaria [një emër tjetër për veriun] do të shkretohet... Do të bien nga shpata...” Në fakt u profetizuan gjëra të tmerrshme: “... fëmijët e tyre do të bëhen copë-copë dhe grave të tyre me barrë do t’u çajnë barkun.”

Ajo që Osea po parashikonte ishte sulmi asirian, por ata ishin “era e Zotit” për të cilën lexuam tek vargu 13:15. Kur vjen ndreqja, duhet të tregohemi të mençur që të dallojmë si instrumentin, ashtu edhe dorën e Perëndisë pas tij.

Perëndia u dha zgjedhjen e tyre, dhe ishte mjaft më e keqe se ç'e kishin parashikuar. C. S. Lewis ka thënë se, në fund të fundit, ka vetëm dy lloj njerëzish. Duke përdorur fjalët e lutjes së Zotit, njëri lloj i thotë Zotit: “U bëftë vullneti yt”, dhe ecën me Perëndinë. Lloji i dytë është e kundërta: ai nuk pranon rrugën e Perëndisë, dhe në fund Perëndia i thotë: “U bëftë vullneti yt.” Perëndia i jep atë që ai ka zgjedhur, bashkë me të gjitha pasojat e tmerrshme të jetës dhe vdekjes larg Perëndisë.

Nëse je larg Perëndisë, ka ardhur koha që ta kërkosht atë. Ktheu tek ai tani, përpara se të jetë tepër vonë.

Kapitulli 16 - Dilema e Perëndisë

Më pëlqen të predikoj ose të shkruaj për Perëndinë dhe për ndëreveprimin e tij me ne nga ato që di nga përvoja, por has një problem në librin e Oseas, që ndoshta na çon më thellë në zemrën e Perëndisë sesa çdo libër tjetër në Bibël. Ai është një vend i shenjtë ku vijmë me nderim. E pranoj se nuk i kam përjetuar të gjitha ato që shikoj tek Osea, por i dëftoj në largësi, si të thuash, për të treguar se ku na është urdhëruar të vijmë në marrëdhënien tonë me Perëndinë.

Tek kapitulli 11 është njësoj sikur përgjojmë një dialog të brendshëm që Perëndia mban brenda vetes, sepse gjendet në mes të një dileme. Ai është i tërhequr në dy drejtime të ndryshme, njëri që do të jetë i keq për popullin e tij, dhe tjetri që do të jetë lajm i mirë për ta.

<u>Lajmi i mirë</u>	<u>Lajmi i keq</u>
vargu 1	vargu 2
vargjet 3-4	vargjet 5-7
vargjet 8-9	

T'i shqyrtojmë një nga një.

Tek vargu 11:1, Perëndia hedh vështirimin prapa kur shpëtoi popullin e tij nga skllavëria në Egjipt: “Kur Izraeli ishte fëmijë, unë e desha dhe nga Egjipti e thirra birin tim.” Këtu dëgjojmë Perëndinë që po mediton për dashurinë që ka për popullin e vet dhe për veprat e tij të mëshirës dhe udhëheqjes në të shkuarën.

Por në vargun 2 ai thotë: “Sa më shumë i thërrisnin profetët, aq më tepër janë larguar prej tyre, u kanë bërë fljime Baalëve, dhe u kanë djegur temjan figurave të gdhendura.” Këtu Perëndia po e kthen vëmendjen tek mosbesnikëria e tyre, “kurvëria” e tyre, siç quhet diku tjetër, - sepse ata e kanë braktisur Zotin, “bashkëshortin” e vërtetë, dhe u janë kthyer perëndive të rreme.

Pastaj (v. 3-4) vëmendja e tij kthehet tek dashuria dhe marrëdhënia që ekzistonte në të kaluarën.

Unë vetë i mësova Efraimit të ecë, duke e mbajtur nga krahët; por ata nuk e kuptuan që unë po i shëroja. Unë i tërhoja me litarë të dashamirësisë njerëzore, me lidhje dashurie; isha për ta si ai që e ngre zgjedhën nga qafa e tyre, dhe përulesha për t'u dhënë të hanë.

Kjo është shkruar me fjalë tepër njerëzore për të na ndihmuar të kuptojmë. Mendoni se me çfarë krenarie i shikojnë prindërit e kënaqur fëmijët tek hedhin hapat e parë, dhe me sa durim i ndihmojnë që të mësojnë të ecin duke u lëkundur dhe pastaj të ecin me siguri! Kur janë ende duke mësuar, ose kur lodhen ose vriten, prindërit i marrin në krahë për një çast. Perëndia thotë që i ka bërë të gjitha këto për popullin e vet, madje edhe e ka drejtuar, duke ia lehtësuar barrën, duke e ushqyer dhe – ashtu siç duhet të jetë çdo prind i kujdesshëm për fëmijët – duke u përkulur mbi të. Çfarë pamje dashurie e butë dhe e duruar!

Por pastaj, në tre vargjet e tjera (5-7) Perëndia mendon përsëri për mëkatën e tyre të vazhdueshëm dhe kokëfortë, dhe vendos që ata duhet të dënohen për këtë:

Izraeli nuk do të kthehet në vendin e Egjiptit; por Asiri do të jetë mbreti i tij, sepse nuk kanë pranuar të konvertohen. Shpata do të bjerë mbi qytetet e tij, do të shkatërrojë shufrat e tyre dhe do t'i hajë për shkak të planeve të tyre të këqija.

Pse? Sigurisht, jo sepse nuk ka dashuri në zemrën e Perëndisë për ta. Përkundrazi, në vargun 7 thuhet: “Populli im synon të largohet nga unë; megjithatë e thërresin Shumë të Lartin, asnjë prej tyre nuk e përlëvdon”.

Pra, me sa duket, Perëndia ka marrë vendimin përfundimtar. Por ai vazhdon të mendojë në vargjet 8-9; dialogu i brendshëm dhe dilema vazhdojnë:

Si mund të të braktis... të të lë në dorë të të tjerëve... Zemra ime ngashërohet brenda meje, dhembshuria ime ndizet e tëra. Nuk do ta shfryj zemërimin tim të zjarhtë, nuk do ta shkatërroj.

E gjithë kjo, siç shkrova edhe më sipër, është kaq madhështore sa s'e rrok dot. Kjo më jep një vështirësi të shpejtë të dashurisë së Perëndisë që më bën të ndihem si njeri që ka hyrë me forcë. Nuk duhet ta dëgjoj debatin e Perëndisë dhe ankthin brenda vetes. Por ja, ku e kemi në shkrim! Ai do që ta dëgjojmë dhe të mësojmë më shumë për zemrën e tij të dashur.

Çfarë ka ndodhur në të vërtetë? Kapitulli 12 dhe 13 na sjell tek vendimi përfundimtar i Perëndisë: ai do t'i ndëshkojë dhe do t'i shkatërrojë me të vërtetë:

Do të të bëj që të banosh akoma në çadra... Zoti i tij do të bëjë që mbi të të bjerë gjaku i derdhur dhe do të bëjë që mbi të të kthehet turpi i tij... Unë do të jem për ta si një luan... si leopard... si një arushë që ia kanë marrë këlyshët... do t'ia ha si një luaneshë, bishat e fushave do t'i shqyejnë. Ti je shkatërruar, o Izrael... Samaria [mbretëria e veriut] do të shkretohet, sepse ka ngritur krye kundër Perëndisë së saj. – 12:10, 15; 13:7-9, 16

Kapitulli 13 mbyllet me një pamje tronditëse të “grave të tyre me barrë [që] do t'u çajnë barkun.”

Megjithatë, edhe pas këtij vendimi tek kapitujt 12-13, Perëndia zgjat durimin dhe i fton përsëri të kthehen. Ja disa fjalë nga kapitulli 14, kapitulli i fundit i librit të Oseas:

O Izrael, ktheu tek Zoti, Perëndia yt, sepse ke rënë poshtë për shkak të paudhësisë sate... i thoni: 'Largo çfarëdo paudhësi dhe prano atë që është e mirë, dhe ne do të ofrojmë fljimet e buzëve tona.'

Unë do të shëroj shthurjen e tyre, do t'i dua shumë, sepse zemërimi im u tërhoq prej tyre... Ata që jetojnë në hijen e tij do të kthehen dhe do të rigjallërohen... Unë do ta kënaq dhe do të kujdesem për të.

Perëndia e dinte se ata nuk do ta pranonin edhe këtë thirrje të fundit, këtë ftesë që shprehet me kaq shumë dashuri në kapitullin 14. Por ftesa, thirrja, ishte e sinqertë. Madje edhe në atë çast, në harmoni me dashurinë dhe mëshirën e Perëndisë, tek kapitulli 11:10-11 lexojmë përsëri se, pas shkatërrimit të premtuar, - të cilin Perëndia vendos të kryente për shkak se nuk pranuan të pendoheshin - pati një premtim se një brez i ardhshëm do të kthehej në të ardhmen e largët:

Bijtë e tij do të rendin drejt tij nga perëndimi duke u dridhur... nga Egjipti... nga vendi i Asirisë; unë do t'i bëj të banojnë në shtëpitë e tyre.

Në këtë libër të mrekullueshëm gjendet një thirrje për ne të krishterët. Në Krishtin, fjalët e gjykimit – si dhe vetë gjykimi – që janë shqiptuar tek Osea kthehen mbrapsht, dhe hyn në veprim ringjallja. Sepse Osea 13:14 i bën thirrje vdekjes dhe ferrit: “O vdekje, unë do të jem murtaja jote. O Sheol, unë do të jem shkatërrimi yt. Pendimi është i fshehur nga sytë e mi.” Ose, më qartë në përkthimin e Dom Filipajt: “Do t'i çliroj nga dora e Nëntokës?

Vallë prej vdekjes t'i shpëtoj? Ku është, o vdekje, murtaja jote? Ku është, Nëntokë, murtaja jote? Dhimja u fsheh prej syve të mi!” Perëndia thërret vdekjen dhe ferrin që të sjellin gjykimet mbi popullin e vet. Apostulli Pal e përdor pikërisht këtë varg tek 1 Korintasve 15:55-57 dhe e kthen anembrapsht, duke e kthyer në një pyetje retorike, ku tall vdekjen dhe ferrin sepse ato e kanë humbur pushtetin mbi ata që janë strehuar në Krishtin: “O vdekje, ku është gjembi yt? O ferr, ku është fitorja jote?... Por ta falënderojmë Perëndinë që na jep fitoren me anë të Zotit tonë Jezu Krisht.”

Ashtu siç shkroi Shën Athanasi në veprën e tij *De Incarnatione Verbi Dei* (Mbi Mishërimin e Fjalës së Perëndisë):

Vdekja është mposhtur dhe damkosur siç i takon nga Shpëtimtari në Kryq. Është lidhur kokë e këmbë, të gjithë ata që janë në Krishtin e shkelin me këmbë kur kalojnë dhe, si dëshmitarë të tij, e përqeshin, e tallin vdekjen dhe thonë: “O vdekje ku është fitorja jote? O ferr ku është thumbi yt?”

Sado gjatë dhe sado larg të jesh endur, në Krishtin thirrësh që të kthehesh dhe të gjesh përsëri mëshirë në të: mëshirë dhe jo gjykim, sepse ai mbarti gjykimin për ne në vendin tonë në Kalvar. Dhe kjo mëshirë ndiqet nga siguria e fitores kur ti kalon përmes vdekjes, për në përjetësi. E shkroi mirë Pali: Ta falënderojmë Perëndinë!

Vargu i fundit i Oseas lëshon një thirrje për të gjithë lexuesit e librit të tij: “Kush është i urtë, t’u kushtojë kujdes këtyre gjërave. Kush ka mend le t’i kuptojë ato. Sepse rrugët e Zotit janë më të drejta; të drejtët do të ecin nëpër to, por shkelësit do të rrëzohen.”

Kapitulli 17 - Një shans i dytë

Ekzistojnë parime të sjelljes së përgjithshme të krishterë që janë për të gjithë fëmijët e Perëndisë, dhe ekzistojnë edhe rrugë me anë të të cilave ai jep një udhëheqje personale për shërbesën ku na thërret individualisht. Për këtë të fundit, mund të lexoni librin e Misionit Ungjillor “Delet e Mia e Dëgjojnë Zërin tim” – titulli i të cilit, sigurisht, vjen nga premtimi që Zoti u dha pikërisht me këto fjalë ndjekësve të vet. Perëndia nuk pranon alternativa: nuk mund t’i themi, “Zot, dua të të shërbej, por nuk dua të bëj këtë, pra më jep një thirrje tjetër.” Duhet t’i bindemi. Nëse ngulmojmë për një kohë të gjatë në mosbindje, siç e kemi parë në faqet e mëparshme, Perëndia do ta theksojë zgjedhjen tonë dhe do të na lejojë të vuajmë pasojat, me gjithë zhgënjimin, mungesën e përmbushjes dhe gjithë pasojat e tjera të vajtueshme.

Për trishtimin tonë të thellë, disave prej nesh – ndoshta shumicës prej nesh – u del huq herën e parë. Nuk i bindemi Perëndisë.

Ose ndoshta, përpiqemi me tërë mend të bindemi, por bëjmë gabime të rënda, dhe na shkon keq.

Them “herën e parë”: por ndoshta e bëjmë më tepër se një herë. Më vonë, kur e kuptojmë dhe e pranojmë që kemi humbur rrugën dhe nuk po bëjmë vullnetin e tij, do të donim të kishim edhe një shans tjetër; do të donim të fillonim nga e para. A është e mundur që Perëndia të na japë një shans të dytë të tillë?

Dua të shikojmë tre personazhe të Biblës: njëri nxitoi para Perëndisë dhe gaboi; njëri e dinte thirrjen e Perëndisë por iku prej saj; një e mohoi plotësisht Zotin. Sipas radhës, ata ishin: Moisiu, Jona dhe Pjetri.

Të nisim me Moisiun. Tek Eksodi 2:11-15, ai shikon një egjiptian që rreh një hebre, kështu që e vret egjiptianin dhe e varros në rërë. Mendoj se asnjë nuk e kishte parë. Të nesërmen, ai pa dy judenj që po ziheshin dhe duke u përpjekur t’i pajtojë, pyet atë që filloi sherrin se pse po qëllonte shokun e vet jude. Burri iu përgjigj: “Mos do të më vrasësh siç vrave egjiptasin?”

Padyshim që Moisiu kishte të drejtë të mendonte se duhet të bënte diçka që të çlironte judenjtë nga shtypja e egjiptianëve: por bëri gabim kur u

përpoq ta bënte në këtë mënyrë, Megjithatë: “ai mendonte se vëllezërit e tij do ta kuptonin se Perëndia do t’u jepte çlirimin me anë të tij.” (Vep. 7:25)

Kur e kuptoi se të gjithë e dinin për vrasjen, ai u frikësua. Gjërat u përkeqësuan: Faraoni e mori vesh ngjarjen. Kështu që Moisiu iku nga Faraoni dhe u vendos si mërgimtar në vendin e Midianit. Aty gjeti një grua, krijoi familjen dhe qëndroi për dyzet vjet (Vep. 7:30).

Dyzet vjet është një kohë goxha e gjatë për të qenë larg punës që Perëndia do prej teje. Por tek Eksodi 3 lexojmë për shansin e dytë që ai pati për t’i shpëtuar judenjtë nga shtypja. Ishte koha e duhur për Perëndinë, dhe Perëndia ia shpalosi mënyrën e vet. Në vargun 10, Perëndia i thotë: “Prandaj eja dhe unë do të të dërgoj te Faraoni me qëllim që ta nxjerrësh popullin tim, bijtë e Izraelit, nga Egjipti.” Tek kapitulli tjetër (4:20) lexojmë se “Moisiu mori të shoqen dhe bijtë e tij... dhe u kthye në vendin e Egjiptit.” Kapitujt që vijojnë tregojnë për bindjen, mundimet dhe suksesin e tij për të përmbushur çlirimin e judenjve nga skllavëria e egjiptasve. Perëndia i kishte dhënë një shans të dytë, pasi Moisiu ishte nxituar përpara se të vinte çasti i duhur, dhe përpara se të merrte vesh metodën e duhur.

Një predikues i njohur baptist në Angli, Stanley Delves, kishte kaq merak se mos gabonte që të ecte një hap përpara Perëndisë për të bërë diçka që donte të bënte, sa kur ndjeu thirrjen e Perëndisë për të predikuar, menjëherë pas mbarimit të luftës së parë botërore, shkroi:

E ndjeva këmbënguljen e kësaj fjale në mendjen time aq shumë sa nuk mund të mos mendoja se ishte nga Perëndia: “Shiko, kam vendosur para teje një derë të hapur, dhe askush nuk mund ta mbyllë.” Mendova kështu: “Tani nuk do them asgjë në lidhje me këtë. Do të hesht sepse nëse kjo fjalë është vërtetë nga Zoti, ai do të më hapë një derë në shërbesë pa qenë nevoja ta përmend këtë çështje.”

Disa javë më vonë, në shtator 1919, kur Stanley ishte kthyer në shtëpi në Sussex, i erdhi një letër nga një njeri që nuk e njohte, njëfarë z. Lancelot Vinall, në lidhje me një kishëz që ishte mbyllur gjatë luftës dhe po rihapej. Në letër, z. Vinall e ftoi Stanley-n të shkonte dhe të drejtonte shërbesën e së dielës. Stanley shkroi:

Nuk njihja asnjëri që shkonte në atë kishë. Nuk i kisha thënë asnjëriu dhe ja ku vjen kjo letër dhe më pyet nëse doja të flisja në këtë kishëz.

Ai kërkoi këshillën e pastorit të vet, i cili iu përgjigj se mendonte që ai do të thirrej në shërbesë dhe se kështu mendonin edhe të tjerët. Ai shkoi dhe predikoi atë të dielë dhe bashkësia e vogël prej pesë ose gjashtë vetësh e ftoi që të vinte përsëri. Ky ishte fillimi i një shërbese që përfshiu pesëdhjetë e katër vjet si pastor i një kishe në Crowborough, dhe përfundoi me daljen e tij në pension në fund të vitit 1977.

Nuk po them se të gjithë duhet të ndjekin modelin që Stanley Delves mendoi se ishte i drejtë për të, në lidhje me shërbesën ndaj Perëndisë; por jam i bindur se ai është një shembull i parimit që t'i besosh Perëndisë të konfirmojë thirrjen e tij duke hapur një derë për ne ndërsa ne ecim përpara dhe i shërbejmë atij.

* * *

Në atë kohë, Moisiu nuk priti kohën dhe mënyrën e Perëndisë, por ishte kaq i zellshëm të bënte punën e Perëndisë sa u nxitua në kohën e gabuar dhe gaboi. Njeriu tjetër, Jona, ishte tërësisht e kundërta: Ai e dinte saktësisht se çfarë donte Perëndia dhe se kur e donte, por i mungonte kaq shumë dëshira për ta bërë sa u arratis në drejtimin e kundërt. Këtë mund ta lexoni tek Jona 1:1-3:

Dhe fjala e Zotit iu drejtua Jonas..., 'Çohu, shko në Ninive, qytet i madh, dhe prediko kundër tij...' Por Jona u ngrit për të ikur në Tarshish, larg pranisë së Zotit... gjeti një anije që shkonte në Tarshish. Pagoi çmimin e caktuar dhe hipi në anije... larg pranisë së Zotit.

Siç mund të merret me mend, gjërat i shkuan shumë keq. Ndodhi një fatkeqësi pas tjetrës, derisa Jona i thirri mendjes dhe u lut:

Atëherë Jona iu lut Zotit, Perëndisë së tij..., 'Por unë me zëra lëvdimi do të ofroj flijime dhe do të plotësoj betimet që kam bërë.' – Kapitulli 2

Pastaj, thirrja e Perëndisë iu drejtua për herë të dytë. Ishte e njëjta thirrje; Perëndia nuk kishte ndryshuar mendje. “Çohu, shko në Ninive, qyteti i madh, dhe shpalli atij mesazhin që po të urdhëroj.”

Ai e kishte marrë mësimin; mësoi me të keq, duke vuajtur rezultatet e trishta dhe të parehatshme të mosbindjes. U ngrit dhe shkoi në Ninive, sipas fjalës së Zotit. Kur predikoi, njerëzit e Ninivesë i besuan Perëndisë, shpallën një agjërim, dhe shprehën një hidhërim të thellë për mëkatet e tyre. Madje, edhe mbreti u bashkua me pendim të vërtetë, dhe nxori një urdhër se qyteti duhet të agjëronte dhe t'i thërrisnin me forcë Perëndisë, të ktheheshin

nga rrugët e tyre të liga dhe nga dhuna, me shpresë se Perëndia do ta largonte zemërimin e tij dhe ata nuk do të humbnin. Dhe Perëndia iu përgjigj sipas lutjeve të tyre.

Në Angli ka jetuar një cigan, lindur më 1860, i quajtur Rodney Smith. Ai u bë ungjilltar metodist. Babai im e ka dëgjuar kur ai fliste në një kishë që ishte ndërtuar për të mbajtur 850 njerëz, dhe cigani ishte bërë kaq i njohur si predikues, sa kisha ishte mbushur plot për një takim burrash. Një herë, më 1893, një njeri i arsimuar i kërkoi disa herë ciganit që të lutej për të, por dukej sikur nuk po gjente lehtësim ose bekime. Ky njeri që kishte shkarë nga besimi kishte qenë më përpara mësues në klubin e fëmijëve, por kishte hequr dorë nga kjo punë në zemërim e sipër.

“O, kjo qenka!” – tha Rodney Smith. “Ti hoqe dorë nga puna që Perëndia të kishte dhënë. Duhet të kthehesh njëherë aty, dhe pastaj do të gjesh paqe në zemër.” Burri e ndoqi këshillën, dhe disa ditë më vonë erdhi ta takonte përsëri Rodney Smith-in. “Bëra siç më the, dhe m’u kthye i tërë gëzimi i mëparshëm!” – tha ia.

Në himn anglez përmban pyetjen: “Ku është bekimi që njihja, kur për herë të parë pashë Zotin?” Cigani Smith i thoshte njerëzve se bekimi ishte aty ku e kishin lënë, dhe kjo temë u rrënjos në predikimin e tij “Krishti i Humbur”, të cilin e kanë dëgjuar me mijëra dhe që është predikuar edhe në radio: “kjo ndodh ngaqë ti e kështu Krishtin, jo ngaqë ai të ka lënë ty. Dhe ai po të pret pikërisht aty ku e le.”

* * *

Moisiu nxitoi; Jona u arratis; por Pjetri mohoi krejtësisht se e njihnte Jezusin. Ja saktësisht fjalët e tij: “Unë nuk e njoh” (Llk. 22:57). Në fakt, ai e mohoi Jezusin tre herë. S’ka asnjë dyshim se nëse ekziston një njeri që do të refuzohet nga qëllimi i Perëndisë dhe që nuk do t’i jepet një shans për t’u përmirësuar në të ardhmen, atëherë ky njeri duhet të jetë Pjetri.

Por, jo! Në fakt, Jezusi e dinte që më përpara se Pjetri do të bënte pikërisht atë gjë, dhe e kishte parathënë. Pjetri kishte deklaruar guximshëm: “Zot, unë jam gati të shkoj bashkë me ty edhe në burg edhe në vdekje.” (v. 33-34). Pas këtyre tre mohimeve, Jezusi u kthye dhe pa nga Pjetri, dhe Pjetrit iu kujtua parashikimi. Atij iu thye zemra për dobësinë dhe mosbesnikërinë e vet, dhe (v. 62) doli përjashta e qau me hidhërim. Duhet të ketë menduar se e kishte humbur mundësinë për t’i shërbyer Jezusit gjatë

pjesës së mbetur të jetës së vet; se do të lihej mënjanë, i refuzuar si i padenjë, i lënë në turp dhe keqardhje.

Pothuajse pikërisht në fund të Ungjillit sipas Markut, një engjëll tek varri i Jezusit – pasi Jezusi ishte ngritur nga vdekja, - u thotë tre grave që kishin ardhur tek varri: “U thoni dishepujve të tij dhe Pjetrit se ai po ju pararend në Galile; atje do ta shihni.” Ç’fjalë mbresëlënëse! Ai nuk ishte refuzuar si i pavlerë për shkak të rënies së tij. Ai do të mëkëmbej. Dhe përsëri, në kapitullin e fundit të Ungjillit sipas Gjonit, Jezusi personalisht e riurdhëron Pjetrin: “Kulloti qengjat e mi... Ki kujdes për delet e mia... Kulloti delet e mia... Ndiqmë.” (Gjn. 21:15-19) Ai e ndoqi, dhe fitoi reputacionin e një shtylle të kishës (Gal. 2:9). Durimi, hiri dhe mëshira e kthyen përsëri në punën e Zotit. Atij iu dha një shans i dytë.

Thomas Cranmer ishte Kryepeshkopi i Canterbury në Angli gjatë shekullit të XVI. Ai u burgos në Londër dhe Oksford për besimin e tij. Pas 2 vjet e gjysmë burgimi, ai firmosi një dokument ku tërhiqej nga bindjet e tij, por prapëseprapë Mbretëresha firmosi urdhrin e vdekjes, duke e dënuar me vdekje me zjarr: pra, të digjej i gjallë. Pastaj, e nxorën për pak kohë nga burgu, dhe i premtuan t’i kthenin jetën dhe postin e Kryepeshkopit nëse do të firmoste një deklaratë tjetër, një mohim të plotë të bindjeve të tij: “Unë heq dorë, ndjej neveri dhe i urrej të gjitha llojet e herezive dhe gabimeve të Lutherit dhe Zwinglius... E pranoj Peshkopin e Romës si kreun suprem në tokë... dhe si përfaqësuesin e Krishtit, të cilit duhet t’i nënshtrohen të gjithë njerëzit e krishterë.” Pas burgimit, lirimit, premtimeve, kërcënimit me vdekje nëse nuk pranonte të pendohej, nervat e lanë. I mposhtur nga vetmia dhe dobësia njerëzore, ai firmosi dokumentin, i cili ishte formuluar nga të tjerët që më përpara.

Aty përfundoi shpresa e tij për liri. E dërguan menjëherë në burg në Oksford. Më 20 mars 1556, Mbretëresha dërgoi urdhër se duhet të vdiste në zjarr të nesërmen. Mëngjesi erdhi me qiell të zymtë dhe shi pa fund, por turmat u mblodhën. Kryepeshkopi kishte veshur një mantel të rreckosur dhe të vjetruar. Bëri këtë deklaratë:

Përderisa dora ofendoj duke shkruar kundër zemrës sime, atëherë ajo do të ndëshkohet e para... do të digjet e para.

Turrën e druve e kishin vendosur në rrugë, dhe e lidhën pas hurit me një tel çeliku. 250 shkarpave të gjineshtrës dhe drurit në këmbët e tij iu vu

zjarri. Kur zjarri mori për lart, ai hapi krahun dhe e mbajti dorën e djathtë në flakë derisa iu dogj në cung. Ndërsa po vdiste, thirri: “Zoti Jezus, pranoje frymën time!”

Mëshirë ka edhe për ata që e kanë mohuar besimin e vet dhe Zotin e tyre, nëse janë vërtetë të hidhëruar për atë që kanë bërë.

* * *

Ndoshta ti ke qenë si një prej tyre. Ke dashur shumë t’i shërbesh Perëndisë, por ke keqinterpretuar kohën dhe mënyrën, dhe i ke katranosur keq gjërat. Ndoshta s’arrite t’i bindeshe dot kur e dije se çfarë donte, kur e dëgjove thirrjen e tij, dhe je larg prej punës tek e cila të drejtoi ai. Ndoshta e ke mohuar fare faktin se je i krishterë, dhe tani mendon se Krishti nuk do të të japë pjesën e shumëpritur në punën e tij, të cilën mezi po prisje ta bëje. Ndoshta, ashtu si mohimet e Pjetrit, kjo ka ndodhur kohët e fundit dhe u pendove menjëherë për rënien tënde; ndoshta ka ndodhur kohë më parë – mos harro, me Moisiun kishte ndodhur që para 40 vjetësh. Por qoftë tani ose kohë më parë, nëse Perëndia po të shtyn nga e para që t’i tregosh për hidhërimin tënd dhe nëse je i gatshëm t’i bindesh tani kudo që të të dërgojë, për të bërë çfarëdolloj gjëje që ai të vendos përpara, thuaj lutjet e duhura, pendohu, dhe ofroji përsëri shërbimin besnik të jetës sate, të të gjitha ditëve ose viteve që të kanë ngelur, të cilat ai do të të japë për të jetuar dhe punuar për lavdi të tij.

Kapitulli 18 - Sërisht Betheli

Për meditim e fundit nga Dhiata e Vjetër, shkojmë tek libri i profetit Amos. Në kapitullin 5:4-5 Perëndia thotë nëpërmjet profetit të tij: “Më kërkon dhe do të rroni, por mos kërkon Bethelin.” Do të përpiqemi të kuptojmë domethënien e këtyre fjalëve.

Dëgjuesit e Amosit po jetonin në lavdinë e së shkuarës, por jo në realitetin e tanishëm të Perëndisë. Këtë gjë mund ta bëjë edhe ndonjë denominacion, ose ndonjë kishë lokale. Shërbëtori i Zotit mund të jetojë mes suksesit dhe bekimit që Perëndia i ka dhënë në të shkuarën; i krishteri mund të jetojë në kujtimin e bekueshmërisë që ka përjetuar dikur, ndoshta kur është kthyer në besim dhe gjatë muajve ose viteve të para të jetës së tij të krishterë. Ne tundohemi gjithmonë të jetojmë në të shkuarën, dhe kjo shoqërohet me tundimin që të lejojmë që standardet e së tashmes të jenë më të ulëta. Por feja e vërtetë nënkupton kthimin nga mëkati dhe përjetimin e Zotit në të tashmen, si edhe përkushtimin nga zemra.

Betheli ishte një nga tre vendet ku fiset veriore të judenjve bënë pelegrinazhin. Tek Zanafilla 28, Jakobi pati aty një takim të vërtetë me Perëndinë atje, mori disa premtime goditëse nga Perëndia, dhe iu betua Perëndisë:

Dhe ja, Zoti ndodhej në majë të saj dhe i tha: ‘Unë jam Zoti, Perëndia i Abrahami, babait tënd, dhe Perëndia i Isakut; tokën mbi të cilën je shtrirë do të ta jap ty dhe pasardhësve të tu; dhe pasardhësit e tu do të jenë si pluhur i tokës, dhe ti do të shtrihesh në perëndim dhe në lindje, në veri dhe në jug; dhe tërë familjet e tokës do të bekohen nëpërmjet teje dhe pasardhësve të tu. Dhe ja, unë jam me ty dhe do të të mbroj kudo që të vesh, dhe do të të sjell përsëri në këtë vend; sepse nuk do të të braktis para se të bëj atë që të kam thënë.’ – Zanafilla 28:13-15

Jakobi komentoi: “Sa i tmerrshëm është ky vend! Kjo nuk është tjetër veçse shtëpia e Perëndisë, dhe kjo është porta e qiellit.” Dhe u betua:

Në qoftë se Perëndia do të jetë me mua dhe do të më mbrojë gjatë këtij udhëtimi që jam duke bërë, në qoftë se do më japë bukë për të ngrënë dhe rroba për t’u mbuluar, dhe do të kthehem në shtëpinë e babait tim në

paqe, atëherë Zoti do të jetë Perëndia im; dhe ky gur që kam ngritur si përmendore, do të jetë shtëpia e Perëndisë; dhe nga të gjitha ato që do të më japësh, unë do të jap të dhjetën.” - Zanafilla 28:20-22

Njëzet vjet më vonë, tek Zanafilla 35, ai u takua përsëri aty me Perëndinë, dhe Perëndia i dha emrin Izrael - ashtu siç quheshin akoma dhjetë fiset kur Amosi po u predikonte. Edhe një herë tjetër, ai mori një premtim nga Perëndia: “Unë jam Perëndia i plotfuqishëm... Do të të jap ty dhe pasardhësve të tu pas teje vendin që i dhashë Abrahamit dhe Isakut.” – një premtim që është i vlefshëm edhe sot e kësaj dite.

Tek 2 Mbretërve 2, shikojmë profetët Elia dhe Elisha në Bethel – dy nga profetët më të mëdhenj qoftë në fjalë, ashtu dhe në vepra, që kanë lindur ndonjëherë në Izrael. Në Bethel kishte një “shkollë profetësh”, dhe Elia dhe Elisha shkuan aty në udhëtimin e fundit që bënë së bashku, në fund të të cilit Elia u mor në qiell me një qerre e zjarrtë, një nga dy njerëzit e vetëm që janë marrë drejtpërdrejt në qiell pa kaluar në vdekje – tjetri ishte Enoku.

Por tani, nëpërmjet Amosit, Perëndia thotë: “Më kërkoni dhe do të rroni, por mos kërkoni Bethelin.” Sa e çuditshme! Vetë emri i tij do të thotë “shtëpia e Perëndisë” – një vend ku Perëndia ishte shfaqur dhe ku kishte dhënë bekimet e tij. Është mirë të dimë se çfarë ka bërë Perëndia në të shkuarën; mund të mësojmë shumë prej saj për jetën dhe shërbesën tonë. Por këtyre njerëzve, në kohën e Amosit, u mungonte realiteti i së tashmes. Ata po shikonin *vetëm* drejt së shkuarës. Në vargjet 4:4-5 dhe 5:21-22 Amosi u predikon:

Shkoni në Bethel dhe kryeni mëkate... sepse kështu ju pëlqen të veproni... Unë i urrej, i përçmoj festat tuaja, nuk ndjej asnjë gëzim në mbledhjet tuaja solemne... Unë nuk do t'i pëlqej.

Ata nuk e kishin larguar mëkatin e tyre: “Ja sytë e Zotit, Zotit, janë mbi mbretërinë mëkatore.” (v. 9:8)

Ja ku qëndronte gabimi i tyre: ata mendonin se ngaqë qëndronin mbi atë traditë, ishin pjesë e atij bekimi. Por asnjëherë nuk ndodh kështu. Ti mund t'i përkasësh Kishës Ortodokse dhe shikon në të shkuarën ditët e lavdishme të Athanasit dhe Gjon Gojartit, ose mbijetesën e kishës nën sundimin Otoman. Mund të jesh katolik, dhe shikon në të shkuarën Gregorin e Madh, Bernardin e Clairvaux, Francisin e Assisit. Si ungjillor që jam, i kthyer në besim në traditën e kishës Metodiste, unë shikoj në të shkuarën me admirim

të mahnitshëm dhe me mirënjohje ndaj Perëndisë valën e Frymës së tij që u derdh në shekullin e XVIII e më tej. Por as ti dhe as unë nuk mund të kërkojmë një “llogari kursimi” të rezervuar nga brezat e shkuara për ne. Dhe as nuk mund të jetojmë me bekimet e jetës sonë të shkuar të krishterë, njësoj sikur ato bekime të ishin bërë një llogari kursimi në një bankë për momentet kur të na zvogëlohej llogaria rrjedhëse. Sot është dita kur duhet të njohim Zotin.

Ose mund të jetë ndonjë vend që Perëndia e ka bekuar bujshëm në të shkuarën, dhe ti i përket atij vendi sepse ku lindur aty. Cili vend është bekuar lavdishëm me fuqi rizgjimi më shumë se sa Uellsit? Ja një fragment nga “Wrexham Leader” – një gazetë lokale e qytetit ku jetoj tani:

Më 1904-1905, Uellsit u përfshi nga një rizgjim fetar. Kishëzat ishin të hapura 24 orë në ditë dhe u caktuan vende në fund të tuneleve [në minierat e qymyrit] ku bëheshin shërbesa përpara fillimit të punës. Salem Chapel, Penycae, pranoi 46 anëtarë të rinj në një të dielë të vetme, dhe gjatë një fushate njëmuajore, u bënë katër shërbesa pagëzimi, dhe tek Tabernacl, Brymbo, Pastori E. K. Jones pranoi 60 anëtarë të rinj brenda një dite të vetme. U numëruan 82 të kthyer në besim në tre javë tek Sion Chapel, Cefn, dhe tek Tabernacle, u pagëzuan 14 njerëz në një ditë. Dehja pothuajse u zhduk nga Coedpoeth. “Shumë prej tipave më të këqij në fshat, - shkroi një korrespondent, - janë bërë besimtarë.”

Në të gjithë Uellsin u dëshmuar skena adhurimi, fuqie, pendimi dhe kthimi të lavdishëm gjatë rizgjimit; dhe as nuk ishte e vetmja herë kur Uellsit u bekua kaq fuqishëm nga Perëndia. Por sot, populli i Uellsit duhet të ecë me Perëndinë për veten e tij, dhe nuk mund të shikojë vetëm në të shkuarën lavdinë e të parëve dhe të jetojë në kujtimin e saj. Ashtu siç thotë psalmi: “Sot, në qoftë se e dëgjoni zërin e tij, mos u bëni zemërgur.” (Heb. 4:7)

Tani e kuptojmë se çfarë donte të thoshte Perëndia kur tha nëpërmjet Amosit: “Më kërkonti dhe do të rroni, por mos kërkonti Bethelin.” Zemra e fesë së vërtetë është vetëm realiteti i drejtpërdrejtë dhe personal i së tashmes në përvojën tëndë me Perëndinë dhe ecjen tëndë me të; jo e shkuara jote, as e shkuara e kishës, dhe as ajo e vendit tënd.

Perëndia shton (5:14): “Kërkonti të mirën dhe jo të keqen, që të rroni dhe kështu Zoti, Perëndia i ushtrive, do të jetë me ju, ashtu si thoni ju.” Vini re

se gjithçka ka të bëjë me *jetesën*: jeta e krishterë është jetë me bollëk. Jezusi tha: “Unë ka ardhur që të kenë jetë e ta kenë me bollëk.” (Gjn. 10:10b).

Nëse përvoja jote e tashme me Perëndinë është e dobët, e kapitur dhe monotone, “Kërkoni Zotin dhe do të rroni” (Amosi 5:6). Ai është gjithmonë aty duke pritur që të vish dhe të të japë një fillim të freskët e të ri në bekimin e tij.

*“realiteti i drejtpërdrejtë dhe personal... jo e shkuara jote, as e shkuara e kishës”: Kisha
‘Tabernacl’, në Brymbo, u mbyll dhe u ndryshua në banesa*

Kapitulli 19 - Simoni

Të kthehemi tani tek Dhiata e Re dhe tek Veprat 8 ku shikojmë një njeri të quajtur Simon. Më parë, përpara se të fillojë historia, ai kishte praktikuar magjinë në qytetin e Samarisë dhe kishte mahnitur gjithë kombin. Sigurisht që magjia është rreptësisht e ndaluar në Bibël:

Nuk do të mësossh të shkosh pas veprave të neveritshme të këtyre kombeve. Të mos gjendet midis teje ndonjë që kalon birin ose bijën e vet nëpër zjarr, as ndonjë që praktikon shortarinë, bën parashikime, interpreton shenjat dhe merret me magji, as ai që përdor yshtje, as mediume që konsultojnë frymrën, as magjistarë, as ai që ndjell të vdekurit, sepse të gjithë ata që merren me këtë punë neveriten nga Zoti. – Ligji i Përtërirë 18:9-12

Ai i tha popullit se ishte njeri i madh, dhe të gjithë ia vinin veshin duke thënë se “ky është fuqia e madhe e Perëndisë”.

Filipi, një predikues i krishterë i hershëm, erdhi në qytet dhe predikoi ungjillin, dhe Simoni besoi, u pagëzua dhe vazhdoi me Filipin. Ai u mahnit nga mrekullitë që Filipi bënte në emër të Jezusit, dhe ai dëshironte të kishte një pjesë në këtë shërbesë dhe të kishte fuqinë e dhënë nga Fryma e Shenjtë.

Apostujt Pjetër dhe Gjon dëgjuan për punën në Samari dhe erdhën vetë. Simoni pa se njerëzit merrnin Frymën e Shenjtë kur apostujt vinin duart mbi ta, dhe ai donte ta ushtronte vetë këtë fuqi. Kështu që u ofroi apostujve para duke u thënë: “Ma jepni edhe mua këtë pushtet, që ai të cilit do t’i vë duart, të marrë Frymën e Shenjtë.” Emri i tij ishte Simon, dhe prej tij ka dalë fjala *simoni*, që do të thotë të blesh një post fetar me para. Simonia është e gabuar: është Perëndia ai që jep shërbesën shpirtërore; ajo nuk mund të blihet me para.

Pjetri i tha Simonit (v. 21): “Ti nuk ke as pjesë as short në këtë gjë, sepse zemra jote nuk është e drejtë përpara Perëndisë”. Simoni nuk e kishte fare konceptin që Zotit duhet t’i shërbesh nga thirrja dhe mundësimi i tij: përkundrazi, mendimet e tij ishin në nivelin e ndyrë të parave. Pjetri i thotë të pendohet dhe të kërkojë falje, duke shtuar: “Sepse unë shoh se je në vrerin e hidhësisë dhe në prangat e paudhësisë.” Dhiata e Vjetër (LiP. 29:18) na thotë se të largohesh nga Zoti për t’u shërbyer perëndive të

kombeve, mund të shkaktojë një “rrënjë që prodhon helmin dhe pelinin.” Mesa duket ky është pozicioni i rrezikshëm ku ndodhet shpirti i Simonit, dhe Pjetri e quan prerë “pranga”: ato e mbajnë shtrënguar. Nuk është çudi që i bën thirrje të “pendohet për këtë ligësi” (v. 22).

Feja e vërtetë nuk është çështje e parëndësishme ose e lehtë, dhe Pjetri shton edhe këto fjalë shqetësuese: “që po të jetë e mundur, të falet mendimi i zemrës sate”. Ai nuk e lë Simonin të shqiptojë disa fjalë të shkurtra si “Më vjen keq”, por nxjerr në pah se kjo ligësi e mban shtrënguar dhe i ka hidhëruar shpirtin, dhe ai duhet të kërkojë seriozisht ndihmën e Perëndisë.

Në vargun 24, Simoni, në fakt, kërkon lutje: nuk na thuhet si përfundoi ngjarja.

A ka të bëjë kjo histori me ne? Po! Sepse është fjala e Perëndisë! Simoni e besoi predikimin, u pagëzua, dhe vazhdoi për një farë kohe me predikuesin. Por ai kishte ende nevojë për pendimin e vërtetë. Jam trishtuar nga tërë ata njerëz që kam takuar gjatë viteve, të cilët kanë shpallur hapur se besojnë të gjitha gjërat e duhura për vete dhe për Jezus Krishtin; të cilët ndoshta e kanë pasuar këtë “kthim në besim” me pagëzimin; dhe për një farë kohe kanë vazhduar në jetën e kishës. Por muaj ose vite më vonë, ata nuk shihen më mes njerëzve të Perëndisë, dhe e kanë braktisur plotësisht ecjen dhe shërbesën e krishterë. Ata janë si njerëzit tek shëmbëlltyra e Zotit tonë tek Marku 4. Mbjellësi mbolli farën e mirë (që përfaqëson fjalën e Perëndisë) në jetën e njerëzve, por zemra e disave ishte si toka e hollë mbi një gurishte, ku rrënjët nuk shkojnë thellë. Kur ata dëgjojnë ungjillin, e pranojnë me gëzim, por meqë s’kanë rrënjë në vetvete, ata zgjasin vetëm për pak kohë, dhe kur vijnë mundimet ose përndjekjet për shkak të fesë, ose në kohë tundimesh, ata rrëzohen. Ose, si të tjerët, që e kanë zemrën si toka ku mbinë edhe gjembat, të cilat ia marrin frymën farës së mirë, dhe kështu ajo nuk piqet por del e pafrytshme. Kujdesi i botës, kënaqësia në pasuritë dhe dëshira që kanë për gjërat e tjera e mbytin farën - pra përparimin e mesazhit dhe të jetës së Perëndisë në dhe shpirtin e tyre. (Lexo Markun 4 dhe Llukën 8).

Nëse je njeri i tillë; nëse ke bërë një shpallje të besimit dhe fillim të tillë jetëshkurtër në jetën e dishepullizimit të krishterë— tani është koha të pendohesh me të vërtetë dhe t’i bësh një përkushtim të përhershëm dhe të ndërgjegjshëm Krishtit si Shpëtimtari dhe Zoti yt.

Po kështu ekziston një tundim që kisha ta zbusin mesazhin e ungjillit për pendimin dhe besimin e thellë që të ndryshon jetën, për t’ua bërë bëjnë të lehtë njerëzve të bëhen anëtarë. Ata shpresojnë se kjo do t’i tërheqë njerëzit në kishë, dhe do të ulë pengesat që ata mund të hasin për t’u bërë të krishterë. Por një punë e tillë prodhon tepër shpesh vetëm besimtarë të rremë dhe jetëshkurtër. Besimtarët e tillë janë si njerëzit për të cilët lexojmë tek Jeremia 6 dhe 8, për të cilët Jeremia tha se mësuesit e fesë së asaj kohe “e mjekojnë shkel e shko plagën e popullit tim, duke thënë ‘Paqe, paqe’, kur nuk ka paqe.”

Kapitulli 20 - Çfarë është pendimi?

“Perëndia... i urdhëron të gjithë njerëzit dhe kudo që të pendohen.” – Veprat 17:30. Por çfarë është pendimi?

Së pari, duhet të vërejmë se ky është një urdhërim, jo diçka fakultative që mund ta përfshish ose ta lësh jashtë jetës së krishterë, sipas dëshirave ose preferencave personale. Ky është mesazhi i parë i Jezusit në Ungjillin e Markut: “U mbush koha dhe mbretëria e Perëndisë është afër. Pendohuni dhe besoni ungjillin.” Por Perëndia nuk na urdhëron të bëjmë gjëra që, me ndihmën e tij, nuk i bëjmë dot: kështu që kjo gjë është e mundshme. Pendimi përfshin dy elementë: pranimin e mëkatit, dhe heqjen dorë prej tij.

Së pari, duhet të njohim dhe të pranojmë se ajo që është e gabuar është e gabuar. Nëse Perëndia e ka ndaluar, dhe ne e kemi bërë, është mëkat. “Më pastro nga mëkati im!” - shkroi psalmisti (Ps. 51), “Sepse i pranoj të ligat që kam bërë, dhe mëkati im më rri gjithnjë përpara.” Nuk duhet të justifikojmë veten, apo fajin tonë, apo të mundohemi ta zvogëlojmë, duke ia veshur situatave rreth nesh, ose asaj që na kanë bërë të tjerët, ose vetë gjendjes sonë fizike ose emocionale në kohën kur kemi mëkatuar. Ne pranojmë se ajo që bëmë ishte e ndaluar, ishte në kundërshtim me vullnetin e Perëndisë dhe me sjelljen e krishterë, dhe e rrëfejmë si të tillë.

Shoqëria i jep emra të zbutur asaj që Perëndia quan mëkat; eufemizma të cilat e maskojnë natyrën e tij të vërtetë në sytë e Perëndisë dhe që japin një përshtypje të rremë se përpiqen, deri në njëfarë mase, të justifikojnë mëkatin. Por të thyesh ligjin e Perëndisë është mëkat: “Kush bën mëkat, bën edhe shkelje të ligjit; dhe mëkati është shkelje e ligjit.” (1 Gjn. 3:4)

Mëkati është thyerje e ligjit të Perëndisë; nuk është thyerje traditash fetare ose kulturore të vendit. Disa njerëz përpiqen të të ngarkojnë me një ndjenjë faji duke shpikur rregulla dhe duke i quajtur idetë e tyre si të Perëndisë, por nëse Perëndia nuk ka thënë gjë në lidhje me çështjen në fjalë, atëherë ajo nuk është mëkat. Megjithatë, nëse të bindin se thyerja e rregullit të tyre është mëkat, ose se mund të jetë mëkat, por ti gjithsesi e bën, duke menduar

se po bën mëkat ose të paktën se mund të jesh duke bërë mëkat, atëherë për ty kjo është mëkat. Kjo është mësimi i qartë i Romakëve 14:23.

Kështu pra: mëkat është të bësh gjërat që Perëndia i ka ndaluar, ose të lësh pa bërë ato gjëra që ka urdhëruar ai, ose të bësh diçka që ti beson ose ke dyshimin se është mëkat. Në raste të tilla, ne mëkatojmë, dhe duhet të vijmë tek Perëndia e të themi fjalët e Llukës 15:18-19, “Atë, mëkatova kundër qiellit dhe para teje; nuk jam më i denjë të quhem yt bir.”

Pastaj, largohemi nga mëkati; e nxjerrim nga jeta jonë – sigurisht duke kërkuar ndihmën e Perëndisë për këtë gjë. “Më laj dhe do të jem më i bardhë se bora... O Perëndi, krijo tek unë një zemër të pastër dhe përtëri tek unë një frymë të patundur... Kthemë gëzimin e shpëtimit.” (Ps. 51:7, 10, 12) Shën Athanasi në “Letrën e drejtuar Marcellinus në lidhje me interpretimin e Psalmeve” shkroi:

Të pendohesh do të thotë të braktisësh mëkatin... Ta zëmë se tani ke mëkatuar dhe, pasi je pështjelluar, pendohesh dhe po përgjërohesh për falje, dhe në atë moment ke fjalët e rrëfimit dhe pendimit tek Psalmi 51.

Pendimi është të kthehesh mbrapsht dhe të fillosh të ecësh në drejtimin e kundërt: t’i kthesh kurrizin mëkatit, dhe të ecësh me Zotin së jashtmi dhe së brendshmi si i krishterë. Tek Veprat 20:21, Apostulli Pal e quajti “pendimi te Perëndia”.

Por kjo ka edhe një dimension tjetër. Mund të ndodhë që gjatë mëkatimit, të kesh bërë padrejtësi edhe kundër dikujt tjetër. Në këtë rast, duhet t’i rregullosh gjërat si me personin që ke lënduar ashtu dhe të pendohesh para Perëndisë. Mendo për fjalët e Zotit tek Mateu 5:23-24:

Nëse ti, pra, po paraqet ofertën tënde te altari, dhe atje kujtohesh se yt vëlla ka diçka kundër teje, lëre atje ofertën tënde para altarit dhe shko pajtohu më parë me vëllanë tënd; pastaj kthehu dhe paraqite ofertën tënde.

Jezusi i tha këto fjalë në kohën kur në tempullin judaik vazhdonte të kryhej adhurim dhe të bëheshin flijime. Ta zhvendosim parimin në ditët tona: do të ishte shumë e gabuar dhe e pamend nëse vjen në Darkën e Zotit, dhe merr bukën e verën e Darkës, kur e di se është një person që me të drejtë ka diçka kundër teje, të cilit nuk i ke kërkuar falje, dhe brenda mundësive, nuk e ke dëmshpërblyer. A ke vjedhur ndonjë gjë? Së pari,

ktheje. A ke thënë fjalë zemërimi, të pasjellshme ose të rreme të cilat duhet t'i tërheqësh dhe t'i korrigjosh? Shko dhe bëje. Kjo është më e mençur sesa të vish në Tryezën e Zotit padenjësisht. Asnjëherë nuk mund të bëhesh vetë i denjë, por mund të falesh dhe të pastrohesh, dhe pastaj të mirëpritësh në Krishtin tek Darka e Zotit.

I njëjti parim kërkohet në Dhiatën e Vjetër. Ezekieli (33:14-16) shkruan:
Kur i them të pabesit: 'Ti me siguri do të vdesësh', në rast se ai largohet nga mëkati i tij dhe kryen atë që është e ndershme dhe e drejtë, në rast si i pabesi kthen pengun, kthen atë që ka vjedhur dhe ecën sipas statuteve të jetës, pa kryer paudhësi, ai me siguri ka për të jetuar, nuk ka për të vdekur. Asnjë nga mëkatet e kryera prej tij nuk do të kujtohet kundër tij; ai ka bërë atë që është e ndershme dhe e drejtë dhe me siguri ka për të jetuar.

Në librin me titull *Stories of great Revivals* ("Tregime të Rizgjimeve të Mëdha") nga Henry Johnson (Londër, Religious Tract Society, 1906) lexojmë këtë fragment mbi lëvizjen e Frymës së Shenjtë të Perëndisë që ndodhi në Uells më 1904 dhe 1905, të cilën e përmenda në Kapitullin 18:

Shumë sherre të moçme u zgjidhën miqësisht, ndërsa shumë borxhe, që ishin konsideruar që kohë më parë si "të papagueshme dhe të pakthyeshme", u paguan më në fund.

Një tregtar mori një letër anonime që përmbante shumën prej £5.10 me urdhërpagesë. Fjalët e vetme që shoqëronin dërgesën ishin "Para ndërgjegjeje". Një doktor fshati i tha një miku: "Ja, rizgjimi po më bën mirë edhe mua." "Do të thuash se ke më shumë pacientë?" – e pyeti shoku. "Aspak, - iu përgjigj doktori, - por £23 që më kishin borxh, të cilave i kisha hequr vizë nga libri si borxhe të papagueshme dhe të pakthyeshme, i kam marrë që kur ka filluar rizgjimi."

Kjo është ajo që ndodh kur vjen tek Perëndia; është një pjesë e pashmangshme e pendesës së vërtetë. Dhe ka gjithmonë falje, pranim dhe jetë për ata që pendohen në këtë mënyrë para Perëndisë dhe që i dëmshpërblejnë njerëzit të cilëve u kanë bërë padrejtësi. Psalmi 130 thotë:

Por te ti ka falje, me qëllim që të kenë frikë prej teje... sepse pranë tij ka dhembshuri dhe shpëtim të plotë.

Tek kthehemi edhe një herë tek Letra e Athanasit mbi interpretimin e Psalmeve, lexojmë:

Pasi na tregon se Krishti duhet të vijë në formën njerëzore, libri i Psalmeve vazhdon të tregojë se ai është në gjendje të vuajë në mishin që ka marrë përsipër... Sepse Ai nuk vdiq duke qenë i përgjegjshëm për vdekjen e vet: Ai vuajti për ne dhe mbarti mbi vete zemërimin që ishte dënimi për paudhësitë tona... Kjo është mirësia e mëtejshme e Shpëtimtarit që, pasi u bë njeri për hirin tonë, jo vetëm që ofroi trupin e vet për të vdekur në vendin tonë - që të na shpengonte të gjithë nga vdekja- por duke pasur dëshirë të na tregonte mënyrën qiellore dhe të përsosur të jetesës së tij, Ai e shprehu këtë në vetë veten e tij.

Ose, në fjalët e 1 Gjoni 1:9 “Po t’i rrëfejmë mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi.”

Jezusi tregoi shëmbëlltyrën e tij ndoshta më të parapëlqyerën për të na treguar se endacakët janë të mirëpritur, dhe, në fakt, ftohen që të kthehen përsëri tek Perëndia. Këtë e gjejmë tek Lluca 15:

Tha akoma: “Një njeri kishte dy bij. Më i riu i tyre i tha babait: ‘Atë, më jep pjesën e pasurisë që më takon.’ Dhe i ati ua ndau mes tyre pasurinë. Mbas pak ditësh biri më i ri mblodhi çdo gjë, shkoi në një vend të largët dhe atje e prishi gjithë pasurinë, duke bërë një jetë të shthurur. Por, si i shpenzoi të gjitha, në atë vend ra një zi e madhe buke, dhe ai filloi të jetë në hall. Atëherë shkoi e iu ngjit pas një banori të atij vendi, i cili e çoi në arat e tij që të ruajë derrat. Dhe ai dëshironte të mbushte barkun me lendet që hanin derrat, por askush nuk ia jepte. Atëherë erdhi në vete dhe tha: ‘Sa punëtorëve mëditës të atit tim u tepron buka, kurse unë po vdes nga uria! Do të çohem dhe do të shkoj tek im atë dhe do t’i them: Atë, mëkatova kundër qiellit dhe para teje; nuk jam më i denjë të quhem yt bir; trajtomë si një nga mëditësit e tu’. U çua, pra, dhe shkoi tek i ati. Por kur ishte ende larg, i ati e pa me dhembshuri; e lëshua vrap, ra mbi qafën e tij dhe e puthi. Dhe i biri i tha: ‘O atë, mëkatova kundër qiellit dhe para teje, dhe nuk jam më i denjë të quhem biri yt’. Por i ati u tha shërbëtorëve të vet: ‘Sillni këtu rrobën më të bukur dhe visheni, i vini një unazë në gisht dhe sandale në këmbë. Nxirrni jashtë viçin e majmur dhe thereni; të hamë dhe të gëzohemi, sepse ky biri im kishte vdekur dhe u kthye në jetë, kishte humbur dhe u gjet përsëri’. Dhe filluan të bënin një festë të madhe.”

Nëse je njeri që ke shkarë nga besimi, të bëj thirrje të të vijë me të vërtetë keq për ftohtësinë dhe endjen tënde, t’i rrëfesh mëkatet Perëndisë, të

kthehesh tek Zoti yt, Jezu Krishti, dhe pjesën tjetër të jetës, të ecësh me të në një jetesë të shenjtë e të drejtë dhe në një shërbesë të gëzuar. Bibla e quan Jezusin Mikun e mëkatarëve. Për të mund të themi me gjithë gëzim nga zemra se:

Ne besojmë...

në një Zot Jezu Krishtin... që për ne njerëzit dhe për shpëtimin tonë zbriti prej qiejve, edhe u mishërua prej Shpirtit të Shenjtë edhe Virgjëreshës Mari dhe u bë njeri. Dhe u kryqëzua për ne në kohën e Pontit Pilat, dhe pësoi dhe u varros, dhe u ngjall të tretën ditë sipas Shkrimeve.

Kapitulli 21 - Një shëmbëlltë

Gjatë mbrëmjeve të acarta, ndez shpesh zjarrin në shtëpi dhe kënaqem kur ulem përballë ngrohtësisë së tij, duke dëgjuar fëshfëritjen e heshtur të flakëve dhe ndonjëherë kërcitjen e drurëve, ndërkohë që lexoj ndonjë libër tërheqës. Nëse e vendos kunjin e shkrepëses tek letra që ta ndez, vijnë një sërë veprimesh të ndryshme:

- Ndonjëherë, letra merr flakë menjëherë, flakët përhapen, shkopinjtë e hollë marrin shumë shpejt zjarr, pastaj dhe qymyri, dhe zjarri digjet me ngrohtësi dhe rehati gjatë gjithë mbrëmjes deri kur vjen ora për të fjetur, pa pasur nevojë për përkujdesje të mëtejshme, përveçse të futësh më shumë dru ose qymyr.
- Ndonjëherë, letra merr flakë menjëherë, flakët përhapen, shkopinjtë e hollë marrin shumë shpejt zjarr, pastaj dhe qymyri; por pas disa minutash, zjarri bie dhe duhet shumë kujdes, vëmendje dhe durim me kacakët që të mbash flakën gjallë dhe ta bësh të vazhdojë dhe të zgjasë: ndoshta letra ishte futur shumë ngushtë; ndoshta shkopinjtë ishin të lagur; ndoshta era po frynte nga oxhaku: por së fundi zjarri fillon të ecë mirë, dhe pastaj digjet me ngrohtësi dhe rehati gjatë gjithë mbrëmjes deri kur vjen ora për të fjetur, pa pasur nevojë për përkujdesje të mëtejshme, përveçse të futësh më shumë dru ose qymyr.
- Ndonjëherë zjarri fillon mirë ose me shumë vështirësi, pastaj shuhet dhe së fundi fiket fare me gjithë përpjekjet e mia. Zgjidhja e vetme – përveçse të mos kesh fare zjarr – është ta shpërhapësh të gjithin dhe ta fillosh gjithçka nga e para.

Në faqet e shkrimit, feja jonë krahasohet ndonjëherë me zjarrin. Për ta parë këtë nuk duhet të kërkojmë më tej shkrimeve të Llukës:

Le të jenë të ngjeshur ijët tuaja, dhe llambat ndezur. - Lluca 12:35

Une erdha të hesh zjarr mbi tokë dhe sa dëshiroj që ai të ishte tashmë i ndezur. - Lluca 12:49

Po a nuk na digjej zemra përbrenda, kur ai na fliste udhës dhe na hapte Shkrimet? - Lluca 24:32

Dhe atyre u dukën gjuhë, si prej zjarri, të cilat mbaheshin dhe zinin vend mbi secilin prej tyre. Kështu të gjithë u mbushën me Frymën e Shenjtë... -

Veprat 2:3-4

Shpesh i përngjasoj zjarret e mbrëmjes në shtëpinë time me jetën e krishterë. Disa njerëz, si zjarri që ndez mirë dhe vazhdon të digjet mirë dhe i shndritshëm, e fillojnë jetën e krishterë dhe kurrë nuk kthehen pas. Ata e duan Zotin dhe i shërbejnë, duke e vënë të parin në përparësitë e tyre që në fillim, dhe ai mban të njëjtin pozitë në dashurinë e tyre edhe kur arrijnë fundin e jetës tokësore. Të tjerët e fillojnë mirë, por zjarri i dashurisë dhe përkushtimit u dobësohet dhe mund të bëhet që të shndrisë vetëm pas një periudhe vëmendjeje dhe kujdesi serioz. Por ata kthehen pas me mundim tek përkushtimi i parë, dhe që në atë moment e tutje ecin me zell në Zotin. Ndërkohë, të tjerë zmbrapsen kaq shumë nga ndjekja e Perëndisë sa, sipas gjithë gjasave, duket sikur nuk ka ngelur asnjë flakë. E vetmja zgjidhje është që t'ia nisin përsëri nga fillimi dhe, pas një periudhe ku kanë qenë goxha larg Zotit, të nisin një fillim të ri në besimin që vepron me anë të dashurisë.

Në një kapitull të mëparshëm shkrova se ne nuk mund të jetojmë në lavdinë e përvojave dhe bekimeve të shkuara; duhet të qëndrojmë afër Zotit tonë, ditë për ditë, deri në fund të jetës. Ose mendojeni kështu: duhet të mbajmë gjallë zjarrin e dashurisë dhe përkushtimit ndaj Krishtit që të digjet brenda nesh. Është njësoj si zjarri në altarin e Dhiatës së Vjetër:

Zjarri mbi altar do të mbahet i ndezur dhe nuk do të lihet të shuhet...

Zjarri duhet të digjet vazhdimisht mbi altarin dhe nuk duhet të shuhet. -

Levitiku 6:12-13

Zjarri mund të shuhet dhe madje të fiket fare jo vetëm tek të krishterët si individë, por edhe tek një kishë e tërë. Kisha lokale mund të shkasë nga besimi tek Zoti po aq sa edhe individi. Vendos në zemrën tënde që kjo nuk do të ndodhë në kishën ku je anëtar.

Më 1653, në qytetin e Nantwich u themelua një kishë Baptiste, dhe disa vjet më vonë, rreth 1675, një i ri, që nuk ia dimë emrin, përshkoi dyzet kilometra me këmbë nga shtëpia e vet në Cefn Bychan deri në Nantwich në kërkim të një pune, dhe filloi të ndiqte kishën Baptiste në Nantwich. Ai i kërkoi predikuesit, Samuel Action, të shkonte dhe të predikonte në Cefn Bychan, dhe rezultati ishte formimi i një misioni ungjillor atje, me bazë kishën në Nantwich, si dhe u mblodh një bashkësi.

Në Cefn Bychan kishte pasur një mbledhje të Quakers², por kaq shumë prej tyre kishin emigruar në Amerikë (Pensilvani), sa kishëza nuk përdorej më dhe njerëzit ftuan bashkësinë Baptiste që ta përdorte. Baptistët bënë takime por akoma nuk ishin formuar si kishë, kështu që ecnin më këmbë dyzet kilometra për në Nantwich që të merrnin Darkën e Zotit një të dielë në muaj, duke u nisur që të shtunën në mbasdite. Më vonë, ata u formuan në një kishë, dhe kishëza e tyre u hap më 1826 – një nga kishëzat më të vjetra në të gjithë zonën.

Por rreth 200 vjet më parë, kisha ra nën ndikimin e një predikuesi të quajtur Robert Sandeman, i cili mësonte se besimi shpëtues është thjesht besimi i së vërtetës së hapur, pranimi i fakteve, dhe i cili nuk prek ndjenjat ose vullnetin. Kjo pikëpamje intelektuale e besimit të çon më shumë drejt një feje të ftohtë të mendjes sesa drejt një përkushtimi të ngrohtë dhe përvëlues në zemër. Ndoshta – mund të mos e marrim vesh kurrë – ajo ishte periudha që së pari e shkatërroi jetën e kishës si ngricë, dhe filloi periudhën e gjatë të rënies që çoi në një përfundim tragjik në ditët e sotme.

Nga fundi i shekullit të XX, bashkësia ishte pakësuar deri në grusht njerëzish që i bënë shërbesat në gjuhën uellsiane, ndonëse deri në atë kohë gjuha e shumicës së popullsisë ishte anglishtja. Kishëza qëndron në mes të një zone me shtrirje shumë të madhe shtëpish, dhe ishte në një pozicion që t'u çonte ungjillin mijëra e mijëra njerëzve – por jo në gjuhën uellsiane, të cilën ata nuk e kuptojnë. Kështu që dy pastorë Baptistë aty afër kërkuan lejen që të përdornin kishëzën me qira të dielave në një kohë kur nuk ndërhynte me shërbesat në gjuhën uellsiane, në mënyrë që të bënë shërbesa në anglisht. Kërkesa u refuzua, dhe tani, ndërsa po shkruaj, kishëzën e kanë nxjerrë për shitje. Mund ta shikoni në fotografi.

Rreth 330 vjet më parë, dhe në vitet në vazhdim, njerëzit treguan besim, vizion dhe përkushtim sakrifikues – kush do të ecte sot dyzet kilometra për të marrë Darkën e Zotit? – por ndërsa koha kalonte, bashkësia nuk vazhdoi në bekimin që u dha në atë kohë Perëndia. Në një farë mënyre, ndoshta nëpërmjet ndikimit të mësimave të Sandeman-it, zjarri i dashurisë së tyre hyjnore u shua. Ata nuk po i donin më ata mijëra njerëz që jetonin rreth e rrotull, nuk dëshironin më kthimin e atyre njerëzve tek Krishti; e humbën vizionin që Krishti të adhurohej nga mijëra njerëz rreth e rrotull në gjuhën

dhe kulturën vendase. Zjarri u shua vërtet, dhe tani s'ka më asnjë dëshmi në atë zonë.

Kjo mund t'i ndodhë një kishe, ose një grupi kishash, një shoqërie misionarësh, ose një shoqërie ungjillore; ose një besimtari të krishterë. Nuk mund të jetojmë në të shkuarën, sado i shkëlqyer të ketë qenë fillimi ynë në shërbesën e krishterë: duhet të qëndrojmë afër Zotit me besim të gjallë dhe përkushtim të ngrohtë derisa një ditë të thirremi për ta takuar ballë për ballë. Dhe atëherë mund të dëgjojmë mirëseardhjen e dëshiruar: “Të lumtë, shërbëtor i mirë dhe besnik!”

1 *God's Smuggler* Hodder & Stoughton, Londër, 1967

2 Quakers – grupim protestant që theksonte anën subjektive të përjetimit të besimit.
(Shënim i përkthyesit.)



Table of Contents

Kapitulli 1 - Shkarja nga Besimi
Kapitulli 2 - Kaini
Kapitulli 3 - Jakobi
Kapitulli 5 - Tamari
Kapitulli 6 - Manasi
Kapitulli 7 - Moshyrja në Bekimin e Perëndisë
Kapitulli 8 - Kujdes për veten
Kapitulli 9 - Samsoni
Kapitulli 10 - Absalomi
Kapitulli 11 - Josia
Kapitulli 12 - Fundi i verës
Kapitulli 13 - Baal-peori
Kapitulli 14 - Gibeahu
Kapitulli 15 - Era e Lindjes
Kapitulli 16 - Dilema e Perëndisë
Kapitulli 17 - Një shans i dytë
Kapitulli 18 - Sërisht Betheli
Kapitulli 19 - Simoni
Kapitulli 20 - Çfarë është pendimi?